


Betim Muco

8 SH - 32
M 98



T R E G I M E

8SH-32
M 98

BETIM
MUÇO



TREGIME

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PRANVERA QË NGJANTE ME DIMËR

Muajt e parë të vitit 1939 po i shtonim të tjera thinja në flokë e në mustaqe kapterit të xhandarmërisë, Abdylaziz Çukrës. «Ku shkon kjo botë kështu? U bë njerëzia lesh e li. Ka dalë hajnia sheshit e Italja hyn e del ndër ne si në shpi të vet». Këto mendonte ai tek kthehej për në qytetin ku shërbente. Kapter Abdylaziz Çukra kishte gruan me gjashtë fëmijë në malësinë e Hasit. Dhe veç hallit për ta, vinin e i shtoheshin edhe shumë mendime të zymta që ia rrëzonin edhe më vetullat e dendura mbi eshtrat e dala në kufijtë e mollëzave të faqeve. Shumë gjëra ai, Abdylaziz Çukra, malësor i pashkollë, nuk i kuptonte dot. Po këtë radhë pleqtë e Hasit e kishin parë shtrembër. «Qenke bërë kapter i naltmadhnisë, o Abdylaziz Çukra. A do të gëzohej vallë yt atë po të qe gjallë?!» Këto fjalë i kishte thënë Gjeto Pllana, më plaku i fshatit. Po halli e kishte bërë të hynte në xhandarmëri. Mendja e paditur e malësorit qe gënjyer nga dëshira për një Shqipëri të fortë, ku të mos hynte e të dilte kush të donte. Si kishte shërbypër një kohë të gjatë në kufi, këto muajt e fundit e kishin transferuar në një postë qyteti... Ditë të tur-

bullta dukeshin që vinin përtej. Kapteri rënroi dhe koka iu bë e rëndë, e rëndë, si të mbante një shkëmb përmbi supe.

Kapteri mbërriti në postë dhe mori shërbimin e vet. Poshtë në qeli kishte njerëz. Posta gumëzhinte nga zërat. Ai pa katër djem të rinj me ftyra të egër-suara. Dy prej tyre ia kishte zënë syri në qytet, njëri ishte mballomaxhi në pazar, ky tjetri, ky tjetri... shet gazeta më duket, u lëkund ai.

«E ç'dreqin keni ba, more?» — pyeti kapter Abdylazizi me zërin e tij prej basi.

«Dreqin prite kur ta bjerë Italia këto ditë, zoti kapter, bile me gjithë të birin, domethënë me mëkëmbësin». Tre djemptë e tjerë qeshën. Kapteri u kollit dhe u largua. Xhandari Fran Tapini nga Mirdita e nderoi, kroi zërin dhe i tha shpejt e shpejt të rejet.

«Qyteti asht rrëmujë. Thonë që kanë me na pushtue. Kush? Italja a Moskofi, ku ta dish, zotni kapter. Kta çunat kanë sha naltmadhninë. Asht dhe aj Vasil Kola. Togeri e çoi sipër atë. Thonë që kta çunat qenkan t'rrezikshëm, komonista. Njeni ishte prej Krujet, po, pér naltmadhni, prej Krujet ishte. Unë e dijshe se komonistat janë t'gjithë prej Vilone, se kshtu na pat thanë nji herë togeri, komonistat i kanë t'gjithë namat prej Moskofit, tha, dhe Moskofi i ka pru me vapor n'Vilonë me msy Shqipninë prej andej. Pér naltmadhni, zotni kapter, ata s'u dukshim rob t'ligj, pasha t'madhin zot. Njeni m'pyeti nga jam. «Pishkashjan jam, or ti?», — i thashë. «Ju pishkashjanët jeni trima të çartun, — tha, — dikur i keni pas ba pritë turkut me atë trimin, Marka Kulin». «Pse, ku e di ti Marka Kulin?», — i thashë. «E di, — tha, — e kam knu nér libra», — Shih, shih, e kish knu

n'libra, zotni kapter, edhe librat e paskan njat Marka Kulin, heu!» Fran Tapini tundte kokën dhe sytë i qenë zmadhuar nga habia. Kapter Abdylazizi shtroi mustaqet me pëllëmbë dhe bëri «nghë, nghë!». Pastaj uli sytë e mbërtheu koburen pas brezit. Edhe kburja iu duk më e rëndë se kurrë.

«Po togeri?» — pyeti ai pa ngritur kokën.

«Togeri asht ke prefekti, zotni kapter, e ka thirrë prefekti sot në mëngjes». Xhandari buzëqeshi dhe zbuloi një sërë dhëmbësh të bardhë e të fortë. Kapteri diçka shau me vete.

«Mirë, — tha, — rri ke telefoni ti, Fran». Tjetri nderoi dhe u largua. Kapteri u ngjit ngadalë lart në dhomën e nënoficerëve. Vasil Alarupi ngriti kokën nga tavolina. Njëri sy i qe enjtur e mavijosur dhe rrëzë mustaqeve të holla akoma s'i qenë zhdukur ca pulla të kuqe. Ai u ngrit në këmbë dhe u përpoq t'i buzëqeshite kapterit. Kapter Abdylaziz Çukra e pa me inat e i vrenjtur. Buzëqeshja e Vasil Alarupit filloi të tretej si dëbora në xham. Ai puqi duart i hutuar dhe kapértheu gishtérinjtë.

«Po ti, ç'do ktu ti? Mos je ma i mirë se shokët ti, a? N'birucë, hajde, misu».

«Zotni kapter, por... ju lutem, kini mirësinë ta sqaroni, ju lutem...»

«Yf!, — bëri një shenjë përbuzëse kapteri. — C'më dridhesh si kurvat, more! Hajt, marrsh n'birucë, se t'hyna n'hu që t'bindet dreqi!» Kapter Abdylaziz Çukra e zuri nga supi sekretarin e bankës së qytetit, fashistin Vasil Alarupi dhe, ndërsa ky thërriste e ulërinte duke protestuar për këtë akt violence e poshtërimi, e shtyu poshtë nëpër shkallë. Katarët djemtë e birucës numër 1 shikonin me buzë në gaz. Kapteri tërroqi derën dhe i vuri drynin llozit

të qelisë, pranë hekurave të së cilës vazhdonte protestat Vasil Kola.

«Mjaft, ore, se na shurdhove! — i thirri njëri nga të katër djemtë, — apo thérret të të dëgjojë Duçja?»

Vasil Alarupi mblodhi buzët dhe lëkura e fytyrës iu tendos.

«Këlysh bolsheviku! — tha duke vërvshëlyer nën zë. — Dale, pa do ta shihni ju!»

«Në i kemi parë të gjitha: ju, mbretin hajdut dhe motrën e madhe, «hallën», «tezen» Itali, të gjitha i kemi parë. Tani veç t'i shohin këta». Djaloshi që shiste gazetat bëri me dorë nga kapteri dhe xhandari. Kapter Abdylaziz Çukra u li sytë te rripi i mesit dhe bëri «nghë, nghë!»

«Ai shau naltmadhninë e tij!» — i pëshpëriti pranë veshit Fran Tapini.

«Pusho, mor ti! — bërtiti kapteri. — Hajt, pushoni ju, sé boll jeni rrashë e gri përjashta!» Ai doli nga korridori pa i parë djemtë në sy. Pas dëgjohej zëri i hollë i Vasil Kolës, që ankohej e kërcënonte. Kapteri tha me vete se ndoshta diçka do të kënaqej po ta shtronte në dru atë mustaqehollë, se kështu mbasse do ta ndiente veten më të lehtë. U mbështet mbas tavolinës dhe vuri kokën në duar. Dhe koka përsëri i rëndoi e i rëndoi. «Çka me ba, — tha, çka me ba? Asgja s'kam në kaptinë e m'dulket sikur me pasë botën mren». Nga muri e vështronë i kapardisur portreti i mbretit. «Hau, pér mbret!» — tha dhe e vështroi me inat e me marazin e mbledhur tërë atyre ditëve. Sytë e tij të errët e të thellë iu ngulën syve të shkruar të portretit, lku endej një buzëgaz i lehtë e krenar. Atij iu duk një qast se sytë e portretit s'do ta duronin vështrimin e tij, ja, ata po fashiteshin, donin të iknin, t'u shmangeshin syve të tij. Por jo...;

ata ishin përsëri ashtu, tallës, buzëqeshës. «Ptu!» — bëri kapter Abdylaziz Çukra përbimi ta. Jashtë u ndien hapat e rëndë e të shpejtë të Framit.

«Zotni kapter, ka ardhë konsulli i Italjes, aj konsulli i ri, jo aj që ka qenë». Xhandari Fran Tapini bëri me kokë nga dera. Në gjithë fytyrën e tij kishte një shprehje të tillë, sikur tani do të ndodhë patjetër diçka e madhe. Kapteri u ngrit ngadalë e si me përtim.

«Le të presë togerin, — tha, — ç'punë kam unë me të?!» Xhandari rrinte te dera me sytë e hapur më shumë se kurrë. Kapteri ndenji një hop, pastaj doli nga dhoma dhe lëvizi ngadalë nëpër korridorin e katit të dytë për te zyra e togerit, ku priste konsulli. Prapa tij vinte si hije xhandari Fran Tapini, duke u përpjekur të hidhte sa më lehtë çizmet e tij të rënda.

«Zotni kapter, shkëlqesia e tij Morelini është konsulli i ri i Italisë, milkeshës sonë të madhe. Më parë sinjor Morelini ka qenë konsull në Tunizi». Përkthyesi, i lyer me parfum e me flokët të ndarë nga një vijë e drejtë, ku dukej lëkura e bardhë e kokës, fërkoi duart dhe bëri me dy gishtërinj nga italiani, që buzëqeshi i përbajtur dhe u përkul lehtë përpara, sikur të tregonte në cirk një numër xhonglerësh.

«Nghë, nghë!» — bëri kapter Abdylaziz Çukra dhe lidhi prapa duart e tij të mëdha.

«Çështja është për zotin Vasil Kola, zoti kapter. Shkëlqesia e tij, onorevole Morelini, kérkon lirimin e tij të menjëhershëm. Zotit Vasil i ndodhi një incident me elementë të rrezikshëm, ju duhet...»

«Si, si, presto; signore Kola e un amice, un fe-

dele amico del nostro paese»¹⁾). Në fjalët e italianit ndihej padurimi.

«Nghë, nghë!» — bëri përsëri kapteri. «Thuaj ktij zotnis, sé s'marrimi urdhna prej ktij ne, jemi shtet i pavarun, s'jemi koloni, ky t'shkoj e të'japë urdhna atje... në vend t'vet». Dhe kapteri u mat të kthente shpinën, me vetullat e mbledhura shuk.

«Por, zoti kapter..., zoti...», Përkthyesit iu mor goja. Ai po merrte një ngjyrë të ndërmjetme, nga e kuqja në të verdhë.

«Kaq! — mbushi dhomën basi i kapterit. — Kto që t'thashë, thuaja atij zotnis!»

«Che teribile voce! Cosa? Cosa dice?»²⁾. Italiani vërtiste i hutuar sytë nga kapteri te përkthyesi. Përkthyesi thoshte copéra të shkëputura fjalësh në shqip e në italisht. Kapter Abdylaziz Çukra ktheu kurrizin dhe u largua duke përplasur derën pas tij. Poshtë dëgjoheshin thirrjet e Vasil Kolës dhe zërat tallës të djemve. Kapteri rrinte i kërrusur përpëra dritares. Një ditë me një diell të mekur lëvizte mbi qytetin. Po vinte pranvera dhe erë pranvere s'binte. Po vinte pranvera dhe dukej sikur po hyhej në dimër. Kapteri shau me vete. Makina e konsullit bëri tym përpëra kthesës. Kapteri lëvizi ngadalë kokën dhe bëri poshtë shkallëve. Sytë e djemve prapa hekurave shihnin shpatullat e tij të mëdha e të varura. Dëgjohej zhurma e çizmeve të rënda. Ai qëndroi përpëra tyre. Djemtë shihnin në heshtje sytë e tij.

1) Po, po, shpejt; zoti Kola është një mik, një mik besnik i vendit tonë.

2) Çfarë zë i tmerrshëm! Çfarë? Çfarë thotë?

«E, or zoti kapter, punë të vështirë ke, or babë, sidomos në këto kohëra». Djaloshi që foli tundi kokën me keqardhje e buzagaz të hidhur.

«Besa boll!» — pëshpëriti kapteri. Trupi i tij i madh dhe i rëndë ishte lëshuar krejt. Ai kërkoi në turri e çelësave, zbërtheu drynin dhe i hoqi shulin derës.

«Shkoni, or djem, — tha, — shkoni, se i duheni këtij vatani».

Djemtë u panë në sy. Pastaj panë sytë e kapterit, pastaj përsëri njëri-tjetrin. Vasil Kola, i mbërthyer një copë herë nga ai vështrim tërë zemërim i kapterit, u tërroq në një qoshe duke gëlltitur sharjet nëpër dhëmbë.

«Hajt pra, çka prisni?!» Ata i shtrënguan krahët kapterit dhe lëvizën në korridorin e birucave. Mballomaxhiu bëri ca hapa dhe u kthye.

«Po ti? — tha. — Po ti, kapter?»

«Edhe unë, — foli kapter Abdylaziz Çukra, — edhe unë nuk e turpnoj Shqipnинë. Shko ti!» Ai e shtyu djalin përpara.

Në korridorin e birucave dëgjoheshin thirrjet e Vasil Alarupit.

«Malok i qelbur! Të paguan mbreti rrogë që të lirosh nga burgu ata këlyshë komunistësh!» Po këto thirrje dilnin nga goja e çapëlyer dhe, pasi përplasehin në muret e qelive e të korridorit, ktheheshin përsëri në veshët e atij që i lëshonte.

Xhandari Eran Tapini ngjiste me vrap shkallët për në dhomën e nënöficerëve.

«Zotni kapter, kapter Çukra, . . . togeri, zotni togeri ka urdhnue urxhent. . . »

Në dhomë s'kishte njeri. Xhandari rrrotulloi sytë me i habi. Dhe befas sytë e tij të hëabitur u ngulën di-ku. Mbi xhamin e portretit të lartmadhërisë varej e kullonte një pështymë e trashë njeriu, kushedi prej sa kohësh e përtypur dhe e mbillaçitur në gjoks, kushe-di me ç'helm të ditëve e të netëve helmuar. Ajo va-rej në xham, mbi sytë, hundën, buzët e mbretit. Ajo varej mbi krejt mbretërinë. Xhandari Fran Tapini kishte mbetur i mekur te dera.

PESHA E NJË FJALE

Motori i makinës gulçoi edhe një herë dhe pastaj u shua. Shoferi, një djalë e zmer, me një kaçurrel që i zbriste gjer te vetulla e djathtë, ngriti të dyja pëllëmbët e hapura mbi timon. Sipas kodit tradicional të shoferëve, kjo do të thoshte: «Nuk kam ç'bëj. S'shkon më tutje». Burri përpara tundi dy-tri herë kokën dhe mbloodi buzët.

«Nuk e mirëmban këtë makinë, more djalë, nuk e mirëmban».

«Po jo, shoku Saliko, ti e sheh vetë ç'karakatinë është kjo; ku bën kjo pér këtë rrugë?»

«E, e, e di unë, xhustifilkime thua, . . . xhustiflkime sa të duash». Ai tundi përsëri kokën. Burri prapa buzëqeshi dhe hapi derën.

«Nisemi më këmbë, — tha, — ka edhe kjo lezettin e vet. Kemi kohë pa shkelur këtej. Pastaj, s'mban shumë, gjysmë ore është».

«Mor po ç't'i bëj këtij të shkretë shiatiku unë, pa. . .»

Shoku Saliko doli si me përtesë nga makina. Shoferi, që kishte zbritur dhe ai, rrinte me një pamje fajtori, mbështetur te parakolpi i ciflosur i makinës. Shoku Saliko i tha të kthehej dhe të vinte t'i merrte

të nesërmen. Shoferi belbëzoi dicëka si «si urdhëron» dhe ngriti cullufën e flokut. Ai priti gjersa të dy burrat u larguan. Figurat e tyre me xhaketat mbi supë erdhën duke u zvogëluar. Në atë zonë, kolektivizimi po shtrinte krahët e tij të fuqishëm e të begatë. Po ende ndesheshin aty-këtu pengesa dhe hezitime. Ndaj ishin nisur të dy ata burra që kishin zbruzur pushkë këtyre anëve e u dëgjohej fjala në këto ditë. Ata punonin në rrethe të tjera e rrallë i sillte rasti këtej. Dhe, tek shkonin ashtu një monopati që priste pér shkurt, secili e mendonte me mënyrën e tij faktin që më shpesh duhej të kishin ardhur në këto anë, ku u kishte kaluar një pjesë e stuhishme e jetës së tyre, lufta. Fshati që dukej pértej ishte Shtëmbari. «Epo dhe kjo, të vish gjér këtu pér t'i mbushur menjjen Remzi Taganit! të hyjë në kooperativë?! Ç'kërkon ai ikopuk? Pse, pák të mira ka pasur nga ky pushtet? Si thua, o Telo?» Ai rregulloi pas këllëfin e kobures dhe tundi kokën. Shoku i tij hodhi xhaketën në supin tjetër.

«Nuk është aq e lehtë, or, jooo, — tha duke zvargur zërin, — edhe në luftë nuk e patëm aq kollaj me ndonjërin, sa e bëmë pér vete.»

«Opo kjo kështu! Pér të mirën e tyre, xhanëm...» Salikoja shkundte duart me nervozizëm. Në fshat lehën qentë. Burrat kaluan çezmën dhë bënë përpjetë një sokaku. Nga shtëpia ku ishin drejtuar ata, siç dukej i kishin parë që larg se Remzi Tagani, burri mbi të pësëdhjetat, i shëndoshë e me mustaqe të kuqërrëmta e të prera shkurt, kishte dalë e i priste në krye të shkallëve. Burrat u afruan.

«Hajde, Telo Koprëncka, hajde! Pushka është e dobët pér t'ia bërë «bam» meqë më shkelët në shtëpi. Hajde bujrum! Bujrum, bujrum, shoku Saliko!»

Të dy burrat u përqafuan me të dhe me të dy djemtë e mëdhenj që rrin pas tij. Njëri nga djemtë u hoqi udhën. Në odën me oxhak, ku hynë, ia behën dy njerëz nga të farefisit dhe u poqën dhe ata me të sapoardhurit. Remzi Tagani nxori kutinë e duhanit dhe e hodhi nga miqtë. Ndërkaq dhe Telo Koprëncka kishte flakur kutinë e tij të duhanit Kutitë u përpinqën me tingëllimën e zakonshme metalike dhe ranë të dyja mbi poste. Burrat qeshën. Telo Koprëncka tundi gishtin tregues.

«E sheh që jam bërë më i shkathët? Më parë s'ta dilja dot ty jo». Ai zgjati pëllëmbën dhe e rrahu pas kofshës së të zotit të shtëpisë.

«E shoh, or, e shoh, o Telo Koprëncka». E qeshura e tij erdhi e u shua shpejt. «Maraz e kam që mbe-tët kaq kohë pa ardhur këtej; si, ore, humbët kështu! Pse, mos u dashka të vijë përsëri gjermani, që t'ju shohim këtyre anëve tona?!»

«Punë, o Remzi, punë shumë, ka punë pushteti. Na mbytën punët». Salikoja fshiu qafën me shami.

«Punët s'janë ujë që të mbytin, o shoku Saliko.»

Teloja qeshi me gjithë shpirt dhe mimika e tij tha «qerrata Remzi!»

Jashtë qe errur. Dyshemeja me dërrasa krisi. Në dhomë hyri kryetari i këshillit. Ai hoqi kë-pucët te dera dhe, me një buzëqeshje të madhe në fytyrë, vajti e rroku dy të ardhurit.

«Po mirë se erdhët, mirë se erdhët! Si jeni, si i keni njerëzit?!

«Mirë, mirë, si je ti, Kapllan...» — thanë thuajse mekanikisht të dy burrat. Kryetari i këshillit u dha dorën dhe të tjerëve. Telo Koprëncka thithi duhanin dhe u mendua me sytë në oxhak. Remzi Tagani ndiqte vështrimin e tij.

«A ta ndez?» — pyeti pas pač.

«Cilin?»

«Oxhakun, de, vaftin s'e ka, po do ta ndez se ju nxjerr mallin juve.»

«Bah!» — bëri Salikoja.

«Mor po ta ndezim, — tha xħaxħai i Remziut, mē plaku nē atē rreth burrash, — ta ndezim si atē-herē nē peracionē e dimrit, hajde peracion, hajde, hajde lufté, hajde». Plaku tundi dorën mbi koké sikur merrte vallen.

«Kēno!» — thirri Remzi Tagani. Kēnoja kérceu si mbi sustē nga cepi i postes ku rrinte e u vērvit drejt derēs. Pas njē hopi oxhaku bramulliti nga zjarrri i druve tē thata dhe burrat e ardhur, tek e shih-nin tē qeshur, u shtynē pas. Pastaj burrat drodhēn përséri duhan dhe pleksen bisedēn. Salikoja u interesua pér gjendjen e fshatit, a kishte mbaruar ndertimi i shkollés sē re, si shkonin me detyrimet e shtetit, q'kishte mbjellē sivjet Remziu. «Ruga do t'ju vijē, — tha, — do t'ju vijē qē sivjet mē Shtembər, u fjalosa me kryetarē e komitetit tuaj», — tha. Remzi Tagani fliste, qeshte, dridhte cigare dhe herē-herē u hidhte nga njē sy vetētimthi miqve kur ata s'e shihnin, si tē donte tē vērtetonte atē diċka qē i kishte lindur nē mendje vizita e papritur. Por njē herē vēshtrimet e tyre u ndeshēn.

«Tē kam dashur e tē dua, o Telo, dhe unē e di, qysh do tē ta prish qejfin,... po q't'u lips ty tē bē-hesh doręzénēs i kësaj pune?!» thoshin sytē e Remziut. «Ta njoh kokén mirē unē, o Remzi, e di qē e kam vēshtirē vērtet, por nē këto pozita kemi qenē shumiē herē tok». «Ashtu ēshtē, por s'qenka njelloc, or, jooo. Atēherē ishte puna pér vatan e pér nder. Sot ēshtē mē e ngatērruar, fundja unē njeriu s'i prish

punë, kush të dojë le të hyjë atje, unë kisha pak tokë, pushteti, që të na rrojë sa malet, më dha sa kam tani, punës i them «peqe»!, detyrimet i shlyej; më mirë se kaq nuk dua, or, jooo». «Nuk luftuam vetëm pér kaq, o Remzi Tagani, nuk luftuam vetëm pér vete».

Të dy ata shiheshin në sy që nën vetulla. Një kushëri i Remziut po fliste pér ndryshimet e fshatit. Plaku ia mori llafin nga goja dhe përsëri vërtiti dorën mbi kokë:

«Ashtu éshtë, o të keqen, ashtu, të mira boll, ore, që s'i kishim parë kurrë më parë, shkollë do a, doktor do a, dyqan do a? Të gjitha i kemi, ore, të gjitha...; po kjo kuprativa na nakatosi një çikë tanë po...»

Në odë ra heshtja. Plaku shihte kokat e ulura të burrave. Dëgjohej vetëm zhurma e zjarrit që po mekej në oxhak. Gjer në atë kohë të gjithë kishin folur e kishin qeshur, kishin pyetur e ishin përgjigjur. Po atë, «kuprativën», s'e kishte ngarë e s'e kishte luatur njeri. Dhe ja, del ky xha Bazja, e si kot e shpie fjalën atje te kooperativa. Telo Koprënckës i erdhi pér të qeshur, bile qeshi dhe me zë. Salikoja e pa me habi. Burrat vunë buzët në gaz. Telo Koprëncka vazhdonte të queshte.

«Pse qesh, o Telo Koprëncka?» — tha Remzi Tagani dhe kërciti kutinë e duhanit.

«Qesh se më vjen qudi që goxha burra të lozim si fëmijët, me të fshehur. Ne kemi ardhur pér kooperativën, o Remzi Tagani».

Heshtje. Remziu i shkoi gjuhën letrës së cigares. Heshtje.

«E dija, — tha ai rëndë e ulët, — dhe s'jeni ju të parët që vini pér këtë».

«Remzi, ti je burrë i mençur dhe e kupton, — u hodh Salikoja. — Partia bën thirrje, apo jo, këtu nuk ka asnjë xhustifikim.

«E kuptoj, o shoku Saliko, e kuptoj», — tha nëpër dhëmbë Remzi Tagani. Të gjithë burrat shihnin nga ai.

«Ju keni frikë nga kooperativa se s'i njihni të mirat e saj. E drejtë, njeriu ka frikë nga e panjohura, po, e drejtë. I thashë dhe sekretarit të rrëthit, po, i bëra pyetje, t'i shpini, i thashë, po, po, t'ju shpien të shihni fshatrat e tjera që janë kolektivizuar. Kolektivi është forcë kolosale, njeriu i vetëm është zero, po, njëshi zero, fyl, thotë Majakovski, poeti i madh Majakovski, e di Majakovskin? Ja kështu thotë, njëshi — zero, fyl, s'bën dot gjë».

«Nuk e njoh unë atë Jakovskin, o shoku Saliko, jooo, po di këtë unë, që jam mirë sa s'ka ku të vejë, me shtëpi e katandi, me fëmijë e farefis. Më thuaj, ç'do më japë koprativa mua? Do jem më mirë se ç'jam sot aty?» Remzi Tagani rrahu pëllëmbën pas çapokut të tij.

«Aa, — bëri Salikoja, — ti, Remzi, ke dyshime, po, ke dyshime. Ti dyshon në fjalët tona, në fjalët e Partisë, a? Kooperativa është begati, ore; ja, ti hy në kooperativë dhe...»

«O Telo, edhe ti kështu thua?» Remziu zgjati drejt tij dorën i nervozuar. Teloja shoi cigaren pas vatrës.

«Dëgjo, o Remzi Tagani. Po të hysh në kooperativë, ti dhe familja jote s'do të jeni më mirë se ç'jeni tanë». Heshtje. Sytë e Salikos u hapën pa masë dhe ai luajti nga vendi, po dora e Telos e preku në bërryl. «Më keq do të jesh, po, këto vitet e para, sa të marrë veten ajo e të mëkëmbet. Nuk do t'ju vijë

rehati e bollëku fap, si nga qelli, or, jo. Pa do lodheni, pa do djersini, po ama të gjithë tok, si dje në luftë, o Remzi. Në fshat nuk janë të gjithë si ti, o Remzi. Ti e di Bedo Asimnë, Mysyl Adipnë e të tjerrë. Edhe ata s'janë më pak punëtorë se ti, por kanë më shumë kalamaqër për të mbajtur, kanë më pak krahë pune dhe janë më keq se ti. Dhjetëra familje të tjera do të jenë më mirë se ç'janë në kooperativë. Më pas, do të jesh edhe ti më mirë se ç'je. Po të shikojë secili punën e tij, tokën me syrin lakmiqar, do të vijë puna që pas disa vjetëve duhet të gremë prapë një luftë kundër bejlerëve të rinj, të dalë nga gjiri ynë, o Remzi. Partia di ç'bën. Vetëm në gjurmët e saj dilet nga pylli i kohës». Dora e Telos rëndonte mbi gjurin e Remzi Taganit. Djali i madh i tij mend i hidhej në qafë Telo Koprënckës, me fytyrën e ndezur prej kënaqësisë. Burrat e tjerë të shtëpisë kishin ulur kokat dhe shihnin nëpër qerpiqë Remzi Taganin.

«Të lumtë goja, o Telo, Koprëncka!», — tha kryetari i këshillit. Heshtje, Dëgjohej «krrak-krraku» i shpeshtë i një kutie duhani.

«Të lumtë pushka, o Telo Koprëncka!, — foli Remzi Tagani kokulur. — Në këtë vatër kanë ardhur shumë njerëz e janë përpjekur të ma mbushnin mendjen. Por të gjithë ma kanë bërë shesh me lule këtë koprativën. Ti më fole drejt, o vëlla. Kështu dua unë. Diç më mbante të mos e bëja çapin. Ti ma dhe shtysën. Na qoftë pér hajër. I koprativës jam».

Burrat u ngritën në këmbë dhe u përqafuan.

«Kënooo! Pushkën!», — thirri Remzi Tagani. Në dhomë u bë zallahi. Burrat i rrithnin krahët sho-shoqit dhe flisnin të gjithë njëherësh. I zotë i shtë-



pisë u var në dritare dhe shtiu tri herë «bam, bam, bam»! me belxhikun e tij të luftës. Pastaj doli në prag të odës i skuqur në fytyrë dhe u thirri grave:

«Bulkën, o gra! O burra!», — dhe vajti e u ul përsëri në mes të gazit.

USTA JORGJI

«Edhe unë dikur kam besuar në zot, inxhinier.» Unë buzëqesha dhe e pashë usta Jorgjin duke picërruar sytë.

«Po, po, — tha ai, — mos të të duket çudi, ja që kam besuar.» Ai heshti një hop. Duart e tij të mëdha e të rreshkura bënë reflekse mbi fibrën e lëmuar të tavolinës. Ne të dy pinim kafe në turizmin e qytetit.

«Kam besuar, or bir, kam besuar.» Ai i tha fjalët thellë, thellë, sikur i nxirrte nga një pus të cilit s'i dukej fundi. «Më vjen turp kur e mendoj. Po njeriu është një gjë më vete, o inxhinier. As vetë s'e di se qysh, po ja,... ty dua të ta them këtë gjë, unë edhe kur më bënë hero, besoja në zot, ta dish.»

Vitet e fundit unë punova tok me Jorgji Sotirin në vende të ndryshme, me atë, usta Jorgjin apo barba Jorgjin, Heroin e Punës Socialiste, duart e të cilit kishin punuar në shumë objekte të vendit. Dhe më dukej se e njihja mirë atë njeri tashmë të plakur, me ato rrudha të thella në fytyrë, me qafën me damarë mavi si të prerë në rombe-rombe dhe me atë buzëqeshje karakteristike të fshehur diku nën lëkurën, nën sy, nën buzë, buzëqeshje që s'ishte kurrikund e që

prapë ishte kudo e shoqëronte fjalët e tij dhe punët e tij. Dhe ja q'më thotë tani. Sa i paditur është njeriu kur thotë se ai i di të gjitha.

«Kur bënë luftë Partia dhe Rinia me fenë, thashë mirë ua bëjnë, edhe priftërinjtë dhe hoxhallarët soj hajduti e soj dhel pre kanë qenë. Po zoti është tjetër, thosha. Ai është atje lart dhe ujdis gjithë jetën e dynjasë. Se, fumi i fundit, prifti dhe hoxha q'ishin. Ja, merre një maskara dhe vishe prift, q'do të presësh prej tij. Bile, dëgjo mua ti, më të shumtët e priftërinjve dhe hoxhallarëve, më preftë mua, as që besonin në ato që thoshin. Po e kishin gjetur një zanat dhe me atë zanat rripnin njerëzinë. Po unë kryqin e mbaja dhe zotin e besoja. S'është e mundur, thosha, gjithë kjo dynja të mos ketë një mekanizëm që ta ujdisë, ja, pa shih ti, që nga miza e dheut gjer te njeriu, që nga kokrra e rrëres gjer të dielli dhe yjet. Pas ditës vjen nata, pastaj dita; ka një dorë këtu thosha. Zoti është diku lart. Ai i sheh të gjitha dhe i di të gjitha. Po ç'të thashë, njeri s'më kishte kuptuar. Këndoja më të rrallë librat e djalit, po më ngatërohej mendja më keq. «Barba Jorgji, — thoshin, — s'i sheh dot me sy priftërinjtë». Dhe ashtu ishte. Po s'është prifti, feja, o bir. Dhe mos më beso po deshe, po ja që unë... Jorgji Sotiri, besoja më zot. Atë kohë punoja shpesh larg shtëpisë. Pastaj më bënë hero e më dhanë yllin. E ç'nuq bëri kjo Parti pér njerëzit, o bir. Natën, kur s'më shihte njeri, e hapja kutinë dhe e shihja atë yll të bukur me pesë cepa. Më lozta një gjë këtu brenda në zemër dhe sytë më visheshin. Po kryqin akoma e kisha. E kisha futur thellë nën setrën e leshtë që mbaj dimër, behar poshtë këmishës. Kështu, që thua ti. Është një çudi e madhe njeriu, sa s'mendohet dot. Mirëpo ato kohë, ky njeri, që është

një çudi e madhe, vajti në Hënë. E pamë në televizor. «Hajde baba, — tha, — pa shihi këta. Janë në Hënë.» Ata njerëz lëviznin si kukulla, hop, hop. I shqeva sytë. Net të tëra shihja Hënën kur hidhnim betonin Ajo rrinte atje larg, në mes të qiellet, me ca njolla si të murme në bark. Njerëzit lëviznin në Hënë. Ku qenka ky zot, thashë. «E ke një hall, o barba Jorgji, — më thosh Zaçja, ndihmësi im, — e ke, e shoh unë, po për hajër të daltë». «Asnjë hall s'kam, o bir, — i thosha, — ç'hall të kem unë?! «E, e, — thosh ai, — se mos do mend shumë ta kuptosh këtë.» Dhe qeshte me djallëzi. Po unë vërtitesha e vërtitesha. Mbështetje zoti thosha i duhet njeriut të paditur, njeriu që di, s'ka ç'e do zotin. Seç ishte një festë... nuk e mbaj mend. Plaka më hekurosi kostumin. «Vëre yllin, — tha, — dëgjon? Kur do ta vësh tjetër?» Dhe e nxori nga kutia dhe e fshiu me një copë të leshtë. E shihte dhe i gëzohej atij plaka. E mora dhe e mbërtheva. «Dale, — tha plaka, — dale se e ke shtrembër.» E ujdisi dhe unë zbrita shkallët. Tek zbrisja ashtu, ndjeva në gjoks prekjen e kryqit. S'di qysh më erdhi, po ndjeva që më hipit të nxehjtët sa s'bëhej. Ky yll, thashë, që ma jep populli e Partia, mbi këtë kryq që, dreqi e di se kush ma ka dhënë, kjo sïkur s'vete. Është turp. E hoqë yllin dhe e futa në xhep. Nuk të turpëroj ty, jo, i thashë. S'më zuri gjumi atë natë. Vërtitesha si mbi gozhë. Të nesërmen, ika pa gdhirë, kishim betonim te këmbla e mesit e urës. Vazhduam gjersa u gdhi. Atje i mendova të gjitha dhe një herë.

Atë kohë, zotin e kisha fshirë nga defteri. Po për kryqin ama, diç ndieja. E kisha mbajtur një jetë të tërë. E ç'të mirë i kisha parë unë atij?! Të mirë u pashtë këtyre, — ai ngriti lart pëllëmbët e tij, — dhe Partisë, që i bëri drithë, ore. Në djall të vejë, thashë. Turp

o Jorgji Sotiri, turp që e mban akoma. Dhe futa dorën nën setër dhe e hoqa atë të flamosur kryq. E mblojdhë në grusht dhe kur gjeta rastin e hodha brenda kallëpit. Asnjëri s'më pa. Përmbi të ra betoni i betonierës që punonte Zaçja. Më mbetën sytë atje një copë herë. Po i kisha menduar të tëra ama. Jo vetëm ata priftërinj e hoxhallarë, po edhe ai kryq i ka sjellë dëm njerëzisë. Le të rrijë atje dhe le të shkojnë makina e treua mbi të dhe le t'i rëndojnë, se më duket sikur marr një farë haku kështu.»

Usta Jongji vërtiste nëpër gishtërinj filxhanin e kafes. Në fundin e filxhanit, nxinte llumi i kafes së pirë. Unë e pashë në sy atë po ai i hoqi sytë dhe pa përsëri diku në fund të filxhanit. Dhe unë u përpoqatë mendoja atë kryq, që kushedi sa vjet ndenji në gjoksin e këtij njeriu dhe tani rri i ngujuar atje në beton dhe rënkon nën lëvizjen e vrullshme që bëhet mbi urë, nën njerëzit, makinat.

«Tani thém që në këtë dynja njeriu i ka në dorë të gjitha, o inxhinier, njeriu, po, njeriu që e ka një kokë të mengur, si Partia jonë. Tani unë kam yllin e saj dhe e mbaj ballëhapur. Ishim ibudallenj dhe e kërkonom zotin atje lart. Zoti është këtu, o bir, jam unë, je ti, është Zaçja, i gjithë populli me Partinë që na hapi sytë.»

Barba Jorgji kishte vënë dorën e tij mbi timen dhe mua, për të parën herë, m'u duk se ai ishte një plak i bukur e plot nur.

TRI LETRA

Letra e parë. E dashur Ket! Kam dhjetë ditë që jam ndarë prej jush dhe më duken si dhjetë vjet. Më duket si çudi dhe sikur s'më besohet që jam këtu, që zgjohem në mëngjes dhe nuk shoh Dajtin, si deve me dy gunga, po lloj-lloj malesh të tjera, me dreqi e di se ç'emra. Po realiteti është realitet, moj e dashur: Gladiola Stefa, vajzë e bukur tiranase, 22 vjeçe, beqare, ndodhet në Petanisht (duket nga emri se ç'është!), fshat malor, 130 kilometra në vijë ajrore larg me Tiranën. Është e tmerrshme, Ket! U thashë në shtëpi, luani vendit, se ju iku çupa. Ata po hiç, s'e vunë ujin në zjarr. Na tani.

Kur erdha këtu ishte ditë e martë. U thashë se kam pasur mamanë sëmurë ndaj isha vonuar. Më takoi kryetari i kooperativës. Veç të shohësh, moj aman. Ka një palë mustaqe naaa, dhe orë e çast përsërit shprehjen: «topi s'e lun», sikur tërë jetën të jetë marrë me topa e mitraloza. Aman, moj Ket, atij i dukem si kooperativiste. Më foli për historikun e fshatit dhe gjendjen e kooperativës. Unë tundja kokën. Shkolla është e re po e shëmtuar. E kanë ndërtuar vjet, po pa pikë gustoje. Jemi katër arsimtarë. Një është vendëse; pu, pu, me të s'rrihet, s'ke ç'muhabet bën. Dy të tjerët, një vajzë e një djale janë nga këto zonat këtu pranë. Jonuzi, kështu quhet djali, është

një karafil i gjatë, me një piko hundë që veç në filma e sheh. Ditet e para se si më shihte, le po donte dhe të më tallte maloku, pa le, më thoshte: «Zonjush Gladiola!» dhe përdridhët buzët. As i flas fare tani. Harrova të të them për drejtorin. Ai është nga një jshat tjeter një orë e gjysmë larg. Mban një kravatë që më zë të vjellët kur e shoh. Ka mbaruar të lartën për matematikë po s'ma ha mendja se ia shkrep andej. Rri si guak e të dëgjon, pastaj në fund thotë dy fjalë, sikur të ketë zbuluar një planet. Veç ta shohësh. Sa për nxënësit, as të vjen t'u bësh mësim. Se mos e kanë mendjen për shkollë ata, për dhi e për dhen e kanë, jepu dhitë dhe hë... lëshoji malit. Aman, moj Ket! S'duroj dot. Ta dish që do më gjejë ndonjë gjë këtu. Natën mbuloj kokën me batanije dhe qaj e qaj. Flemë në një dhomë me Lulen. Të shtunave ajo shkon në shtëpi. Atëherë mbetem vetëm dhe i vë dollapin derës. Ç'të të them, moj Ket?! Këtu të gjithë të shohin sikur të kesh zbritur nga yjet. Më thirri sekretari i Partisë së kooperativës dhe më tha ta hiqja «at fije hekri prej kaptine» domethënë koronën e flokëve. «Pse, i thashë, kjo e paska penguar kooperativën tuaj që t'i shkojë puna mbarë?!

«Jo, tha, po asht shenjë borgjeze.»

Ja, Ket, në këtë fshat është Gladiola Stefi. Të mërzita, ë? Epo mërzitu dhe ti një çikë se unë po luaj mendsh fare. Ç'kemi asaj Tirane? Po ti vetë a del mbasditeve? Ç'ka dalë ndonjë film i bukur andej? Aman, Ket, më shkruej sa më shpejt e sa më gjatë, që të kem mundësi ta lexoj nja dy ditë, të paktën, letërën tënde. Epo ç'të bëj dé? Këtu s'ke me kë shkëmben dy fjalë. Kalo nga shtëpia dhe pyeti a e kanë marrë letërën time, se sikur s'po bëhen të gjallë. Le të qajë mamaja tani, mirë iu bë. Aman, Ket, më

shkruaj për gjithçka. Të fala të gjitha shoqeve. Uh, se harrova, Tos Latifi është këtu në një fshat të rrerhit. Më kishte dërguar të fala. Kështu pra, Ket, mos më harro. Adresën e ke mbi zarf.

Të përqafoj fort, fort
Gladi yt (e mërzitur)

Letra e dytë. E dashur Ket! Me shëndet jam mirë. Këtu tani bën shumë ftohtë. Kudo ka dëborë. Nganjëherë duket shumë bukur. Kur sheh dëborën këtu, asaj së Tiranes duhet t'i thuash jo dëborë, por pluhur shkumësi. Më ka marrë malli shumë për ty e përtë gjithë. S'besoja se mund të duroja pa ju parë përafro katër muaj rresht. Ti më thoshe në letër që të mos qahem, pooo, e ke kollaj ti, pa hajde një herë këtu provoje. Ka nevojë këtu dhe për ekonomistë. Meqë ra fjala, është një llogaritar, vendës është, është simpatik. Një ditë tha një shprehje të Çehovit. M'u duk si çudi. «E njeh Çehovin ti?» — i thashë, «E njoh, — tha, — kemi bërë bashkë ushtrinë.» Lulja me Jonuzin ia dhanë gazit. Më erdhi inat dhe i thartova turinjtë. Po ai deshi të më zbuste; «Po Çehovi nuk shëtit vetëm në bulleardin «Dëshmoriët e Kombit», moj Gladiolë, apo jo?» Thonë për të që është djale i mirë. E quajnë Demo, Demo Benda (çfarë emri, ë?).

Kemi pasur shumë punë këto kohë. Nxënësit vijnë nga larg, një pjesë bëjnë një orë rrugë. Aman, moj Ket, të vjen keq për ta, ecin nëpër dëborë. Unë u ndez sobën dhe i vë të rrinë rrreth saj sa të marrin veten. A e di si më thërrasin ata? Zysh Jola. Drejtori u heq vërejtjen. «C'është, more, kjo «zysh Jola»? Mësuese Gladiola thoni, mësuese Gladiola!» Po ata harrojnë dhe prapë: «Zysh Jola, zysh Jola!»

Për të gatuuar, gatuajmë këtu në dhomë. Më solli Lulja ca sallam. Hëngra një copë të madhe sa desh u mbyta, kisha kohë që s'kisha ngrënë. Nganjëherë na viziton kryetari. «Si po ia çoni rini, mirë? Topi s'e lun', bukuriii! Keni nonji nevojë, nonji hall, se helbete dimën asht topi s'e lun.» Aman, Ket, veç ta dëgjosh. Po thonë se është punëtor i madh. Në fakt, nga një cep i fshatit në tjetrin e sheh dhe nga një fshat në tjetrin (kooperativa përbëhet nga tri fshatra).

Tos Latifi erdhi një herë te ne. Ç'kemi bërë atë natë! Jonuzi i binte kitarës (u bie ca këngëve ai që allah, allah), pastaj lojtëm letra dhe ne të dyja, unë me Lulen, i mundëm Tosin me Jonuzin. Kështu, që thua ti, e kalojmë. Po ama, rri, rri dhe mërzitem, moj Ket. Se si më duket vetja këtu, larg, larg, sikur jam në Polin e Veriut. Për Vitin e Ri sigurisht që do të vij. Aman, edhe 12 ditë janë. Mezi i pres. Moi, se harrova, po deshe akrilik vishnjë, më thuaj që të ta bie kur të vij, se mora vesh që ka këtu afër, te dyqani i minierës.

C'thotë Tirana janë? Tani patjetër nëpër vitrina kanë vënë pambuqet.

E dashur Ket! Më ka marrë malli shumë; shumë, shumë. Vdiqa të të shoh ty, mamin, Benin, të gjithë. Uh, aman, se s'të thashë: Beni më shkruan letra serioze, sikur të jetë i madh dhe më këshillon të mos mërzitem, aman, veç t'i lexosh. Fundja, s'je jashtë kufirit, thotë, Shqipëri është dhe aty. E di umë të kujt janë këto fjalë, e di, ia mëson babai ato. Sa të vij, pa do t'ia shkul veshët.

Të puth fort, fort
Gladi (që së shpejti e ke aty)

Letra e tretë. E dashur Ket! Tani sapo u ktheva nga një aksion për hapje tokash të reja. Ishim tok me të rinjtë e kooperativës, Nesipi, kryetari, tha: «Msuse Gladionës (kështu ma thotë emrin ai) s'ia hakë qeni shkopin për punë buqsie, topi s'e lun', sikur me pas le me shat' n'dor'». Më shëndet kam qenë mirë. Ca kohë më ka munduar dhëmballa e fundit fare, që më doli tani. Ajo është dhëmballa e pjekurisë. Pra, siç e sheh, tani u poqa. Mos qesh, ë. S'e ke idenë sa e bukur është pranvera këtu në male. Ti, me atë damar që ke, do të shkruaje vjersha këtu. Kam qenë shumë e zënë, kemi pasur një inspektim këto kohë. Dola mirë dhe më lavdëruan. Kam ca nxënnës, moj Ket, që ke qejf t'i dëgjosh, bilbila janë, e di si e bëjnë komentin, hata fare. U çudit ai i seksonit. Kam mësuar të bëj byrek siç e bëjnë këtej. Të shkrin në gojë, kaq i mirë është. Ma mësoi e ëma e Nuries, e asaj koleges që është vendëse. Kam qenë nja dy herë në shtëpinë e saj. Ta dish ti se ç'gocë është ajo. Dëgjo, do të të them diçka. Demoja do të vijë me shërbim këto ditë në Tiranë. I kam dhënë numrin e telefonit tënd. Takoje dhe sillu mirë me të, Ket, se nuk është djalë i keq. Se mos tallesh se pale si ju duken këta njerëzit e këtushëm juve, malokë, helbete. Mos i var turinjtë, moj, se bëj shaka. Pastaj më shkruaj në letër si t'u duk. Drejtori na ka ikur. Ka ardhur një tjetër. Ai shkoi në Institut në Shkodër, në katedrën e matematikës.

Tani diçka për të qeshur: kam marrë një letër të çuditishme nga një Genc Ajazi, gjeolog. Ai flet sikur të më njihonte me rrënjen e me degë. Thotë që do të vijë me një ekip për të kërkuar një vendburim minerali këtu pranë. Pastaj se ç'thotë, sikur dhe unë qenqam një lloj minerali i rrallë e ku di unë ç'tjetër.

Qyfyre. Nuk më kujtohet fare kush është ky. Mos është ai i gjati me syze që e gjenim çdo mëngjes afër Kuvendit Popullor? Kujtohu një herë dhe më shkruaj. Kam filluar të mbaj ditar. I shënoj të gjitha në të. U, se harrova: Kam një djale në klasën e shtatë që shkruan vjersha. E ka shumë pasion dhe në fakt është i talentuar. Pesë vjersha unë ia kam redaktuar dhe ia kam shkruar pastër. I kam nisur në «Zerin e Rinisë». Ti shko dhe interesohu një çikë atje se u bë-në mjaft kohë. Djalin e quajnë Nehat Bejko. Nuk do të harrosh, ë?

Tani tjetër gjë. Po ç'thotë hidrocentrali i Fierzës, ë? Hic, ë? Vepër e madhe. Shiko, moj e poshtër, mos m'i shit mua ato. Le që e nuhata që kur isha aty unë. Nuk vjen kot burri i botës çdo javë me shërbim në Tiranë. Më vjen inat, unë e shkreta t'i them të gjitha ty, kurse ti... Nejse, mua më mirë më bëhet. Po erdhe në Fierzë ti, të kam dy herë më afër se tani që je në Tiranë. Kam një ide. Po e more lejen tani, siç ta kanë planifikuar, hajde këtej nga unë. Do të kënaqesh, ta dish. Mendoje dhe më shkruaj. Do të të mbajmë mirë, moj budallaqe. Do të të shpie lart në stan. Atje janë ca djem shumë të mirë! Vetëm që janë të turpshëm, si çupa të padala. Ke ngrënë kos që ta presësh me thikë ti? Hajde, Ket, se nuk do të bëhesh pishman. Më shkruaj. Po e mbyll tani se kam një tog hartime për të korrigjuar. I kam thënë masë për ca libra, ndihmoje dhe ti se mos m'i gjeni. Të fala të gjitha shoqeve dhe shokëve.

*Të puth e të përqafoj
Gladi (që të pret të vish)*

NJEREZ MBI OXHAK

Tre montatorë punonin në majën e oxhakut të lartë të kombinatit. Mbi qytet shkëlqente dielli. Ata të tre kishin kohë që ishin mësuar ta shikonin kësh-
tu qytetin, t'i shihnin kështu nga lart rrugët e tij,
njerëzit që lëviznin nëpër rrugë. Gjoksi të mbushej
me ajër dhe poezia, sic thoshte Edi, sekretari i rinisë
së brigadës së montimit, ishte afër, fare afër, e, ndërsa
thoshte kështu, Edi zgjaste dorën në hapësirë sikur
të donte ta prekte atë. Shokët qeshnin. Ata kishin ko-
hë që punonin te ky oxhak dhe çdo ditë ishin ngjitur
më lart, tok me rritjen e shtatit të tij. Dhe tani kishin
mbërritur te kreu i oxhakut, i cili së shpejti përfun-
donte, së bashku me uzinën e kombinatit.

Edi zgjidhi litarët e lidhur nën sqetull, fshiu
duart me një pece dhe tundi kokën me bezdi.

«Ç'ke, Edi? — Zana e pa duke kapsallitur sytë
nga dielli. S'të pëlqen të zbrazësh? Bëju një telegram
që këtu, s'vij dot thuaju.» Ajo tregoi me dorë. Edi
qeshi dhe pa poshtë qytetin. Vërtet, ja tek ishte ko-
miteti i rinisë, ajo godina atje. Të dukej sikur, po të
mblidhje një gur në një copë letër dhe ta flakje, bin-
te tamан në dritaret e tij.

«Në ç'orë e keni?» — pyeti Maksi dhe shtrembëroi fytären duke shtrënguar një bullon.

«Në dymbëdhjetë.»

«Epo, nisu atëherë», fiu!» Maksi fishkëlleu dhe tundi dorën. Edi rregulloi rripin e pantallonave dhe u var te shkallët.

«Kujdes, o çuna! Kini mendjen, se vërtet poezia është afër, po për dreq janë afër dhe ca gjëra të tjera që s'na pëlqejnë.»

«Hajde, pa zhduku tan!» — bëri Zana dhe qeshi.

«Kini kujdes, Zanë, me gjithë mend e kam.» Ai rrudhi ballin me një shprehje të tijën karakteristike dhe koka i humbi poshtë skelës. Një copë herë u ndje fishkëllima e tij. Ishte një nga këngët e festivalit të fundit. Zana ktheu kokën dhe pa sytë e Makshit. Atij i shkoi një i kuq në fytërë. Kishin dy vjet që punonin në një brigadë. Maksi ishte një djalë që prekej shpejt, impulsiv e që ndonjëherë rrëmbehej lehtë.

«Zanë, — tha ai, . . . — është hera e parë që mbetemi vetëm të dy, kështu, apo jo?» Zanës iu mpi këmba e majtë. Ajo u kthyte dhe u rrotullua në skelen e ngushtë me një shprehje bezdie në fytërë.

«Ç'ke?» — tha Maksi.

«Hiç, m'u mpi këmba.» — tha ajo dhe qeshi. Maksi vuri buzën në gaz pastaj gazi befas iu shua dhe në fytërë i kaloi përséri një fashë e kuhe. Ai hoqi litarin e sigurimit nga gjoksi.

«Kur të mpihet këmba është kollaj, po ç'të bësh kur të ndodh më keq.»

«Si më keq, Maksi? Sot qenke bërë filozof.» Ajo qeshi me një farë habie dhe anoi kokën që të mos i binte dielli në sy. Flokët, që i kishin dalë nga shamia, ia mori era dhe ia mblođhi prapa veshëve.

«Sepse mund të të mpihet zemra, Zanë, dhe... dhe s'ke ç'i bën asaj.» Maksi belbzoi flakë i kuq në fytyrë. Ai e kishte lënë çelësin dhe diçka ndukte me nervozizëm mbi një dërrasë të skelës. Zana e zbuti të qeshurën dhe mbeti në një shprehje midis habisë dhe të një diçkaje të padëshirueshme. Ajo ndjeu shqetësimin t'i luante brenda vetes. Sytë e Maksit kërkonin tanë sytë e saj. Poshtë u ndje fishkëllima e Edit. Ai tundte lart të dyja duart për ta dhe dukej i vogël, i vogël në sheshin me pluhur të kombinatit. Zana qeshi e sfocuar dhe diçka tha për të. Po Maksi s'e kishte fare mendjen tek Edi dhe fjalët e saj për të.

«Zana, — pëshpëriti ai, — ... nuk duroj më, Zanë, unë të dua... nuk e ke kuptuar ti?» Dora e tij e djathtë bëri një lëvizje të vrullshme dhe një ashkëlë dërrase iu ngul thellë në mish. Ai e hoqi dhe në dorë i rrođhi currili i gjakut. Vajzës iu dëjersitën temblat dhe mollëzat e gishtërinjve. Ajo vështroi poshtë dhe mendtë iu morën njëlloj si atë ditë kur kishte hipur për herë të parë mbi oxhalk dhe xha Nihatit e mbante pranë e s'e lëshonte nga vetja. Ajo pa gjakun në dorën e Maksit dërrase iu drodh ibuzua.

«Lëre! — tha Idali, nervoz e tashmë i zbehtë në fytyrë, — lëre, ç'rëndësi ka kjo. Më dëgjove ç'të thashë, Zanë?» Sytë e tij kishin një shkëlqim jonormal. Ajo i mori dorën dhe u përpoq t'i lidhte shaminë mbi çarjen, ku kishte nisur të mpilkjese gjaku.

«Të dëgjova, Maks», tha ajo pa e ngritur kokën. Djalit i dridhej trupi. Ai u hoq praptas. Vështrimi i tij që i mjegullt dhe ai s'shihte ku vinte këmbët.

«Domethënë, Zanë...» — Zëri i tij kishte një nuancë të tillë që dukej sikur ja... tanë ai do të klithete me sa kishte fuqë.

Ajo ngriti sytë dhe pa sytë e tij. «Si s'e kam ditur, si s'e kam kuptuar këtë gjë?!» belbëzoi zëri brenda saj. Frynte erë. Nëpër qìell shplekseshin ca re të yogla si tym i bardhë. Dhe poshtë ishte tokë. E mira, e dashura, por... e forta dhe e ashpra, kur nga lartësia vinte e përplasej mbi të një trup njerëzor. Zanës i mbeti zëri në grykë. Ajo e ndiente zemrën t'i rrihte me vrull, e ndiente në gjoks, në kokë, në krahë, në duar. Maksi kërkonte përsëri sytë e saj. Herë-herë ai bënte lëvizje të vrullshme, nervoze dhe në laringun e vajzës në qdo çast të tillë artikulloshin ca pasthirrma që vinin e i shuheshin në buzë.

«Maks, dëgjo, Maks, ...» (Sa e vështirë është të gënjesh.)

«Jo, Zanë, s'kam c'dëgjoj... më thuaj, më do ti, Zanë?» Trupi i tij dridhej. Dridhej dhe dora e vrarë, ku varej e palidhur mirë shamia e Zanës.

«Po, Maks,... të dua, po dëgjo...» — Sytë e vajzës ishin të mëdhenj e të mbushur me lotë. Shamia i kishte shkarë prapa në zverk. Djali mbeti një çast pa fjalë.

«Zana... vërtet, Zana?!» Zëri i tij mori ca, nuanca të çuditshme. Ai mori frymë thellë-thellë, saqë u kollit. Vuri pëllëmbët e veta pranë kokës, sikur të kishte frikë se mos i ikte ajo nga supet.

«Vërtet, Maks, po... prit, e bisedojmë poshtë. Nuk dua ta bisedojmë këtu.» (Po c'faj kam unë, Maks, pér këtë? A kam faj unë, në qoftë se dua një tjetër dhe ty të kam parë kurdoherë vetëm si një shok të mirë e kurrë s'më ka shkuar mendja pér ndjenjat e tua?)

«Oh, Zanë, më mjafton kaq, ti më do? Thuaj, thuaje edhe një herë!» — Zëri i tij u zvarris nëpër lutjen dhe dora i lëvizti drejt flokëve të saj valavitës.

«Mos, Maks, tē lutem... — Në sytē e saj kishte një lutje më të madhe se ç'thoshte goja e saj me fjalë. — Mos, le të punojmë tani, ... duhet të mbarojmë, u dhashë fjalën shokëve.»

«Pra ti ... Zana, më beso...»

«Të besoj, Maks, të besoj.» (Ç'bimë e çuditshme është dashuria. Ti nuk kë faj. Po mos vallë e kam unë fajin!?) Ajo ia shtrëngoi në dorë tē dy cepat e shamisë, i lidhi në gjoks kombin dhe i zgjati çelësin që ai e kishtë lënë aty pranë. Punuan kështu gjeri në orën tre. Ajo ndiente kudo, në çdo pellëmbë tē trupit, sytë e tij.

«Kujdes, Maks, — thoshte ajo herë pas here, — hajde më brenda skelës.» Ai buzëqeshë si në ëndërr. Vajza punonte dhe çdo sekondë i dukej si një hapësirë gjigante që donte shumë e shumë kohë tē përshtkohej.

Ajo erdhi dhe e kërkoi atë pasdite në shtëpi. Maksi rehidi me vrap me xhaketënë në dorë.

«Zana, pse më ike ashtu qëparë, kur zbritëm? Unë...» — Ai përpinqej tē fuste krahun në mëngën e xhaketës. Vajza shikonte drejt përparrë vetes si e përqëndruar diku.

«Tani do tē ta them, — tha ajo e qetë dhe ktheu sytë nga ai. — Hajde, — shtoi — mos rri kështu, hajde ecim.» — Ajo i shkundi krahun dhe e tërhoqi. Ata dolën tē dy në rrugën kryesore. Vajza filloi tē fliste e qetë e duke zgjedhur fjalët. Në fytyrën e Maksit u shfaqën pulla tē kuqe.

«Si?... — atij iu zbeh zëri. — Ti dashke Nandin, shokun tim dhe unë s'di gjë?!» Vetullat e tij u bënë xhunga mbi sytë.

«Qetësohu, Maks, dhe mendoje më gjerë këtë gjë. Ç'faj kam unë këtu?! Unë e dua Nandin dhe ai më domua. Së shpejti fejohemi. Të kam dashur gjithmonë, por si shok, Maks, vetëm kaq. Sot atje... — vajzës iu mbushën sytë me lotë... — s'kisha ç'të bëja, Maks.»

«S'kisha ç'të bëja, ashtu? Dhe u talle me mua... Po, ti... po ti më the...» — Ai klithi.

«Pusho! — foli ajo këtë herë. — Pusho! Dëgjon? Kalama! Të thashë ashtu se të dua si shok, të dua të jesh i gjallë e jo të copëtuar poshtë oxhakut.» — Vajza u shkëput prej tij dhe eci përpara:

«Zanaaa!» — bëri ai si me vete. (Pse të më ndodhët kështu?!) Pastaj vështrimi iu kthjellua ngadalë dhe pa përpara, larg, konturet e saj (Na ishte një vajzë që e quanin Zanë.) Mendimet e ndjenjat u kapërtihyen brenda atij shpirti njerëzor. (Po unë e desha atë, e deshal!) Ai nisi të ecte rrugës e mendime të shumta i vërshuan në kokë. Mund të ndodhë që të nesërmen ai të shkonte e t'i shtrëngonte dorën asaj çupe, asaj shoqjeje të mirë me një «më fal!» të madh në sytë e tij. Mund të ndodhët kjo? Sigurisht që mund të ndodhët.

... . — S'juqat K. mështer i sektorit M... 1960 r. është shkodra. O sëmundje te gjithë e mështerit është që "në kohën e marrëveshjes së përgjigjet e tij, qëndrueshëm është që tashmë nuk ka qëllim e përgjigjet e tij, qëndrueshëm është që tashmë nuk ka qëllim e përgjigjet e tij". H. mështer i sektorit M... ka qëllim që të bëjë qëndrueshëm që tashmë nuk ka qëllim e përgjigjet e tij. Ai vishet që një mështer...

KANARINA

Sekretari ngjiti shkallët për në zyrën e tij. Ai kishte lajmëruar shoferin se pas dy orësh do të nisë shin për në kooperativën malore të Gallxhi. Atë dite koha kishte marrë për mirë. Pranvera atë vit po vinte ngadalë e si me druajtje. Kishin rënë shumë shira dhe mjaft punë të bujqësisë kishin mbetur prapa. Ai hapi perdet e dritareve dhe pidoqi një copë herë me sy lëvizjet e makinave të gurores. Pastaj u ul në tryezë dhe mbështeti bërrylat në të. Në mendje i shkoi gjithë panorama e jetës së rrëthit.

«Në përgjithësi, më industrinë i kemi më mirë punët, — tha, — Ajo iniciativa e kombinatit të drurit duhet mbështetur». Ai shënoi diçka në faqen e blokkut-kalendar. «Po. Duhen dënguar më shumë shokët e aparatit në bazë. Në uzinën mekanikë kanë prodhuar një agregat të ri. Nëse do të japë rezultat, të mendojmë nëse mund ta prodrojmë në seri. Ata të fermës kërkonin diçka të këtij lloji». — Ai përsëri shënoi në bllok me një shkrim të shpejtë e të pjerrët. «Duhet lajmëruar drejtori i parkut. Transporti s'po u pëngjigjet sa duhet punimeve imbrojtëse». — Ai ngriti dorezën dhe vërtiti numëratorin e telefonit me po atë dorë.

«Mirëmëngjes! — tha. — Jam Kanan Buzi»... «Faleminderit, si jeni ju? O shoku Stavri, të mora për atë çka biseduam pardje... Si? Jo, nuk e lamë fjalën kështu. Dje ti nuk ke dërguar aq sa c'biseduam... Po... Domethënë sot kanë shkuar dhjetë, apo jo?... Mirë. Gjithë këtë javë mos i ndërprit. Ç'kemi, ndonjë gjë tjeter? Si shkojnë punët atje ndër ju?... Po kjo është gjë e mirë. Bisedoje me Kasemin këtë. Hajde suksese! Tungjatjeta! — Ai la telefonin dhe shënoi përsëri diçka në bllok. Pastaj u ngrit dhe nisi të ecet nëpër dhomë. «Organizatat-bazë të kooperativave duhet të lëvizin më shumë», — tha. U përkul mbi tryezë dhe shfletoi dhe një herë informacionin e dërguar nga sekretari i komitetit të partisë të fermës se rrëthit. Nënvizoi një rresht. E la stilografin dhe nisi përsëri të lëvizte nëpër dhomë.

Kanan Buzi ishte i ri në këtë rrëth. Atij s'i bë-heshin as gjashtë muaj që kishte ardhur. Po ai kishte vite që merrëj me punë drejtuese në pushtet dhe hyri shumë shpejt në brendësi të gjérave. Tani mund të thoshte se e njihte mirë situatën e rrëthit, dinte ku ecet puna më mirë e ku më keq. Dinte ku duhe-shin përqendruar më tepër forcat e ku duhej kërkuar më tepër llogari.

«Njerëzit punojnë, — tha ai, — punojnë e përpil-gen. Bëjmë mbledhje, kritikojmë të metat, neglizhen-çat, konceptet e gabuara, nxehemi, po njerëzit punojnë». Ai u ul në karrigen e punës me një shprehje kënaqësie në fytyrë. «Ja, brigada e këtij Nduri Islamit ka heronj të vërtetë. Pse, c'është heroizmi më te-për-se kaq?» Ai shënoi mënjamë një porosi për gazetën lokale, lidhur me këtë brigadë. Ra zilja e telefonit dhe ai ngriti receptorin.

«Po... Mirë. Le të vijë.» E lajmëruan së Risto Mihali dente të takohej me të. Ai ishte përgjegjësi i stacionit të bimëve medicinale. S'para i pëlgente ky tip. Ishte nga atá njerez te përtë ngjitur, që të bez-disnia me atë lloj përkujdésjeje të shtritur. «Të lütem, të lutem... merreni një të dredhur nga kafila ime. Si, nuk e pini, shoku Kanan?... Oh, sa keq... dhe unë e zgjodha këtë lloj duhani apostafat pér ju. Sa keq!... Po mirë, urdhëroni të pimë një kafe... Si, as kafen nuk e pini? Interesant. Më cuditët, shoku Kanan. Ç'vullnet çelik që duhet të keni, as duhan as kafe, as... më cuditët, shoku Kanan». Kanan Buzi kujtoi këto dhe mblođhi buzët. Në komitetin e partisë së rrethit kishte sinjalizime pér dëmtime të pronës socialiste pikërisht në stacionin e bimëve medicinale. Pér këtë ato ditë kishte vajtur atje një ekip i kontrollit punëtor: «Dicka eshtë», mendoi sekretari. Risto Mihali u duk në derë. Ai kishte shtat mesatar, fytyrë të imprehtë dhe pa tul të tepërt. Nga cepat e syve i shpérndaheshin poshtë, në faqe, një tufë rrudha të vogla. Sytë e tij ishin gri të errët dhe kapakët e tyre linin të dukeshin vetëm gjysmat e bebeve. Buzëqeshja i tregonte në anë të gojës dy dhëmbë floriri. Kjo shprehje mund të thuhej dhe ndryshtë, pér shembull: Dy dhëmbë floriri në anë të gojës i tregonin buzëqeshjen. Këta dy dhëmbë ishin burim i shumë shakave që bënte në shokëri Risto Mihali: «Ja, — thoshta, — këto janë i vemi kapital që ka Ristoja, o shokë, ha, ha, ha». Buzëqeshja e Risto Mihalit po afrohej tanë pranë tavolinës së sekretarit.

«Si jeni, shoku Kanan?... Gëzohem. Gruan si e keni? Atë Oltionin e vogël, mirë? Eshtë në klasën e

dytë ai. Po, po, e, di, xhevahir, djalë! Më thotë ai imi, i vogli, përtë, pa, pa, pa... » Sekretari qe ngritur në këmbë dhe shkundte dorën e të ardhurit. Ai përpigjetë buzëgeshte. «Pa shih, ky ditkërka dhe emrin e tim biri...!» Ai i tregoi karrigen Risto Mihalit.

«Keni ardhur me këmbë të mbarë, shoku Kanan, po, po, me këmbë të mbarë, ja... u hap koha...»

«Po koha do të hapej, mor shoku Risto, se... bëhari është dé, sa përmua, unë bëj gjashtë muaj që kam ardhur...»

«Po, po, sigurisht». Dy dhëmbët e florinjtë të Risto Mihalit u duken. Ai vuri mënjanë një pakto të vogël që kishte në dorën e majtë. Të dy burrat u veshtruan në sy. Sekretari e pyeti përpunët e stacionit. Risto Mihali përgjigjej duke tundur të dyja duart. Ai pothuajse s'rndonte fare mbi ndenjësen e karri-
ges, po dukej se... ja... nga çasti në çast do të hidhej përpjetë sikur dikush të cilronte menjëherë një tok sustash të padukshme. Risto Mihali mori leje të ndizte një duhan. Pastaj ai pëshpëriti me gjysmë zëri se i vinte keq që s'e pinte shoku sekretar, meqë ishte duhan i mirë shumë. Po le, më mirë që s'e pinte. «Po, po, shumë më mirë, se ç'e dontë të flamosurin; ata që e pinë, janë njerëzit pa pikë vullneti. Do vullnet, ore, ta lësh, pos!». Sekretari buzëgeshi përsëri. U bë heshtje.

«Po... kishit ndonjë problem, shoku Risto?»

«Jo, jo, ç'është ajo... Po ja, na mbytën punët, ore, për ideal, erdha një herë t'ju shoh si vini me shëndet.»

«Siç e shihni, jam mirë», — tha prerë sekretari. Ai mori një shprehje të vrenjitur, por njerëzillëku e

bëri t'i ngjiste asaj vrenjtjeje një buzëqeshje të prodhuar me zor.

«Gëzohem, gëzohem shumë, shoku Kanan, të ma besoni. Edhe rrathi ka ndryshuar shumë. Këto muaj vihet re një fryshtet tjetër, veç ta shihnit, shoku Kanan. Po... sigurisht... udhëheqja, sigurisht... Ai nuk e zgjati më ligjëratën, pasi pa dy vija të thella në fytyrën e sekretarit. Kanan Buzi u ngrit në këmbë. Sustat e padukshme nën Risto Mihalin, u lëshuan. dhe ai... frrap, u gjend menjëherë i drejtar.

«Ju kam sjellë dhe diçka... diçka të vogël, shoku Kanan. Ne e kultivojmë aty në stacionin tonë këtë. Meqë erdha... thashë...» Ai e vuri pakon në anë të tryezës.

«C'është kjo?»

«Skaliol, shoku Kanan.»

«C'është ky skaliol?»

«Skalioli...? Po skalioli është ushqimi më i mirë për kanarinat, shoku Kanan. Kanarinat...»

«E pastaj... C'më duhet mua kjo?»

«Po... sigurisht, po... për kanarinën tuaj, shoku Kanan.»

Sekretari vuri duart me pëllëmbët mbi xhamin e tavolinës. Ai mori fryshtë thellë.

«Ku e dini ju që unë kam kanarinë?»

«Sigurisht që duhet të keni, shoku Kanan, po kanarina është... edhe...» — dhëmbët e florinjtë u rishfaqën dhe kapakët e syve mbuluan gjysmat e bebeve. «... edhe paraardhësi juaj, shoku... mbante dhe ai, posi. Pastaj, pastaj... shoku Kanan, odo njëri e ka për detyrë të kujdeset për eprorët e aq më tepër për udhëheqjen... ja, ju i thatë shoferit kur ishit në Tiranë që të blinte diçka për kanarinën». Sekretarit i rrihte fort një damar rrëzë veshit. Ai

vështroi një copë herë gojën gjysmë të hapur të folësit.

«Merreni këtë, — tha, — merreni, shoku Risto Mihali. Umë nuk mbaj kanarina. Kam një çupë të vogël që e quajnë Kanarinë». Ai ndoqi ndryshimin e mimikës së tjetrit. Në ftyrën e Risto Mihalit u dulk një lëvizje e rrufeshme e tipareve. Vetullat u ngritën, buzë e sipërme lëvizë lart, kurida e mprehtë doli përpara, pastaj vetullat ranë poshtë më vrull, mjekra u lëshua, bëbet e syve dukeshin e zhdukeshin nën kapakët disi të mbufatur. Kanan Buzi mendoi se sa pëk ndryshon, në aspektin formal një buzëqeshje nga një pamje e vrenjtur. Mjafton të luash diçka, diçka fare të vogël dhe ja... ke kaluar nga njëra te tjetra dhe anasjelltas. Po kjo, vetëm në aspektin formal, sepse, për të kaluar siç duhet nga njëra tek tjetra, dhe atëherë kur duhet, duhet të kesh shpirt të vërtetë njeriu. «Po ky s'është njeri — tha Kanan Buzi, — ky është një qenie e pështirë». Risto Mihali diçka pëshpëriste. Ai bëri përsëri një tentativë buzëqeshjeje. Dhëmbët e florinjtë u shfaqën përsëri. Kanan Buzi kishte kohë që s'po e dëgjonte.

«Mos harroni këtë, — trëgoi më dorë pakon sekretari. — Dhe tjetër herë mës u kujdesni kaq shumë për eprorët. Këtë kujdes të madh tregojeni atje, në mbarëvajtjen e puniёve. Tungjatjeta!» Ai iktheu shpinërin. Risto Mihali, i zbehtë dhe i pandjeshëm, deshi të thoshte diçka, për profilin i rreptë i sekretarit e bëri të ndërronte mendje. Kur Kanan Buzi u kthyë, në dhomë veç tij, s'kishte njeri tjetër. «Bah!» — shfryu me zë ihatin e tij sekretari. Ai u ul në tavolinë dhe mbështeti kokën mbi pëllëmbë. Ai shënoi diçka në bllokun e tij. Pastaj ngriti kokën dhe mendoi për afë

që vërtet njerëzit punojnë e përpiken ndershmërisht e me partishmëri, por midis tyre ka dhe të tillë, që bëjnë të gjitha përpjekjet dhe vënë të gjitha energjitet që të shfrytëzojnë vrullin e përgjithshëm, punën, detyrën për të kanalizuar në turbinën e tyre të vockël të interesit personal sa më shumë ujë nga rezervuari i madh socialist. «Vjen tjetri serbes në derë e kërkon të të komprometojë... Përpiken dhe ata me atë mënyrën e tyre të çajnë...» U ngrit dhe eci një copë herë nëpër dhomë. Pa orën. Po shkonte dy. Ai telefonoi në shtëpi.

«Kanani jam, Drita... Mirë, si jeni ju, Rina çibën? Dëgjo, s'do të vij për drekë unë. Do të kthehem vonë, mëbasi do të shkoj në Gallxhi. Epo... ç'të bëj unë? Mirupafshim... E... s'ka gjë, e ha në dardkë... Mos e lër Oltin të dalë pa bërë detyrat. Mirë ju gjetsha!»

Ai la receptorin dhe buzëqeshi më vete pa həqur dorën që atje. «Kam bérë cervish, si e ke qejfti», — i kishte thënë ajo. Përséri i erdhë për të qeshur. Ja, nëpër këtë fill telefoni, ku kishte folur e menduar për industrinë, bujqësinë, për njerëzit, vinte e përcillej kjo fjalë «cervish». Ishte një fjalë shtëpie, gruaje, amvise, një fjalë familjeje. «E megjithatë, dhe pa këtë s'bëjmë,» mendoi Kanan Buzi. Ai vështroi një copë herë jashtë nga dritaret. Vështronte dhe nuk vështronte gjë. Vështrimi i tij shuhej tej. Ai u kthye drejt derës. Pa një hop me mëdyshje përdesy-në e tij më kremastar, pastaj e mori dhe e hodhi krahëve, Zhrifti shkallët. Pas pak një makinë gulçoi drejt udhës veriore të qytetit.

ÝJET E JETËS

Iloja nixori paketën dhe nisi të vizatojë skemën. «Eshtë e thjeshtë, — tha ai, — në fakt ky është një separator, një ndarës. Ka dy bunkerë brenda njëri-tjetrit. Materiali bie këtu te ky, ja. Secili bunker e ka daljen të veçantë. Ka një aks me fletë me seksione të ndryshme. Tani dhe presionet këtu dhe këtu nuk do jenë të barabarta. Një pjesë e thërrmijave ngjitet lart dhe shkon në njërim bunker, ato më të imtat, të tjerat mbeten këtu; Kështu bëhet ndarja, kupton?»

Fatos Gjoleka buzëqeshi i menduar. «E bukur, — tha, — ... e di që e ke bukur? Po, ... po mirë, vallë, mund të ndahen thërrmijat me një kufi të prerë, domethënë këto më të mëdhatë se kaq të shkojnë poshtë dhe këto të tjerat lart?»

«Këtu është puna, këtu kam ngecur tani. Duhet llogaritur seksioni i fletëve dhe sasia e tyre. Me aq matematikë sa di unë, kjo nuk bëhet. Do të më ndihmosh ti, Tos?»

«Kur të duash», — tha Fatos Gjoleka dhe i rrahu krahët. «Ke ibërë një gjë të bukur, Ilo.»

«E..., e, kur ta bëjmë, flasim. Po ama, e di sa na

nevojitet ky në punë?! Mirë..., lëre tani se të mërzita me këto.» Ai u shtri përsëri mbi bar. Rreth e qark u ndeh errësira. Ata kishin dalë e rrinin të dy në kodrën mbi qytetin e vogël.

Fatos Gjoleka s'ia ndante sytë shokut të tij, si lumtur tek e dëgjonte që fliste me aq pasion për punën e tij.

Jo se s'qe i zgjuar, përkundrazi. Po sepse ndonjëherë bëhej melankolik, mbyllej në vjetvete dhe s'shoqërohej me njeri. Edhe mësuesit në shkollë e trajtonin disi më ndryshe se nxënësit e tjerë.

Në gjimnaz e la fare shkollën dhe hyri në punë. «Duket ka gjetur shokë të mirë atje», mendonte Tosi e s'ia ndante sytë shokut.

«Ç'kemi nga Tirana? Tani t'u afrúa fundi. Do të mbarosh e mbasë na vjen këtej. Po të caktuan në shkollë, do të më kesh nxënës të mbrëmjes. Do të të shoh ty në katedër e do të më vijë për të qeshur. Pse, thua ti? Po ja, do të më kujtohet kur qemë fëmijë dhe vidhним hurma të kopshti i papu Janit. Po kur dilte prifti i xhindosur ë ëna mallkonte me ferr e më xhehenem, ë?»

Ata qeshën të dy një copë herë. Fatos Gjoleka kishte dy ditë që kishte ardhur me pushime në shtëpinë e tij. Ishte korrik dhe netët qenë të ngrohta e fosforeshente nga drita e yjeve. Ata ndenjën një hop ashtu të menduar e me duart nën kokë.

«Sa bukur është, — bëri Tosi, — eh... sa e madhe është bota.»

«Ra një yll, — thirri Iloja, — shihe, ja!»

«Në fakt ai s'është yll. Ca thonë ta një yll, ca ra një kometë. Ajo është një copë materie e ardhur nga hapësira kozmike, që quhet meteorit dhe që duke

hyrë në atmosferën e Tokës, digjet dhe jep ndriçim që shohim është.»

«Eh, sa gjëra që s'dimë, — tha Iloja . . . , — po mire, Tos, po ky grumbull yjesh që është mbi në është Kashta e Kumtrit, apo jo?»

«Po. Kjo është Kashta e Kumtrit; hyn në galaktikë, ku bën pjesë edhe sistemi ynë diellor. Në galaktikë ka miliona yje dhe patjetër ka dhë sisteme të tjera planetare, të ngjashme me tonin, ku mund të zhvillohen proceset jetësore.»

«Pse, domethënë mund të ketë dhe njerëz, apo jo?»

«Mund të ketë dhe njerëz, po ndoshta ata nuk janë si ne tamam, kushedi se ç'udhë ka marrë jeta atje e c'kushte të tjera ka gjetur.»

«Sigurisht që këto yje janë shumë larg, apo jo?»

«Shumë, ylli më i afërt është katër vjet e gjysmë-dritë larg nesh.»

«Si, ç'është kjo?»

«Po ja, drita, për të ardhur nga ai yll, duhet të udhëtojë katër vjet e gjysmë.»

«Si, ore?! Drita the?! Domethënë . . . »

«Domethënë, kur e shohim ne tanë atë yll, nuk është shohim siç është, por e shohim si ka qenë para katër vjetësh e gjysmë.»

«Héu, . . . dreq . . . S'më kishte shkuar në mënd kjo gjë.» Iloja u ndeh ashtu, me vështrimin e mbërthyer në kupën e qiellit.»

«Po pas kësaj galaktike, Tos?»

«Pas kësaj ka të tjera galaktika, bota është pa fund.» Ata heshtën të dy.

«Sa e trishtueshme», — foli Iloja.

«Pse?»

«Po ja, të mendosh që ka njerëz të tjerë diku

nëpër gjithësi dhe ne nuk i shohim, nuk i takojmë, nuk japim e marrim me ta.» Tosi qeshi.

Tosi kishte ngritur kokën lart dhe shquante më radhë konstelacionet e shumta, të cilat i kishte dhënë në provim në janar. Iloja nuk ndihet fare.

«Ilo, mos fjetë, ore? A ikim, se vajti vonë?»

Fatos Gjoleka u ngrit në këmbë. Iloja lëvizë dhe u çua mbi bërryla.

«Ikim, — tha, — vërtet vajti vonë.» Ata i zbritën kodrës sipas momopatit, që e dinin symbyllurazi. Ba-ri fëshférinte nëpër këmbë. Rreth dëgjohej bulkthi. U ndanë te rrugica. Ilo Petani futi duart në xhepa dhe shipi në trotuar. Hija e tij herë zgjatej e herë shkurtuhej, lëvizte përpara e prapa tij sipas largësisë apo afërsisë më llambë neon. Ilo Petani ngriti përséri kokën lart. Ai i ngadalësoi hapat dhe u mbështet te kangjellat e lulishthes «Po, unë, — tha, — unë, Ilo Petani, si duhet të dukem në gjithë universin? Si thërrmija e thërrimes së thërrimes. Hajdë! Ja, të thérres unë tani më sa kam fuqi, kush do të më dëgjonte? Do të më dëgjojnë këta të mëhallës, t’ha Kasoja, roja i magazinave në Manalat, dhe polici Dödë, më qoftë se është diku këtu rrotull. Askush tjetër s’do të më dëgjonte!» Ai ndenji i menduar dhë pa rrugicën. «Drita e ka shpejtësinë freqind mijë kilometra në sekondë. Kaq më duket e ka. Domethënë dashka vite të vijë prej yjeve te ne. Sa e madhe është bota. Ndoshta është e trishtueshme kjo madhësi e saj. Pa hajde tani mendo për separatorin tênd, për punën tênde, për hallet e tua. E q’janë të gjitha këto më krahasim me botën tejembanë?» Ilo Petani ndjeu të mërzitez. Pas gjashtë mëtajsh që e kishte lënë duhanin, iu ringjall përséri dëshira për të pire një cigate. Që nga lart rridhëtë nëpër qiel që shkëlqimi i ver-

dhë i yjeve dhe cipa blu kishte marrë një transparencë të çuditshme. Ai vështroi e vështroi, sa i lotuan sytë. Pse i lotuan vallë sytë? Iu lodhën apo u rëndoi ajo dhembje që ndieu befas në shpir? Rrugica kishte heshtur. Rreth e rrrotull ndiheshim zhurmat e insekteve të natës. Qetësi. Kishte kohë që Illo Petani rrinte ashtu i mbërthyer te kangjellat e lulishtes. Dritat e dritarëve nisën të rralloheshin. Befaste pallati karshi u ndie një e qarë foshnje. Zëri i saj i brishtë e i hollë u hap rrreth e qark.» Ky zë foshnje, tha Illo Petani, — nuk ndihej atje, te Harusha e Madhe, te Dragoi, ... po unë e ndjeva.» Pastaj ai ndenji i menduar dhe i tha vetes se q'rëndësi kishte a ndihej atje. «Ja unë e ndiej atë zë, atë klithmë je-te të asaj fëmije,» — tha ai. Ai mbushi kraharorin me frymë. «Pa vëri veshin heshtjes. Mos vallë është heshtje ajo? Jo, ka kaq tinguj e zëra. E gjithë jeta lëviz në të. Këtu, mën këtë qiell janë ato, yjet e jetës dhe ti këto duhet të shohësh, këtu t'i ngulësh sytë. Kurse ti bëhesh budalla dhe mendon më kot, trishtohesh më kot. Jeta është këtu rrreth teje, e madhe, e bukur, e gjallë, e prekshme, konkrete. Ti punon, përpinqesh, lodhesh, ndien mërenzi, gëzohesh, domethënë jeton. «Jeta është këtu, — i erdhi të therriste atij, sikur të kishte zbuluar dikça të re e të jashtëzakonshme. — Dhe ne, ky vend dhe pjesa më e mirë e kësaj bote, duam ta bëjmë dhe do ta bëjmë këtë jetë më të mirë, ta bëjmë jetën më jetë.» Ai buzëqeshi me vete dhe këputi një lule matanë gardhit. Te kthesa u ndien të qeshura e hapa. «Po del turni i dytë nga puna», — tha ai. Dhe pa përsëri qiellin dhe yjet. Po sytë tanë i kishtë plot dritë e ngazëllim. «Na shihni ju ne, o botëra të largëta, — tha ai, — për shembull më shihni mua, Illo Pe-

tanin, 23 vjeç, mekanik, që mot mbaroi teknikumin dhe dëshiroj të bëhem inxhinier? Më shihni ju?» Atij iu ngroh gjoksi dhe një rrezatim i çuditshëm ndjeu t'i përhapej së brendshmi. Mendimet iu ngatërruan. Ai deshi të thoshte diçka për botën e tij, për shokët, njerëzit që ka rrëth vetes, për gjithë atë ujëvarë ditësh e netësh, për pranverën dhe uzinën e tij, për atë ide të madhe, në themel e së cilës vunë zemrat njerëzit e mirë të epokave dhe në betonin e së cilës vënë zemrën ai dhe shokët e tij, për dëshirën e pushtetshme që bota e gjithë të bëhet dritë, komunizëm. Por ai nuk tha gjë. Vetëm sytë i qeshmin dhe një gaz i madh i që shpalosur fytyrës. Ai eci për nga shtëpia e tij dhe tha më mendje: separatori. «Çdiferencë presioni duhet të krijojnë fletët e mëdha me të voglat? Ja, ta zëmë për shembull se fletët e sipërme do të bëhen dy herë më të mëdha...».

shqipërisht, që nuk ka më përdorur. Në këtë rast, shqipërisht është një vërtetë vëllazëri i përgjithshëm. Në këtë rast, shqipërisht është një vërtetë vëllazëri i përgjithshëm. Në këtë rast, shqipërisht është një vërtetë vëllazëri i përgjithshëm. Në këtë rast, shqipërisht është një vërtetë vëllazëri i përgjithshëm.

NJE ISO REND NË HAPËSIRE

Tek agjencja e makinave kishin mbetur vetëm dy burra, Shkoi kohë dhe u err. Të dy burrat u afroan me njëri-tjetrin, pasi gjithmonë errësira i afrojnjerëzit. Njëri nga ata ishte djali e tjetri burrë i theyer në moshë, me mustaqe që i mbulonin buzën e siperme.

«Nga të kemi, o djali?»

«Nga Lajthiza jam».

«Unë jam më tej, nga Toplani; e ç'bëjmë, o djali, a nisemi më këmbë? Të ishim nisur me kohë kishim sosur tanë». Djali tundi kokën si me mëdyshje, vështroi edhe një herë udhën dhe bëri shenjë me dorë.

«Nisemi, — tha, — kot të presim më, s'ka makina sot, e shtunë është». Ata u nisën nëpër rrugë. Burri kishte një feste të zezë në kokë dhe një xhaketë kadicë po të zezë. Djali ishte kokëjashtë, me një këmishë mëngëgjerë dhe një jelek të leshtë. Te kthesa e rrugës, ata prenë për shkurt.

«I kujt je nga Lajthiza, o djali?»

«I Teki Bërmashit jam; Sulo më thonë».

«Pse, ore, iu bë kaq djali Tekiut, a? Hajde, dja-

lë, hajde». Burri e vështroi me gaz dhe shtroi mustaqet në anën e buzëve Qe natë me hënë dhe qdo gjë shkëlqente si e kallajisur.

«Keni një trimëreshë ju andej, o djali. E di ti apo jo? Shqipe Pocomitin». Burri vështroi përpara i menduar.

«E qysh s'e ditkërkam, ore?! — bëri djali si i fyer. — Një Shqipe ka Lajthiza, sos ka njëqind». Burri tundi kokën.

«Një, një, po e keni lënë pa këngë, o njeri, — bëri ai, — vdiq Dule Plithari dhe sikur vdiq dhe kënga aty ndër ju.» Djali vështroi me bisht të syrit. Burri u vrenjt dhe profili i tij në hënë dukej si kosor i mprehtë. Ai çapiste përpara dhe djali vinte disi prapa, në anë të tij. Burri ktheu kokën nga djali.

«Të zotët jeni ju rinia për punë, ore, të zotët, por të këngës s'jeni ama. Qysh të këngës? Jo të këngës që e gjeni gati, ore, jo. Të këngës që ta bëni vetë». Burri tundi kokën si me shaka e si me inat. Kishin rreth ndonjë orë që ecnin nën hënë.

«A rrëmë sa të dredh një duhan, o djali?» — tha burri dhe i rrahu krahun.

«Si të duash», — u përgjigj djali dhe pa përqark. Ata u ulën mbi ca gurë rrëzë rrugës këmbësore. Burri nxori kutinë dhe e zgjati nga djali. Ai bëri me dorë që s'e pinte.

«Mirë bën, ç'e do të flamosurin». Burri vuri fletët në mes të gishtërinjve dhe ngjeshi duhanin në të. Djali u mbështet pas, në gurët, me duart nën zverk. Burri i shkoi gjuhën letrës.

«E ç'sheh, o djali, hënën sheh, a?», — qeshi ai. E qeshura e tij u ndje si gurgullimë.

«Nuk shoh hënën, o, jo, po shoh jetën time».

Djali nuk lëvizit vendit. Burri e vështroi i heshtur.
Ai blói në vete atë thënie.

«Mirë e ke, — tha, — mirë e kë, o djalë! Dhe vu-
ri duhanin në buzë e rrahu xhepat për shkrepësen.
«E qumiba, përnder, — tha, — ptu! e flamosura!»
Pastaj e gjeti dhe e fërkoi me tërsëllëm. Shkrepësja
bëri flakë. Djali, i bukur si djalë, rrinte ashtu, me
shikimin përpjetë. S'fiste njeri. Përtej, prapa bokës,
ishte qyteti. Diku aty afër ndihej cinxri. Burri thithi
duhanin dhe u mendua. «Shikoj jetën time, — tha, —
hë, qerrata djale! Ai buzëqeshi lehtë. Befas, në mes
të heshtjes, zëri i djalit gurgulloj i ëmbël e i butë.
Burri mbajti vesh. Zëri kërkoi pak sa të vinte atje
tek duhej, pastaj zuri vend. Ishte një zë i fuqishëm
e i ri:

Jetës, tënde, çupë, mëndë, mëndë, mëndë,
sa i shkele pragun.

«Mbama, ore, mbama! — tha, diku, në mes, të
këngës, ai. Burri hoqi duhanin nga goja dhe bëri:

Ohoho! (me një zë të thellë e të plotë,) Opo sa
i shkele pragun, moreee! Eeeee!

Kur e shkeli hasmi, more,
pragun e vatanit.

Ore, pragun e vatanit, ooo!

Ia ktheu burri dhe bëri ison, një iso të madhe,
sikur këndonin dhjetë burra. Djali heshti dhe kërkoi
fjalët.

Shqipë Pocomiti, moreee,
Shqipe pushkëtopi.

Burri e vazhdoi këngën me një zë të dëdhur kraharori. Cigarja e tij e hedhur ngjante si sy ikuq në errësirë. Ai shkrua: «Ooo, moreee! ia ktheu djali dhë u ngjith lart, mbi zérin e trashë të burrit. — «Eeee!» — bënë të dy pastaj:

C'u ngule si rrapi, o moj,

te pozicioni.

Burri ngriti lart dorën dhe e uli poshtë sikur të rrëfente edhe me gjeste atë që fliste kënga. Ai mbaroi ison dhe kroi zérin. Dhe djali filloi përséri:

Nënia të kish bijë, moj,
fshati, moj, të kish çupë.

Opo çupë, moreee! — zgjati tej zérin burri me dorën në kraharor. «Eeee!» — Kënga hapej nëpër natë dhe, tek gjente hapësirën boshe, zhurmërat e ditës qenë fashitur, rendte e rendte si e hazdisur, përplasej në grykat e në faqet e malit.

Të ka Shqipëria, o moj,

Opoyll të kuq në ballë

Djalit i shkëlqyen sytë dhe ktheu i mallëngjyer vërgun që tha burri. Djali tashmë që ngritur e rrinte ndenjur pranë sëpiti të tij. E mbushën ison të dy, të plotë e të gjatë dhe heshtën. Heshtën shumë e shumë, sa burri drohti përsëri një duhan dhe e piu. Secili rrinte ashtu më vete dhe mendohëj për shpirtin e tronditut nga kënga.

«Eeh!» — bëri burri dhe vuri dorën mbi gurë e

u çua. «A ngrihem, o djali, se ná zuri nata?» Djali u ngrit si nëpërt gjumë dhe të dy vazhduan udhën në heshtje. Ecën kështu një copë herë. Djali donte të thoshte diçka. Burri e kuptoi dhë ktheu kokën nga ai: «Djali!

«Të lumtë goja, o djali, — tha... — paska Lajthiza, o, paska!» Ai rrahu shpatullën e djalit dhe e shtyu përparrë.

«Të lumtë goja dhe ty, o Didin Mokrari!»

«E nga më njeh mua ti, o qerrata?!» — nënqeshi burri i habitur.

«Këngën tënde e njeh gjithë krahina, o Didin», — tha djali dhe e pa drejt rië sy. Sytë e të dyvë ishin mbushur me shkëlqimin e hënës.

«Po kjo qe kënga jote, o trim, — tha burri i menduar, — dhe kënga jote dò të mbetet».

«Jo, — tha djali, — të dy e bëmë». Pastaj atij iu zgjidh gjuha dhe i foli burrit përveten, për shkollën e mbreñjes, për kooperativën dhe të fejuarën e tij në një fshat aty pranë.

«Kam edhe unë një djali, — pshëretiu Didin Mokrari, — në Tiranë e kam, mëson në shkollë, ja kaq sa ti është. Ç'e do këngës s'ia thotë ...» Ai pshëretiu përsëri dhe ngå shprehja e fytyrës djali kuptoi se e vuante me të vërtetë këtë gjë Didin këngëtarë.

«Po mos u mërzit, — foli djali me gjysmë zëri, — mos u mërzit, do këndoje dhe ai. Ja... edhe unë kurrë s'kisha zënë këngë gjér më sot». Burri ktheu kokën e vështroi si me çudi.

«Ashtu është, — vazhdoi djali i lehtesar, — se si më erdhi qëparë».

Habia e burrit po shndërrohej në një buzëqeshje të madhe. Ai i hodhi dorën djalit dhe e hqiqi pranë.

Tej u dukën dritat e Lajthizës; udha për në Toplan kthehej më të djathtë. Burri shkurtoi çapet.

«A ia themi dhe një herë, o djalë? — tha. — Ia themi dhe një herë dhe ndahemi pastaj. Po do t'ia marrësh ti, ama, unë ta kthej». Djali uli sytë poshtë dhe i mbajti ashtu një hop. Pastaj e ngriti kokën tok me zërin:

*Shqipe Pocomiti, o moj,
Shqipe pushkëtopi!*

O moreee! — bëri pas tij Didin Mokrari. Zërat e tyre u përzien siç përzihen dy përrenj, një i shpejtë e një më i shtruar e bëjnë një lumë. Ata rrinin ash-tu më këmbë, në mes të udhës, me nga një dorë në sup të njëri-tjetrit.

UDHA TE NJERIU

Gazetari mblodhi mjaft të dhëna për heroin e shkrimit të ardhshëm, nga bashkëluftëtarë e veteranë, por vetë atë s'e kishte takuar ende. Në qendrën e rrëthit i thanë se mundohej kot që shkonte në Tëbellevë, pasi ai, Hajdar Goliku, ishte kaq fjalëpakë e gojëkyçur, sa i kalonte të gjithë kufijtë: «Ai 's'flet kurrë për veten, — i thanë, — bile nuk i pëlqejnë e i merr zët ata që kërkojnë të rrëmojnë në të kaluarën e tij». Gazetari buzëqeshi dhe tha, se do ta provonte njëherë. «Fundja, kjo është puna jonë,» — tha ai dhe ngriti supet. Pastaj u përshëndet me shokët e gazetës lokale dhe doli në xhade. Tek priste aty, mendoi për njeriun e panjohur. Mundohej ta përfytyronte atë. Pranë i ndaloj një makinë nga të kooperativës dhe e mori. Gazetari e kishte mendjen te heroi i tij dhe pothuajse nuk i dha fare muhabet shoferit. Arriti në fshat kur dielli i zbehtë i dhjetorit kishte nisur të bënte copën e fundit të harkut të tij ditor. Dinte edhe këtë: që Hajdar Goliku, tanimë rrëth të gjashtëdhjetave, punonte si telefonist në postë. Pas Çlirimt atë kishin dashur ta merrnin në qytet. «Hajde, — i thanë, — do të të japim këtë apo atë punë.» «Jo, — u tha Hajdar Goliku, — Jام mirë këtu.»

Gazetari pyeti për të dhe i treguan se ishte në postë. U nis. Gazetari kishte tre vjet në këtë zanat. C'është e vërteta, kjo ishte pak dhe sigurisht i vinte zor t'i përmendte ata tre vjet. Po sidoqoftë puna e kishte shpënë udhëve e udhëve, fshatrave e qyteteve, kishte njohur njerëz të mirë e të ligj, të mëdhenj e të vegjël, të thjeshtë e të komplikuar dhe diçka dintë dhe ai nga gjithë ajo antologji, ku ëdo fletë është një jetë njeriu. Por, tek hynte tani në postë, ai përsëri ndjeu emocion. Kështu i ndodhët thuajse pérherë. Dhe ishte e natyrshme kjo: ai përpiquej të hynte te njeriu, tempulli më i madh e më i shenjtë që natyra ngriti që prej historisë së lashtë të jetës.

Gazetari i dha dorën Hajdar Golikut dhe i tha kush ishte.

«Qofsh shëndoshë!» — uroi burri kockëmadh, pak i kërrusur në supe dhe u ul përsëri pranë telefonit. Në dhomë kishte një sobë, një tavolinë, një shtrat hekuri dhe centrali telefonik me dhjetë fishe.

«Dua të shkruaj një shkrim për ju, shoku Hajdar, — tha gazetari dhe përnjëherësh e kuptoi gabimin që bëri, — kam biseduár me shokë e të njohur tuajt.» Burri e pa në sy. Sytë e tij dukeshin herë të butë e herë të ashpër. Ai lëvizte lapsin në një regjistër të hapur përpara vetes.

«E ç'je munduar, o djalë?!» — foli burri. Fjalët ai i tha me një zë të butë, disi të trashë, ku ndihej shkoqur një nuancë mërzie. Gazetari u përpoq të vinte buzën në gaz. Ra zilja e telefonit dhe Hajdar Goliku bëri «Alo, alo!» Djali e ndjeu veten keq dhe mendoi se duhej të bënte diçka. Ai e pyeti Hajdar Golikun për punën e tij, për kooperativën e fshatin. Nxori paketën, ndezi një për vete dhe ia zgjati dhe atij. Hajdar Goliku vuri pëllëmbën e madhe në gjoks.

Aj s'e pinte. Të gjitha pyetjeve të gazetarit iu përgjigj me nga dy-tri fjalë të thata. Pastaj ai ulte përsëri kokën mbi regjistër. Edhe dy herë të tjera kërkëllima e zjiles ë preu atë heshtje të rëndë. Gazetarit iu djersitën duart dhe nisi t'i hante rrëza e flokëve. Po ta kisha për herë të parë, tha ai, do të nevrikosesa me të. Fundja unë dua të bëj një shkrim, ta nxjerr në gazettë dhe njerëzit ta këndojnë, kurse ai... ai më sheh sikur t'i kem zënë derën dhe sa nuk më thotë: «Pam'u sikteris, se më mërzite!» C'njeri i çuditshëm, tha dhe iu kujtua që ai kishte marrë disa plagë në luftë. I kishin thënë bile se një copë predhë ai e ka ende në kokë. Me këtë mendim, i vështroi kokën mbuluar nga flokët e shkurtër e të thinjur dhe u mundua të gjente se ku ishte ajo copë predhë që ai, Hajdar Goliku, kishtë një jetë të tërë, tridhjetë e kusur vjet që e mbante në trup si një pjesë të vetes së tij, atë copë predhë të nxjerrë kushedi se ku në Gjermani, të shkrirë e të derdhur kushedi se ku në Gjermani dhe të mbushur me barut e të bërë vrashëse kuschedi se ku në Gjermani. Dhe ky njeri këtu që, siç duket, ka në pjesë edhe modestinë e njerëzve të tjerë përreth, hesht, kur mund të thotë shumë gjëra. Befas djali pati të ftohtë dhe mblođhi mbi gjunjë kundat e pardesysë. Hajdar Goliku ngriti kokën dhe e pa. Gazetari buzëqeshi dhe i tha se nëna e kishte porositur gjithmonë që të mos nisej hollë mbasi do të mardhë udhëve, po ai s'ia kishte vënë veshin.

«Nëna përfëmijën është një sy e një vesh më shumë», — tha Hajdar Goliku.

«Sa bukur e the», — foli gazetari. Në sytë e tij u zgjerua buzëqeshja. Në fytyrën e Hajdar Golikut diçka u zbut dhe vështrimi iu ngroh.

«Mos deshe zjarr, t'i hedh dru sobës? — tha ai.

— Dimër është. Po unë jam mësuar kështu». Gazzetari pa nëpër d'homë. Pas derës ishte një kapicë me druri. Ai u ngrit vetë dhe mori dy kopace. Jashtë kishte nisiur të errej. Gazetari u mendua. Si është njeriu, tha ai. Kishte njobur kaq njerëz dhe prapë s'mund të thoshte se kishte njobur dy njëlloj. Po si këtë... «vërtet më duket se po lodhem kot,» mendoi. Apo, ia viente që ta njinte dhe këtë, qoftë dhe kështu? Gazzetari ndezi përsëri një duhan. Ai u ndje i lodhur. Dhe befas, tek hiqte me të gjithë gjoksin tymin, zuri të fliste për udhëtimin e tij. Ai tregoi si ishte lagur gjér në kockë të Elbasan, si ishte tharë në një furrë buke në të dalë të qytetit, si kishte bërë një copë rrugë me një zetor e si thërrishnin me zetoristin mes zhurmës së motorit për t'u marrë vesh me sho-shoqin.

«Kur më vdiq babai, — tha gazzetari, — isha dhjetë vjeç. Babai ka luftuar në jug, partizan. Ishte mësues dhe i donte shumë fëmijët. Ai fliste me mua si me një të rritur. Më tregonte shumë gjëra nga lufta... Nëna më ka mbetur atje, në Sarandë, me vëllanë e madh. Unë po, në Tiranë, po puna na bën të vëmë e të vijnë udhëve. Ako më skam marrë shtëpi, beqar thoshin. Tani janë fejuar, dhe këto ditë dë të më jepin. Rri në një dhomë në një hotel aty në qendër. Nëna bëhet merak. «Körba unë, — thotë në letrë, — qysh bën, qysh ha ë qysh ngröhesh, o bir?» Si gjithë nënët. Po puna jonë është e bukur, lëvizim, shohim e ndiejmë pulsin e të gjithë vendit. Po jo gjithmonë na shkon mbarë; ashtu si në çdo punë, natyrisht. Edhe duhet përpjekur, duhet grindur, luftuar. Ja, ne kemi një shef atje, ai thotë: «Çë ke këtë, pa hiqe shpejt këtë rresht, kjo merret si nxirje e realitetit», thotë. E pse u marrka si nxirje e realitetit, o shoku shef? E vërteta jo gjithmonë është e bukur. Duke thënë

kështu, ti je si ai njeriu që thotë se dielli është i shëmtuar se me teleskop iu dukerkën ca njolla. Kësh-
tu është, në mes të fushave të pafund me grurë të shëndetshëm mbin edhe egjér, apo jo? Ja, ti je bujk
dhe e di më mirë. Po ai thotë: «Jo, hiqe këtë rrresht!» Po, po ta heq atë rrresht e atë tjetrin, do thonë ata poshtë: «Erdhi gazetari, ndenji, iku dhe hallet s'na i mori vesh, vetëm sukseset e të mirat na pa.» Se kanë dhe halle mileti, ka pengesa socializmi, nuk është si një tren që shket mbi binarë të grasatuar, pa ka edhe ndryshë, pa ka edhe ndonjë prishje e shtrembërim.

Ai shoi bishtin e cigares te këmba e sobës, pastaj hapi derickën e saj dhe e futi brenda. Më pas zuri të fliste për shokët e tij të punës dhe të fejuarën e tij, që studion në vitin e parë për filozofi.

«Ajo s'ka parë asnje vend, — tha ai, — veç Tiranes dhe Durrësit, kur shkon për pushime. Nganjëherë i dukem i çuditshëm kur i flas për atë a këtë problem. Në shumë gjëra ajo s'më kupton. Po është çupë e mirë», — tha ai dhe papritur buzëqeshi. Pastaj ngri-
ti sytë.

«Ndoshta të mërzita, — tha, po ja që nganjëherë njeriu... sikur paska dëshirë të flasë me dikë.»

Hajdar Goliku kishte mbështetur mjekrën në pëllëmbën e hapur dhe një buzëqeshje e menduar i qe nderë në fytyrë. Sytë i shprehmin ngrohtësi dhe gjithë qenia e tij sikur thoshte: «Kështu ështëjeta, o bir, ndryshe s'do qe e bukur. Po ti lufto, përpiku e mos u térhoq!» Ata ndenjën një copë kohë në heshtje. Gazetari shihte herë-herë këmbët e veta dhe herë-herë derickën e sobës. Jashtë kishte nisur të errej. Në dhomë ndriçonte zjarri.

«Pa na e hap atë dritë, o djali, — tha Hajdar Goliku. Pastaj pshëretiu: — E... eh! — dhe drejtoi tru-

pin. — Sot je tek unë, — tha, — ja tani vjen Bekshua, roja i kooperativës dhe shkojmë në shtëpi. Kam një raki të mirë. E pi rakinë ti?» Gazetari buzëqeshi. Ai u ul përsëri dhe tha diçka për rakinë.

Roja erdhi pas pak. Ai u njoh me gazetarin.

«Shkruaj, ore, shkruaj, — tha, — hajde, Hajdar Goliku, hajde, dragua, ore, dragua, kur vërvitej ky, ore, mbi gjermanë... hajde, hajde, me dorë i mbërthente, ore, me dorë. Shkruaj, që ta dinë rinia, shkruaj dhe për sot, që marrin 14 lekë për ditë-punë e i thamë sëkter fukarallékut, po... Partia, ore, Partia dhe Enver Hoxha, që u falshim nga ditët tonë.»

«E, o! Beksho, se i di ky të gjitha; po, hë! Hajdar Goliku është vuri përpëra gazetarin dhe doli pas tij.

«Natën e mirë!» — tha Beksho rojtari dhë mbylli derën pas tyre.

«Natën e mirë!» — tha Beksho rojtari dhë mbylli derën pas tyre. «Po, tani qenë luftë ai?» — pyeti gazetari.

«Ka qenë në luftë ai? eh, kamë qenë dhe të tjerë, po tani s'janë më. Shokë të mirë na vrau gjermani. Eh... Po hajde, kemi një natë të tërë përpëra. Edhe do të pimë, edhe muhabet do të bëjmë. Më pëlqeve, o djalë.» Dhe Hajdar Goliku hodhi krahun e tij të rendë mbi paradesynë e gazetarit dhe e hoqi nga vetja.

undet. Gjekë i mbi si — unë — qëndroj me vix
qyr mësill e bollë. Në shkallat e vjetra, qëndroj me vix
— përditshëm — qëndroj me vix — qëndroj me vix.

Prandaj që nuk është më vix, qëndroj me vix —
tështë së vërtetë — qëndroj me vix — qëndroj me vix.

SHARR EXHİU

Restoranti i qytetit që mbushur plot. Te tavolina
pranë derës ishte vetëm një njëri. Unë bërat me she-
një dhe ai tha: «Ulu, pos...» Kamerieri i solli atij pjat-
tën dhe unë bëra porosinë. Pija cigare dhe shikoja
shokun e tavolinës. Ishte rreth 30 vjeç, me duar ven-
de-vende të nxira dhe më tipare të bukura. Vetëm
flokët i ngriheshin me kryenegësi tufa-tufa. Ai hante
shumë bukë. E hante me kafshata të mëdha të cilat
i ngjyente në lëngun e gjellës. E pyeta nga ishte.
Tha se që nga Fani dhe kishte ardhur në një mble-
dhje me mekanizatorët e rrethit. Pastaj unë e pyeta
për kooperativat.

«Sa hektarë keni gjithsej?» — thashë unë.

«Nuk e di saktë», — u përgjigj ai dhe u skuq.

«Si ka mundësi?!» — qesha unë dhe përnjëhe-
rësh më erdhi disi keq që e vura në pozitë të vësh-
tirë.

«Po unë punoj në sharra, — tha ai dhe të kuqtë
e fytyrës ende s'i kaloi, — në sektorin e Fanit.» Ka-
merieri më solli porosinë.

«Kisha dhe një pilaf,» — tha shoku i tavolinës.

«Mirë, ta sjell», — murmuriti kamerieri.

«Mos je inxhinier, ti?» — thashë unë. Atij iu bë qejfi që e gjetit.

«Si të quajnë?» — pyeta.

«Nikollë, Nikollë Beshiq. — Unë nisastë haja.

«Esntë e vështirë puna juaj?» — pyeta përsëri.

«Oka, — tha ai, — më parë ka qenë shumë keq, tanë është rregulluar mjft. Unë punoj si motorist.»

«Në sharrën me motor?» — thashë — »

«Po. Janë të mira shumë ato! Eh, si na kullojnë djersa përparrame sharrat e dorës. Tani s'i përdorim më!»

«Po mirë, konkrètisht ç'punë bëni ju?»

«Brigada jone është në prerje. Jemi 10 vjetë, kemi një sharrë me korent. Presim trupat, pastrojmë degët, i lidhim pas traktorit ose në teleferik. Ja kjo është.»

«Në dimër e keni keq, apo jo?»

«Vështirë është, pastrojmë dëborën me lopatë, pema duhet prerë rrash me tokën.» Ai zuri të hanë pilafin.

«Gatuajnë keq, — tha, — s'gatuajnë! gjetë kemi një shok në brigadë, prej tij të hash, pa, pa.» Unë buzë qesha.

«Druri më i fortë është ahun. Kapahe isatavolina. Po ta punosh sharrën mirë, për 25 minuta e përet një si ky. Presim dhe pishë dhe ahnere. Kjo është një lloj pishe shumë e bukur. S'është shumë e lartë, tri-tet më majëmali dhe është shumë e vjetër. Të shohësh kur bie. Të vjen keq. Një shok në fillim qante, po, po, i mbusheshin sytë me llojtë.»

«Ka ujq 'andej?» — thashë unë dhe ndeza cigaren. Ai më bëri me shenjë që s'e pinte.

«Ka, — tha, — sa të duash. Tani është koha e arivut, arinj ka shumë tanë. Është i rrezikshëm ai. Ka

mbytur bagëti. Ka ndodhur që ka mbytur edhe njerez. Të mbyt me gurë. Ai shkul lisin të gjithë... Këtë të keqe kemi qe vendin e punës e kemi larg, duke prerë duke u larguar. Në shtëpi nuk shkojmë përnatë.» Më pa drejt në sy dhe më buzëqeshi.

«Mësohesh, — tha, — mësohesh me të gjitha. Pota nuk je prej këtej apo jo?»

«Jo, — thashë, — jam me shërbim!» Dikush më goditi në sup. U ktheva dhe pas hë Kiçon, një shok shkolle. U përqafuam dhet shkëmbyem dy-tri fjalë.

«I lig, — tha ai, — vjen e s'ndihesh fare. Nesër mos zër hotel, se s'të flas me gojë.»

«Mirë, mirë, — thashë, — po ik tani se qenke me shokë.»

«Do të vij nesër të të marr», — tha ai.

«Mirë», — bëra unë dhe e shtyva tej. Nikolla më buzëqeshi. Kishte vënë duart mbi tavolinë. Unë e pashë me vëmendje dhe ai u skuq. Mendova se sa gabim bëjmë ndonjëherë që shumë gjëra i marrim sipas një kallëpi shtampë. Për shembull unë kisha krijuar një lloj modeli në përfytyrimin tim për mësorin dhe, kur përmendej ai, më dilte një fytyrë e vrazhdë, tipare të egra, të ashpra, kryelartësi, shtati madh etj. Ja që s'ishte kështu.

«Jam pér rrugë, — tha Nikolla, dhe u ngrit, — do më falësh.»

«Ou... po është natë, — thashë unë, — ku do shkosh?!» Ai qeshi.

«Duhet shkuar, — tha, — dy orë mban. I bihet këtej, nga Kolçi në Surroj, Qafa e Britmës dhe bie në Fan. E po, natën e mirë!» — Më shtrëngoi dorën.

«Natën e mirë! — thashë. E ndoqa me një buzëqeshje derisa u zhduk pas derës dhe thitha cigaren. Pas pak kamerieri pa në tavolinë dhe, i alarmuar,

rendi jashtë. Pastaj u kthye i kuq flakë në ifytyrë.

«Pa, ... sikur e dija», — dhe goditi pëllëmbën me pecetën që mbante në dorën tjetër. Më erdhi e pritur. Ndjeva një të nxehjtë. M'u duk sikur gjithçka kisha mgrünë pak më parë kishte një shije të rëndë e të keqe.

«Si është puna!» — thashë dhe e mblođha veten.

«I poshtri, — tha kamerieri, — . . . dhe pilaf, don-te dhe pilaf, aah...»

«Mor po si e ke hallin?» — pyeta prapë.

«Iku, — tha, — iku pa paguar. Ah, kur...» — Ai shau përsëri.

«Mos u rrëmbe, — thashë, — pyet një herë si e tek. Ai shoku kishte punë dhe m'ili la mua të hollat Urdhëro. Nuk bën këshfu.» Unë vura të hollat mbi tavolinë. Kamerieri uli kokën dhe diç murmuritë në pér dhëmbë. Ndenja dhe pak dhe u ngrita. Isha i sigurtë që ai kishte harruar nga nxitimi. S'doja të mendojavmë pér këtë gjë. Megjithatë bëja g'bëjë dhe mendimi më kfhehej aty. Mora çelësin dhe ngjita shkallët e hotelit pér në dhomën time. Ashtu i veshur, u mbështeta në shtrat dhe u përpëqa të lexoja diçka. Nëpér rreshtat e librit më dukej se dilnin ca pisha të mëdha e të rënda. Ato këputeshin e binin në një krah, duke shkundur cullufet e déborës. Në fillim binin ngadalë, pastaj merrnin shpejtësi. Ndi-hej krisma e thyerjes së pjesës së pasharruar, pastaj fishkëllima e degëve dhe në fund oshëtimë e pér-plasjes. E mbylla librin. Ndeza një cigare dhe e detyrova veten të mendoja pér punët që do të kryeja të nesërmen. Trokiti dera. Pata një parandjenjë.

«Hajde, Nikollë!» — thashë. Dera u hap. Ai qëndronte pa hequr dorën nga doreza. Kishte vrapiuar. Akoma s'i që normalizuar frysëmarrja.

«Pse, mór burrë, — thashë, — s'bëhej kiameti, gjérë që ndodhin.»

«Lëre, — tha, — u turpërova fare, u turpërova, s'më kishte bërë vaki.» — Fshiu djersët me mëngë dhë përsëri e mbuloi një purpur turpi.

«Hej dreq, — tha, — . . . shumë falemnderit nga ti, o inxhinier!» — Futi dorën në xhep dhë lëshoi të hollat në eep të tavolinës.

«Po rri pak, — i thashë, — çlodhu.»

«Jo, — tha, — më presin, rrugë është, për t'u bërë është.» — Më zgjati dorën. E térhoqa dhe e përqafova.

«Po të ra rruga, pyet në Fan për mua se më gjjen. Natën e mirë!»

«Rruga e mbarë!» — thashi. Ndenja një copë herë me fytyrën te xhami i dritarës Jashtë kishte nisur të frynte erë. Tej, në errësirë shquheshin shtrati i copëtar i Drinit dhe konturet e masiveve malore. Përfytyrova përsëri zhurmën e sharrave, trapin e trupave nëpër lugje, dëborën që shkundej si miell kur rrëzohej pemë. «Tani ai është i qetë», — thashë dhe häpa përsëri librin.

NJË MAKINË NË RRUGËN MALORE

Befas ai ndjeu cicërimat e zogjve dhe atë zhurmë të mbytur që bën pylli kur nëpër degët e pemëve të tij depërtton flindi i lehtë i muzgut. Hapi sytë. «Oul!» — ia bëri dhe i dha trupit. Heshta e dhimbjes e përshkoi të tèrin. Ai klithi dhe koka iu vais përséri mbi myshkun e gjelbër. Dikur erdhi përséri në vete. Ngriti pak kokën dhe pa këmbët e tij. E majta ishte nën një trup të madh druri që pesë burra s'do ta luanin dot. «E pat kjo, — tha shofer Fadili, — e pat». U mbështet mbi bërryla dhe i dha trupit edhe ca përpara. Rruga dukej deri tej te kthesa dhe pastaj humbiste. Makina e tij iku e fundit nga sharrat dhe ai e dinte se zor të luante ndonjë mjet në këtë orë në Rrugën e Llapushit. Rëndoi mbi pëllëmbën e njërsës dorë dhe i tundi kokën makinës së tij. Ajo rrinte aty mënjanë, me derën e hapur, nga ku duke shin cepi i xhakoventos së tij dhe zinxhiri i çelësave. Makina iu duk si një qenie tepër e pikëlluar dhe shofer Fadili u përpoq të vinte buzën në gaz. «Mirë, — tha ai, — të mbledhim veten më parë... ndizë një, shoku Fadil, shoferi i dalluar Fadil, gomari Fadil, që s'ta mori mendja këtë gjë.» Nxori paketën dhe

vuri një «Partizani» në 'buzë. Pastaj thithi me ëndje duhanin dhe pa lart qiellin që kishte filluar të errej. Një shpend rrahu krahët në degët e pishës pranë tij dhe në sup i ranë dy hala të thara. Preku me pëllëmbë myshkun e kadifenjtë. Ana e majtë e pishës kishte më tepër myshk. «Domethënë këtej është jugu, — tha ai, — apo veriu, s'më kujtohet mirë,... si thoshte Gushin kur mësonte atë mësimin e gjeografisë?... E ç'të të kujtohet ty, je bërë si ai kali, s'lexon një libër a një gjë, vetëm punë, punë, o burra.» Shau veten. «Gushin e kam të mirë, — tha pas pak, — të pestën e mbaron këtë vit,... do ta bëj doktoreshë. Poo, që t'i vëré një këmbë druri këtij hajvanit këtu. «Lëvizi pak padashur dhe dhembja e shpoi. Diç iu kujtua. «Jepi tani, — tha, — plani është ky: do ta gjerryesh nën këmbë dheun aq, sa ta nxjerrësh, pastaj te makinë dhe... o burra!» Kërkoi nëpër xhepa. Iu kujtua që biçakun e kishte të lidhur me tufën e çelësave dhe tundi kokën. Hoqi rrëth këmbës myshkun. Toka ishte e butë dhe e lagësht. Ai nguli gishtërinjtë në të dhe hodhi dheun e murmë anash. «Pooo, e kishe lënë kavon në atë gjendje, helbete, shofer i zoti, i forti Fadil, ariu Fadil, kërrici Fadil. Na tani... E ç'grindesh, o derëzi, u bë kjo, do t'ia bëjmë dermanin. Dermanin the? Pooo, me një këmbë. Hesht, të thashë dhe luaj duart, atë bëj!» Ai kishte kaluar burimin dhe kishte ndier trungjet të liroheshin në karrroceri. Shau nëpër dhëmbë dhe ndali makinën. I erdhi rrötull ngarkesës dhe mori nga kabina levën. Kavoja që lidhte trungjet ishte dobësuar dhe vendevende kishte mbetur me dy-tri fije. Ai nisi ta shtrëngonte kur... Trungu i sipërm u derdh drejt tij. Ai qe hedhur praptas... Pastaj nuk mbante mend gjë.

Këmba shkau në gropën e bërë dhe ai ndjeu t'i

lirohej nga pesha. Mori frysë thellë. Djersa i rrođhi mbi gjoksin leshtor. U hoq pas ngadalë e me mundim dhe ajo diçka e përgjakur, e zhyer me d'hë e ashkla druri, ajo diçka, që pak më parë ishte këmba e tij e mirë, doli nga gropë. Shofer Fadili ndjeu një rrëqethje. «Tani ta shohim ç'ka, — tha. — E ç'të ketë, or budalla, ja... e ka pickuar një çikë pleshti pooo... Mirë, mirë, keq do ta kishe po të mos që mpiksur gjaku.» I erdhi ligsht ta shihte më gjatë këmbën ashtu. Me kokën mënjanë shkau dorën e majtë që nga kofsha, ngadalë, deri poshtë. Gishtérinjtë i kaluan gjurin. «Ja... këtu, — tha... — këtu është thyer. Hajde, pa do ta ngjitim prapë, mos ki dert. Vetëm mos u ndje sa të arrijmë». U shtri në kurriz dhe ndezi përsëri një duhan. Errësira që dendësuar dhe përreth nuk shihje dot më tej se dhjetë metra. Ai mendoi për shokët. «Tani do kenë arritur, — tha, — Gëzimit s'i punonte mirë një kandele. Po nejse, s'ia ha qeni shkopin atij.» Ndjeu një kapitje si prej të dehuri dhe i erdhi sikur të luante një grimë, qoftë dhe një gisht, do t'i prishej e gjitha ajo rehati marramendëse që e kishte pushtuar. Ai i dha trupit lart dhe fërkoi fytyrën me pëllëmbë. «Tani dëgjo komandën: Me zvarrisje, para!» — tha shofer Fadili.

* * *

Kishin njëzet minuta që udhëtonin. Sapo kaloi qafën kishte marrë tre pasagjerë te përroi i kthjellët. Njërin e mjihte, ishte mësues i atyre anëve, tjetri, ai që kishte pas vetes, kishte nja një vit që kishte ardhur nga qyteti. Shofer Fadili dinte vëtëm që ishte njeri i kalemit, llogaritar apo diçka këtu

vështirësi makinën dhe bëri ca metra prapa. Në horizont u shquan dritat e qytetit.

«Kanë punë të vështirë këta, jo shaka», — tha fshatari dhe tundi kokën.

«E, t'u bë qejfi, ë, — foli me vete shofer Fadili, — mos u mburr jo, se s'po bën heroizma.» Vuri një cigare në buzë. Mësuesi i zgjati shkrepësen dhe ai e ndezi me sytë përpara. Bëhet, vallë, prapë këmbë, mendoi, bëhet, vallë? E pse mos bëhet! Ndini theu tri brinjë dhe krahun dhe tanë është për bukurin, bille punon me ato 40-tonëshet e Fierzës. Do bëhesh, moj këmbë, që ç'ke me të. Kur të mbarojë çupa klasën e të marrë dëftesën, do të kërcejë me ty, dëgjove?» E mbuloi përsëri një kapitje tunduese, që e ftonte të linte timonin e të lëshohej symbyllur mbi shpinoren e ndenjëses. «Edhe të të varnin, kaq do të duroje tanin», — tha shofer Fadili. Makina kaloi me zhurmë në-për lagjen e jashtme të qytetit.

«Mbaje, — tha ai i kalemit, — do të zgres unë.» Shofer Fadili s'dëgjoi gjë. Mësuesi e preku në krah.

«Fadil, ti s'je mirë më dukesh.» Shofer Fadili u përpoq të buzëqeshte. Kaloi sheshin përpara agjencisë dhe ndaloi te cepi i spitalit.

«Të falemnderit, or shok, e ta paça hua.» Fshatari i ra shpatullave. Ai i kalemit diç murmuriste në-për dhëmbë duke u përpjekur të dilte që pas shpinores së shoferit. Shofer Fadili bëri një përpjekje të stërmundimshme dhe lëvizi nga vendi. Rëndoi mbi këmbën e shëdoshë dhe shkau për gjatë derës. Mësuesi zbriti me vrap nga dera tjetër dhe rendi tek ai.

«Shokë... — belibëzoi shofer Fadili, — kam thyer një... njérën këmbë, më shpi... më shpini pak...». Ai mbylli sytë dhe mbështeti kokën te goma e përparme. Të tre burrat e tjerë heshtën një hop.

«Pu, pu, pu, — bëri ai i kalemit, — e dëgjuat? Me një këmbë tha, ë, me një këmbë; qenka për të lidhur ky, ore, drejtohet makina në atë rrugë me një këmbë?! Me një këmbë tha, ë; u bë për të thënë» O zot si paskemi shpëtuar, o vëllezër! Pu, pu!» Ai i ra ballit me pëllëmbë.

«E di ç'ke ti, mbushu që këtej, hajt, sikter!» — shfryu fshatari dhe shikundi krahët sikur të rrihej me dikë.

«Mor po...»

«O po mjaft llomotite të thonë, dëgjon apo s'dëgjon?»

«Ngrije pak, — tha mësuesi, — ngrije pak e ma hidh në kurriz.» Fshatari shau dhe e ngriti shofer Fadilin mbi shpinën e përkultur të mësuesit. Pastaj vrapi i përparrë drejt portës së spitalit. Mësuesi e ndoqi pas duKE bërë zigzage nga pesha. Ai i kalemit mëbeti pranë makinës si kërcu i prerë. Mbështeti njëren dorë mbi gomë por i dogji dhe e hoqi shpejt. Dritat e rrugës binin në kabinë.

DALLGET E GRURIT

Në rrugën e ngushtë midis parcelave zhurmonte një motocikletë. Agronomi i sektorit, Pjetër Hila hidhej lart e poshtë mbi sedilie sipas gropave të rrugës. Ai shihte majtas e djathtas dhe sytë i shkëlqenin. Te kryqëzimi i dy kanaleve e fiku motorin, e ngriti mbi këmbalecë dhe shkundi me dorë pantallonat. Pastaj mori bukën e mëngjesit të mbështjellë me një copë celofon dhe eci rrëzë kanalit. Aty më tej duke shin mbi grurin tri autokombajna.

«Si jeni, burra?» — tha Pjetër Hila.

«Hajde bujrum!» — iu pëngjigj Zenun Tafili me gojën plot. Ata po hanin mëngjes.

«Hajde, o shoku Pjetër, hajde. Hajde e ha me ne. Kushedi se ç'të ka vënë gruaja aty?!» Lec Hidri, njëri nga kombajnerët, qeshi dhe i hapi vend agromit të ulej. Kombajnerët lëvizën të gjithë më tej.

«Epo, në mos më pastë vënë gjë të mirë sot, kurri s'ka për të më vënë!» Agronomi u ul në mes të gazit. Ai mbloodi këmbët pranë vetes. «Po ç'thoni, o shokë?» — tha dhe i pa ata në sy. Kombajnerët heshtën duke u mbllaqitur. Sytë e tyre qeshnin.

«Më mirë se vjet është njëherë, këtë di unë.»

«Mos është si i rrallë?»

«Gruri i rrallë? I rrallë jo; veç në goftë i lehtë në peshë. Agronomi kafshoi bukën. Nuk i vinte pér të ngrënë. Ora kishte kaluar nga nënta. Duhej pritur sa të thahej gruri nga vesa e pastaj të hynin kombajnat, ndaj ata vazhdonin të rrinin të ulur aty tek ai shesh. Rreth e rreth ndihej zhurma e grurit. Frynte pak erë. Pjetër Hila e la bukën dhe u ngrit.

«Po ha njëherë, o i uruar.»

«S'më shkon fare», — tha ai. Dhe qeshi me vete; kur ishite në shkollë, sa herë që hynte në provim, kështu s'i halhej. S'i hapej goja pér kiamet. Ai hyri midis grurit. E shkoi dorën përmbi të dhe ndjeu në pëllëmbë gudulisjen e kallëzave. Më pas këputi një kallëzë, e vuri në dorë dhe fërkoi pëllëmbët. Pastaj flaku bykun dhe fryu lehtë në dorën e hapur. Mbi pëllëmbë mbetën kokrrat e verdha në të kuqe. I mbajti ashtu në dorë dhe tundi dorën lart-poshtë. «Nuk është i lehtë, — tha, — jo.» E hodhi grurin në pëllëmbën tjetër. Pjetër Hila ishte i gjëzuar. Ndiente gjëzim në tërë qenien e tij. Tu kujtuam imazhet e romaneve të Balzakut. «Ky është ari ynë.» — pëshpëriti Pjetër Hila dhe sytë e tij të gjelbër të errët ndritën, vështroi dhe një herë kokrrat e bulkura dhe i hodhi ato në gojë. «Gëzuar, — tha, — gjëzuar bukën e re!» Pjetër Hila ia bëri vetes këtë urim dhe buzëqeshi. Ashtu, me atë buzëqeshje doli nga gruri.

«E, sikur erdhi koha, ë?»

«Gati jemi. Po, sikur të vinte dhe Destani.»

«Ja tek e ke dhe atë», — tha Lec Hidri. Ndanë parcelës po vinte përgjegjësi i sektorit, Destan Agaraj me brigadiere Dafinën. Kjo qe parcela e saj dhe përgjegjësi po e ngacmonte. Ata u afruan duke qe-

shur. Ashtu duke qeshur u përshëndetën me shokët. Motorët e autokombajnave u ndezën.

«A u furnizuat me karburant? — tha Destani.

«Në rregull jemi me të gjitha», — tha Zenun Tafili nga lart.

«Drekën do t'jua biem këtu. Dritat i keni në rrëgull?» Lec Hidri bëri me dorë që gjithçka ishte siç duhej. Secili nga kombajnerët e dinte pjesën e tij.

«Ti, Zenun, do të kthehesh pastaj të marrësh anët e parcelës buzë kanalit.» Zenun Tafili tundi kokën. Destan Agaraj bëri me dorë dhe kombajnat lëvizën nga vendi. Sheshi u mbush nga zhurma. Pjetër Hila diçka i thoshte me zë të lartë përgjegjësit. Destani bënte me dorë nga rruga. Atje tej dukeshin një grup vajzash e grash që vinin për të mbledhur kallinjtë e mbetur. Pjetër Hila mori frymë thellë. Me vete uroi këtë çast: «Me këmbë të mbarë!» Ashtu siç thoshte kur shkelte pragun e derës ku jepešin provimet. Zu të lëvizte pas kombajnës së Lec Hidrit. Leci kishte vënë në kokë një kapelë të vjetër kashte, të shtypur e të deformuar. Ndihmësi qeshte me të dhe i tregonte agronomit kapelen e Lecit. Në anë të parcelës erdhën dy zetorë. Ata prisin të merrnin ngarkesën e bukur të grurit. Agronomi Pjetër Hila vrapoi dhe kërceu mbi kombajnën e Lec Hidrit. Ai u ngjit sipër, mbi bunker. I vinte të qeshte si fëmijë. Futi duart gjer në bërryl në grurin e bunkerit.

«Eshtë i pastër!» — thirri ai.

«Si?» — Lec Hidri kishte vënë dorën në vesh.

«Eshtë i pastër shumë, them, s'na ka ndodhur kurrë kështu.»

«Siii?» — Lec Hidri u zgjat drejt tij. Pjetër Hila qeshi dhe bëri një shenjë me dorë. Dafina tok me dy shoqe shkonin pas autokombajnës së Zenunit. Desta-

ni bisedonte me zetoristët dhe kontrollonte a ishin zënë mirë nëpër anët spondet, se mos derdhej gruri rrugës. Dafina dëgjoi Pjetër Hilën të thërriste emrin e saj. Ajo vrapoi tek ai.

«Shih këtu, Dafinë. Si të duket ty?» Ai buzë-qeshët dhe i tregonte një grusht me grurë. Dafina e hapi grurin me gishtërinj. Ai e pa në sy pa e ndarë buzëqeshjen.

«Mos kujto se unë s'e pëlqej të bukurën, Dafinë. E mban mend ç'më the atë ditë?» Dafina u skuq. Një muaj më parë, kur gruri kishte ardhur gjer të gjunjët, i njomë e i gjelbër, agronomi kishte vënë detyrë të shkuleshin gjemba dhe leguminozet e egra të mbira nëpër të, buzë kanaleve. Të nesërmënai kishte kaluar nëpër parcela dhe kishte parë shumë lulëkuqe aty në grurë. E thirri Dafinën dhe i tha t'i hiqnin dhe ato. Dafina qe skuqur në fytyrë.

«Pse, — i tha, — ç'të keqe ka prej tyre, shoku agronom?»

«Unë s'kam të keqe, po ka të keq gruri.»

«E ç'i bëjnë grurit ato? Ato ngjajnë kaq të bukurë aty midis gjelbërimit. Çuditem si nuk e ndieni qoftë dhe kaq pak të bukurën ju, agronom.» Dhe qe kthyer e kishte rendur e zemëruar. Dhe ja, ai Pjetër Hila po ia kujtonte tanë këtë gjë. Dafina buzëqeshi përsëri e bërë flakë në fytyrë.

«Po, Dafinë, — vazhdoi Pjetër Hila sikur t'i fliste vetes, — këtu ka më shumë poezi se ç'na duket neve shpeshiherë.» Sytë e tij kishin humbur diku midis grurit që mbante në duar. Dafina shikonte edhe ajo aty, në pëllëmbën e tij dhe në sy i mbiu përsëri cipa e lotit. Destan Agaraj erdhi pranë tyre.

«Unë them se dyzet i marrim këtu», — tha ai dhe fshiu djersën nga qafa.

«Po të marrim dyzet këtu, ju heq të dyve një drekë në «Turizëm»», — tha Pjetër Hila.

«Shumë mirë, pastaj bëjmë një çikë pushim dhe ju heq unë darkën, po aty.» Ata qeshën të tre. Larg në rrugë dukej makina e drejtorit të fermës. Destan Agaraj bëri me dorë andej. Pjetër Hila vështroi buzëgaz. Drejtori do të zbriste dhe do të bënte ca nga ato «hëm, hëm-et» e tij të zakonshme. Ai sigurisht do të ishte në qejf, por, si gjithmonë, nuk do ta shfaqte. Do të shtynte lart strehën e kasketës dhe do të vinte grushtet në ije. Shoferi do ta ngacmonte duke thënë se nuk marrin aq po kaq për hektar këtu. Drejtori do t'i kthehej; «Rri, or ti, aty, të thonë!» dhe, megjithëse do të fliste me ton, në fytyrë do t'i vije re atë buzëqeshjen dashamirëse. Pastaj ai diçka do të pyeste për masat që ishin marrë. Më pas ai do të futej nëpër grurë, për t'u gëzuar edhe ai me të. Pjetër Hila qeshi kur mendoi të gjitha këto. Ishte burri i mirë drejtori i tyre.

«Ç'ke?» — pyeti Destan Agaraj.

«Hic», — bëri ai me dorë dhe u thirri vajzave që shkonin pas kombajnës së Pandeliut, duke u treguar një copë vend ku kishin mbetur kallëza. Dafina rendi për atje. Pjetër Hila shihte atë copë tokë, ku më parë kishte valëzuar gruri, që ngjante si kokë e qethur. Tani ai grurë valëzonte atje në bunker, pastaj në lëmë, pastaj nëpër thasë, pastaj në miellin e bardhë, pastaj në bukën e ngrohtë, pastaj në krejt jetën tonë të madhe. Ç'ishte ky valëzim i çuditshëm? «Eshtë dallga e madhe e jetës», — tha i menduar Pjetër Hila.

PAZARI I PASDITES

Agron Polloska u bë zëvendësministër. Ç'është e vërteta atij nuk i pëlqeu fare kjo gjë në fillim. Bile s'po e konceptonte dot se atij, Agron Polloskës, përgjegjës turni në kombinat, i thërrisin shoku zëvendësministër. Atje ku ishte e kishte vënë punën në vijë, përpiquej e lodhej por ama e dinte se ku duhej tamam të përpiquej e të lodhej. Kurse këtu në detyrën e re s'po dinte nga t'ia mibante. Ministri i kishte qëndruar pranë ditel e para dhe i kishte dhënë udhëzime të shumta e megjithatë ai, me shumë vështirësi, po ia mbushte mendjen vetes se do ta bënte dhe duhej ta bënte mirë atë detyrë. Sepse ai ishte komunist, luftëtar në frontin e madh të Partisë dhe Partia ia caktonte pozicionin e luftimit, sot ushtar këtu, nesër komandant atje, pasnesër prapë ushtar atje përtej, se atje është nevoja. Kështu është kjo punë.

«Do ta bëj, i kishte thënë vetes, do ta bëj edhe sikur ta di se i shtrydh trupin dhe mendjen dhe u marr dhe pikën e fundit të energjisë.» Dhe i qe përveshur punës aq, sa sidomos gruaja, që mori përsipër dhe barrën e pazarit, filloi ta ndiente mungesën e tij në shtëpi. Po kjo ndodhi vetëm në fillim, sa u njoh me detyrën, sepse më pas e kishte më të lehtë. Filloi të kishte kohë të lirë.

«Po t'i kushtohesh seriozisht punës, gjithmonë ke për t'ia dalë mbanë.» Këtë po mendonte, ndërsa me torbën e ushqimeve në dorë kishte dalë për të psonisur.

Arjana, e shoqja, ishte edukatore në një kopsht fëmijësh dhe pazarin e pasditës e bënte zakonisht ai. Kishte kohë që e bënte këtë gjë, që kur ishin martuar, bile edhe më parë se të martohej. Ai mendoi se ku i duhej të shkonte dhe u drejtua nga dyqani i mishit. Aty kishte pak njerëz. Kur i erdhi radha, shitësi e pa me dashamirësi.

«Ç'urdhëroni? — pëshpëriti ai. — Mos deshët gjë peshk? Kam peshk të freskët, levrek, peshk i mirë shumë.»

«O, paske peshk, shumë mirë, levrek, ë? Më jep dy kile.» Agron Polloska buzëqeshi dhe iu kujtua se sa do të gëzohej Arjana për peshkun.

«Ptu! — bëri një pensionist me zë të ulët, prapat. — Po ky sikur tha që u mbarua.»

«Si the, xhaxha?» Agron Polloskës i ngriu buzëqeshja dhe u kthyte nga pensionisti.

«Jo, mor shok, jo, s'është mirë kështu. Kushdi ç'je ti dhe kushdi ç'nder i bën ti këtij myteberi, pa ha dhe peshk.» Plaku ktheu kokën dhe i nguli sytë te druri ku pritej mishi.

«Të lutem, të lutem, mos më fyej mua; të njoh mirë unë kush je ti, po, të njoh...» Shiteti qe bërë flakë në fytyrë. Agron Polloska e vështroi me gjak-ftohtësi.

«Vetëm për mua paske peshk ti?»

«Jo, shoku..., ç'është ajo fjalë, për ideal që...»

«Nuk bën mirë kështu», — tha prerë zëvendësministri. Në kokën e tij tashmë ishte ndërtuar saktë

situata. Ky njeri, shitës mishi, gjer dje ishte indiferent ndaj tij, si ndaj gjithë klientëve të tjerë me të cilët s'kishte marrëdhëniet të veçanta shoqërie, miqësie, farefisnie, kurse tani, befas, i ofron peshkun e fshehur, nesër mund t'ia japë mishin pa radhë, pas nesër mund t'ia paketojë e t'ia sjellë edhe në shtëpi. «Maskara e faqezi!» — shau ai me vete. E përplasi letrën me peshk në banak, i shtrëngoi krahun pensionistik dhe u largua. Vështrimi i plakut e ndoqi me respekt. Prapa tij u bë heshtje. Agroni eci i inatosur në trotuar. Ç'vetti të veçantë paskësh fituar ai, Agron Polloska, që iu dashkan bërë privilegje?! «Unë jam po ai që kam qenë, — tha ai, — po ai Agron.» Ashtu i inatosur hyri në dyqanin ushqimor. Shitësja mbërtheu përparësen dhe rregulloi rripin në mes. Ajo e zbuti zérin dhe filloi të përsëriste shpesh fjalët «urdhëroni» dhe «ju lutem». Në dyqan ishin dy gra dhe tre burra. Befas shitësja u kthyte nga ai dhe e pyeti se ç'dëshiron te. Agronit i rrahu me forcë një damar në qafë.

«Ende s'më ka ardhur radha, — tha ai duke e parë shitësen në sy, — shërbeju atyre njëherë.»

«Ç'është ajo? — bëri shpejt e shpejt shitësja e skuqur. — S'thonë gjë këta, kushedi se ç'punë keni ju, shoku zëvendësministër?!» Njerëzit panë nga ai me vërejtje.

«O.. o, urdhëroni, urdhëroni!» — bëri një nga burrat. Një tjetër iktheu kokën mënjanë.

«Merr, mor bir, të keqen, — tha një plakë, — ç'është ai llaf, të marrim ne përpara teje?! Merr zotote njëherë.»

«Jo, moj mënë, jo. Të marrësh ti njëherë se je plakë e je përpara meje, të merrni ju të gjithë, mire shokë, se të gjithë jemi punonjës e qytetarë të këtij

shteti dhe jemi njësoj të nderuar e të respektuar për punët tona. Dhe ti shoqe, — ai u kthyesh nga shitësja, — nuk vepron drejt. Turp! Ti përfaqëson këtu tregtinë socialiste.» Agron Polloska e mbajti veten dhe fjalët i tha saktë e prerë. Pastaj përshëndeti me kokë dhe u largua duke hequr pas derën.

«Po unë e shkreta, unë...» — pëshpëriti shitësja pas tij. Ajo kërkoi sytë e klientëve por ata rrinin kokëposhtë. Zëvendësministri ziente përbrenda. Ai po mendonte me vete të gjitha sa i ngjanë. «Këtu nuk duhen bërë lëshime, — tha ai. — Fajin e kemi ne vetë, na pëlqen privilegji, mësohemi me të, nuk i vëmë rëndësi: «Hë, mo, themi, ç'ka të bëjë kjo», nesër pastaj vihemë vetë në pozitat e atij që na e bëri këtë privilegji dhe ia bëjmë këtë një tjetri ose dhe vetë atij, përsa kemi në dorë. Sa herë e ka ngritur Partia luftënkundër hatërlëqeve, tarafit, servilizmit?! Dhe përsëri ne e harrojmë.» Agron Polloska e cte në Rrugën e Kavajës me torbën bosh në dorë. Atij nisi t'i dhimbte koka.

«O Gone, Agron, ore!» Ai ndali hapat e ktheu kokën. Te dera e bufesë ia bënte me dorë Tolo Bashari, banakieri i vjetër.

«O po hajde, o derëzi, se na harrove. Apo ke frikë se duhet të na qerasësh meqë u bëre i madh?» Agron Polloska qeshi dhe u përqafua me Tolo Basharin. Ashtu të zënë nga krahët u futën brenda.

«Epo ç'kemi, o Gone? Hajde, hajde, zëvendësministër, o qerrata! Po mos na harro. Apo s'të pëlqen më kafja ime?»

«Rri, ore shejtan!» — bëri Agron Polloska dhe e shpoi në brinjë banakierin. Tolo Bashari mbushi dy birra dhe ia shtyu njérën përpara.

«Pije! — tha dhe çoku krikllën e vet pas saj. — Paguaji ti këto se të takojnë.» Agron Polloska buzëqeshi, pagoi paratë në arkë dhe i dha banakierit kuponin.

«Gëzuar!» — tha.

«Gëzuar e me faqe të bardhë!» — bëri Tolo Bashari. Ata pinë birrën dhe folën për tregtinë dhe xhiron e lokalit. Pastaj i dhanë dorën njëri-tjetrit dhe Agron Polloska doli nga bufeja i përcjellë nga shakatë dhe të qeshurat e banakierit. Në sytë e zë-vendësministrit nuk kishte më gjurmë inati e mërzie. Po thellë, thellë në bebëzat e syve ai kishte një tjetër ndjenjë. Diçka kishte ndryshuar konceptimi mbi punën e tij. Kjo punë ishte më e madhe e më e gjerë. Sepse për një çast ai kishte menduar se si duhej të manovronte me treguesit ekonomikë e financiarë si duhej të rakordonte plane e shifra, të drejtontë sektorë e degëprodhimi, por kishte harruar se si duhej të punonte me njerëzit, pa të cilët të gjitha shifrat, treguesit, planet, sektorët dhe degët nuk kishin kuptim.

Agron Polloska arriti në shtëpi dhe e shoqja ia hapi derën tek ai përpiquej, në grindje me vvetveten, të fuste gelësin e vet në bravë. Sytë e tyre u ndeshën dhe ai u mbështet i lodhur te buzëqeshja e madhe e gruas së tij.

«Hiqi këpucët se kam larë, — tha ajo dhe i mori torbën nga dora. — Oul!» — tha, dhe e tundi torbën bosh. Agron Polloska hoqi këpucët dhe vuri buzën në gaz. Gruaja i vajti pas në kuzhinë. Djali i tyre i vogël lozta mbi divan. Ai bëri «ba-ba» dhe Agroni e mori në duar dhe i ngau buzët me gisht. Pastaj mblodhi buzët e veta i fëshkelleu djalit si zog. Arjana e

shikonte në sy dhe kërkonte sytë e tij. Ai e la djalin dhe i zuri dorën së shoqes.

«Ç'ke, Goni? — tha ajo. — Të ndodhi gjë?» Dhe befas ai ndjeu si lëvriu në qenien e saj shqetësimi për të.

«Jo, — tha ai,... — të zakonshme.» Dhe ngadalë i tregoi asaj gjithë panoramën e pasditës. Ajo buzë-qeshi dhe mbështeti kokën në supin e tij.

«Po mirë, sipas teje nga kjo gjë ne s'duhet të hamë?» Ai e shtrëngoi kokën e saj pas vetes. Sytë i qeshnin të menduar.

«Jo, moj grua, s'thashë kështu. Për këtë kam faj unë. Po a e di ti, Ari, se si më erdhi, nuk më erdhi hiç mirë nga ato skena, më beso... Më kot të kërkojmë të bëhet puna, po qe se harrojmë njerëzit që e bëjnë atë punë. Ja ai kasapi mund të jetë i dalluar, mund të realizojë xhiron, planin. Po pse, a mjafton kjo? U bëjmë remont makinerive, i grasatojmë e u ndërrojmë pjesë, po për njerëzit kujtohem i më pak dhe shpeshherë jemi formalistë. Njeriu sot duhet të jetë i ndërgjegjshëm për punën që bën e, në qoftëse e bën mirë, atëherë s'ka pse të ketë frikë dhe të bëhet servil ndaj më të madhit në përgjegjësi. Në qoftë se bën kështu, shiko se patjetër ai punën e tij nuk e bën mirë, diçka e keqe, e paligjshme, e papranueshme nga shoqëria fshihet në atë punë. Dëgjo, Ari, më thuaj, a mund ta bëj unë këtë detyrë?» Ai i shtrëngoi dorën fort dhe shfaqi me zë atë mendim që i qe vërtitur në kokë tërë atë ditë. E shoqja e pa në sy lbutë e me dashuri.

«Do ta bësh, — tha ajo, — do ta bësh, Goni, — ajo e ngriti zérin, — ti dhe shokët e tu.» Djali i vogël i Agron Polloskës përpiquej të ngrihej në këmbë duke u mbajtur pas krahut të të atit.

NJË TREGIM NË MUZG

Ekipi i Institutit të Folklorit përbëhej nga dy vajza të reja, muzikologe. Njëra nga ato qe e gjatë, me flokë të drejtë e të zinj, me vetulla të larta e të harkuara. Ajo bënte lëvizje të prera, ku vihej re një lloj nervozizmi. Shoqja e saj ishte më e shkurtër, flokëgështenjë dhe mjaft e qeshur.

Në vatrën e kulturës së kooperativës kishite ardhur Mele Rabani, plaku nëntëdhjetëvjeçar i njojur për këngët e tij në të gjithë atë zonë.

«Ky po, ky është magnetofon, — thoshte përgjegjësi i vatrës së kulturës së fshatit dhe shkonte dorën, me një ndjenjë të dukshme zilie e respekti, mbi tassot e magnetofonit. — Një që kishim këtu, s'na punonte mirë... e kam shpënë ta ndreqin.» Mirépo të tjerët s'e kishin mendjen dhe atij s'po ia vinte veshin njeri. Kryetari i këshillit u thoshte diçka vajzave. Ato tundnin kokat pa bërë zë. Plaku i shihte ashtu, si nën vetulla. Vështrimi i tij thoshte se s'ia mbushnin syrin ato çupërlina.

«E dale de..., ta mbaroj këtë të flamosur», — bëri Mele Rabani dhe i tregoi kryetarit çibukun e nxirë. Në vatrën e çibukut, nën hirin e bardhë fekste syri i

kuq i duhanit të ndezur. Vajza e gjatë kishte ngulur sytë e saj tek ai sy. Tjetra e shkundi nga supi.

«Po ç'ke, pra?»

«Hiç.»

«Hiç?... Hiç mos thuaj, se kaq gjë e kuptoj unë. S'do të ma thuash, ashtu thuaj.»

«Mos është zënë me Benin?! — mendoi ajo. — Ka disa ditë që sikur nuk është në terezi... Është e çuditshme, të dashurosh dhe të kesh këtë trishtim në sy!»

Tjetra u përpoq të buzëqeshte. Kryetari i këshillit prekte me dorë lëkurën e butë të këllëfit të magnetofonit.

«A ta zë, moj çupani?» Plaku shkundi çibukun dhe e rrahu pas oxhakut.

«Gati, xha Mele!» — tha ajo më e shkurtra dhe lëvizi një buton të magnetofonit. Ajo ngriti dorën.

«Oj... oiii!» — bëri plaku dhe i dha kokës lart.

*Nuse, moj, yll i pandritur,
nuse, moj ku të kanë nisur.*

*Cipa jote bardhë porsi miell i situr,
nuse, moj, ku të kanë nisur.*

*Kali s'të mban dot, merr për t'u gremisur
Nuse moj, ku të kanë nisur.»*

Plaku shikonte përpara, nga cepi i dhomës. Çupa e gjatë qe mbështetur me të dy bërrylat në tavolinë dhe vërtiste nëpër gishta një nga bobinat e magnetofonit. Përgjegjësi shikonte herë vajzat e herë plakun. Në sytë e tij ndriste gjithë krenari një buzëqeshje. «Hë, këtu më rri, — thoshte ajo buzëqeshje,

— kemi këngë dhe këngëtarë ne, or t'u bëfsha, pa shih... mallëngjeu çupat xha Melja, po si... » Dhe ai i dha një herë dorës përpjetë sikur të thoshte: «Forca, o xha Mele!» Çupa tjetër e vështroi. Ajo ngriti gishtin dhe e vuri te buzët e saj. Po këtë gjest bëri ndaj përgjegjësit edhe kryetari i këshillit. Çupa e shkurtër tundi nja dy herë dorën pér t'i mbajtur plakut ritmin.

*Velloja mbi ballë ç'të është vithisur,
nuse, moj, ku të kanë nisur.*

*Nënia dy-tri fjalë ç'të ka molloisur,
nuse, moj, ku të kanë nisur.*

*Këngët rrëth e rrrotull, tabut i stolisur,
nuse, moj ku të kanë nisur.*

*Zemra e gjorë, moj zog i përpëlitur,
nuse, moj, ku të kanë nisur.*

Bobina e magnetofonit ra me zhurmë nga duart e vajzës së gjatë, në dysheme. Tjetra shtypi taston dhe vuri duart në lbel. Ajo e pa shoqen në sy me një pauzë qortimi.

«Ama dhe ti...! Xha Mele, taksimat e ke dhe një herë, ë?»

«Paga, moj bijë, paçka». — Plaku kroi zërin dhe filloi përsëri: «Oj... oti...! Vajza pa sytë e shoqes së saj. «Seç ka», — tha me vete. Te sytë e çupës së gjatë sikur po shtohej e po shtohej masa e kristalë dhe nga kjo sytë e saj po bëheshin të ndritshëm, të ndritshëm.

Nëna dy-tri fjalë ç'të ka molloisur,

nuse, moj, ku të kanë nisur.

Zemra e gjorë, moj, zog i përpëlitur,

*nuse, moj, ku të kanë nisur.
Djali që s'të dhanë, komit arratisur,
nuse, moj, ku të kanë nisur.
Oj... oiii!*

U dëgjua kërcitja e tastos së magnetofonit. «Shumë mirë, — tha vajza, — të lumtë, xha Mele!» — Vajza qeshi dhe vuri dorën mbi supin e plakut dhe tjetrën mbi përkrahun e kryetarit. Plaku tundte kokën si me shaka. Vajza ktheu bobinën. U dëgjua fëshfërima e shiritit. Pastaj zëri i Mele Rabanit disi i transformuar:

*Nuse, moj, yll i pandritur,
nuse, moj, ku të kanë nisur.*

Kryetari diç i thotë në vesh xha Mcles, por ai ia bënte me dorë.

«Një Mele Rabani ka fshati, or t'u bëfsha, një! — thirri përgjegjësi.

«Pa dale, dale njëherë», — bëri plaku dhe u ndeh nga magnetofoni. Vajza e shkurtër pa shoqen. Kristalli i syve të saj po shkrinte. Edhe pak dhe ajo masë e ndritshme do të rrëzohej mbi mollëzat e faqeve.

«Të po qan? C'ke kështu pra?» — Shoqja e tërhoqi atë mënjanë duke u përpjekur t'u zinte pamjen dy burrave që dëgjonin këngën.

«Unë e dua atë... e duaaaaa! Po si nuk duan ta kuptojnë ata të mitë», — pëshpëriti shpejt e shpejt vajza e gjatë dhe i shkundi krahun shoqes sikur ajo të kishte faj që s'po kuptonte se ç'i thoshte tjetra. Plaku kishte vënë dorën në vesh e dëgjonte zërin e tij. Dy burrat e tjerë panë vajzat dhe pastaj njëri-tjetrin në sy.

*Kali s'të mban dot, o moj,
merr për t'u gremisur,
nuse, moj, ku të kunë nisur.*

Zëri i Mele Rabanit dilte nga shiriti i ngrohitëc i dridhshëm.

Vajza e shkurtër kaloi pëllëmbën e saj mbi parakrahun e shoqes.

«Kjo këngë, — mendoi ajo, — është e vjetër. Vjen thellë nga shekujt, e megjithatë na trondit edhe ne, sepse ka edhe sot nga ata njerëz që pengojnë lumturinë e çupave, ndonëse të ndryshuar, me tjetër pamje, me tjetër veshje, me tjetër mënyrë të menduari e të vepruari. . .». Ajo vështroi shoqen dhe i erdhi keq për të dhe për gjendjen e saj. Pastaj pëllëmba e saj u shtrëngua më me forcë mbi krahun e saj. Vajza mendoi se shoqja e saj nuk do të përfundonte si heroina e kësaj kënge të lashtë, se ato ishin aq forca, sa të mos e lejonin mbytjen e dashurisë së tyre, mbasi tërë shoqëria, është me to, është me atë dashuri të pastër e të bukur.

Jashtë binte muzgu. Në dhomën e vogël të shtëpisë së kulturës nuk ishin vetëm ata të pestë, tre burrat dhe dy çupat muzikologe. Ishte dhe një nuse mbi një kalë që merrte të gremisej, me një nënë që shpirtvrararë i thoshte diçka në vesh, me një djalë që e shuanë britmën e dhembjes në brinjën e malit që ishte streha e komitëve, ishin dhe një sërë njerëz të tjerë nga Tirana, njerëz modernë, me zakone moderne. Kishte shumë njerëz ajo dhomë e vogël. Po vallë e dëgjonin të gjithë këngën e vjetër të Mele Rabanit dhe zërin e tij që mbaritte zemrën e madhe të popullit?

SHOKU I VJETËR

Pinim birrë. Kisha kohë pa e takuar atë, shokun tim të fëmijërisë. E shikoja dhe përpinqesha të vija re gjurmët e viteve të moshës. Ai kishte gishtërinj të gjatë e të drejtë dhe gotën e mbante në një mënyrë të veçantë. Pamë njëri-tjetrin në sy dhe qeshëm pa shkak. Pyetëm për të rejat e secilit. Pastaj përsëri heshtëm. E pashë në sy.

«Hë, — i thashë, — fol». E kuptoja gjithmonë kur donte të më thoshte diçka. Ai mblodhi ibuzët e tundi dorën sikur donte të fshinte diçka.

«Hiç, — tha, — ja... e shkela mbrëmë». Unë u mbështeta në shpinoren e karriges dhe ndeza cigaren. «Rrija atje, — tha, — tek ajo tavolinë... Ngjitur kisha tre djem të rinj». Heshti. «Mbrëmë këtu kishte dhe orkestër». Heshti përsëri. «Kishte dhe njerëz më shumë». Rrotulloi gotën mbi tavolinë. «Në lokal hyri një çift i ri. Vajzës i hipit një e skuqur nga vështrimet e njerëzve dhe fillooi të shikonte poshtë. Djali gjeti një tavolinë të lirë dhe e drejtoi shoqen e tij për aty. U ulën. Ishin pas nesh. Djalin e kisha përballë, ndërsa vajza ishte në profil. Befas u kujtova se e njihja atë djalë. Ai e ka pasur shtëpinë ngjitur me gjyshen

time. Kisha kohë pa e parë. Ishte punëtor i zoti, i zinte dora qđo gjë. «Ç'e do, — thoshte gjyshja, — i mirë, i mirë ky djali i Nastës, po si shumë i qullët ëma. Do mbetet pa martuar ditëziu». Unë buzëqesha me vete dhe më beso që ndjeva një farë kënaqësie të çuditshme, kot fare, ja... për atë që ai ishte fejuar apo ishte në prag të fejesës. Vajza ishte e bukur. Ai ia preu mezen me thikë dhe ia vuri përpëra. Lëvizjet i bënte të ngadalta, sikur kryente një punë shumë serioze e me shumë rëndësi. Vajza gukiste lehtë përmbytja pjatë me pirun, si të kishte frikë se mos i thyhej në dorë. Djemtë pranë meje shikonin andej me ngulm. Ata përkuleshin ndaj njëri-tjetrit dhe pastaj kukurisnin së qeshuri. Ai në mes tyre, një djalë i gjatë e biond, me cigaren më mes të gishtave, bënte çmos t'i binte në sy vajzës. Kisha hyrë aty në lokal, gjysmë ore përpëra, fare i qetë e i kënaqur, por në atë çast nisa të ndieja një nervozizëm të çuditshëm. Vajza, me atë nuhatjen e mprehtë të femrës, diçka kuptoi dhe u spostua. Tani ma kishte kthyer kurrizin. Djemtë pranë meje përpoqën gotat e qeshën. Djali që njihja unë i shtinte vajzës herë pas here birrë nga shishja dhe i fliste për diçka, me atë mënyrën e tij të qetë e të ngadalshme. Të thashë, kishte dhe orkester. Lozni një pjesë të bukur. Ç'ndiente vallë ai djalë? Sigurisht që ai ishte i gjëzuar, por këtë s'e shfaqte hapur. Vajza hidhë flokët pas e rrrotullonte vështrimin nëpër sallë dhe, sa herë bënte kështu, djemtë qeshnin me zhurmë. Ndjeva që po më nervozonte kjo gjë. Pse, mor, ta hajë dreqi, të jenë kështu ca njerëz?! Shikoja përreth tavolinat. Njerëzit e ndonjë tavoline ishin të kënaqur. Buzëqeshjet u ndeheshin si fasha të ndritshme mbi sytë dhe buzët. Një plak aty pranë meje shihte me qortim tavolinën e djemve.»

Shoku heshti gjatë. Unë e shihja se ai e kishte vësh-tirë të shprehej. I buzëqesha dhe çokita gotën time pas së tijës, që ai e vërtiste pa prerë mbi mbulesën e tavolinës, sikur donte ta vidhoste në të. Piu një gllénjkë dhe vazhdoi përséri: «Djemtë vazhdonin të qeshnin me zë. Dy të tjerët ngacmonin djalin e gjatë biond, i cili bënte ca shenja të lehta me kokë për nga tavolina përtej. Desha të paguaja e të ikja, po djali që njihja unë e thirri kamerierin para meje. Ai, me qetësinë e zakonshme rreshtoi kartmonedhat pranë bllokut të kamerierit. Vajza u ngrit dhe drejtoi trupin. Djali i lëshoi rrugë përpara vetes. «Do ta kthejë dhe një herë kokën», — tha njëri nga djemtë pranë meje. «Te dera», — tha tjetri. Djaloshi biond buzë-qështë dhe rrihte me gishtërinj tavolinën. Orkestra filloi të lozta prapë dhe unë u përhoqa të mendoja me çdo kusht diçka tjetër. Befas djemtë qeshën me të madhe. Një burrë i moshuar i pa me qortim. «E . . . , — tha njëri, — ç'ta punoi, as ta vari fare!» Tjetri e go-diti biondin në sup. Ky rrundhi turinjtë dhe vuri cigaren në buzë. Ma bënte kraharori vu, vu, si një kazan që valon. Më kujtoheshin sytë e mirë të djalit që rrinte pranë gjyshes sime si dhe vajza e bukur dhe e druajtur. Njëri nga djemtë qeshi dhe u përkul pas. Karrigia e tij rrëshqiti dhe ai u mbajt te tavolina ime. Piruni trokëlliu në pjatën bosh. U ktheva nga ata. «Maskarenj», — thashë nëpër dhëmbë. Djaloshi bi-ond më pa me përcëmim dhe bëri një shenjë sikur të tregonte një majmun në zoopark. Tjetri më tregoi grushtin që poshtë mbulesës. S'përbahesha dot. Paguam e dolëm pothuaj në një kohë. Aty te lulishtja desh i rraha të tre. Ja, kaq. Do t'i rrjhja mirë. E di që do të bëja gabim, po... më mirë që ndodhi kështu. Ja . . . »

Shoku im pa poshtë te këmbët e tij. Vërtet më mirë që ndodhi kështu, se këto punë nuk zgjidhen me të rrähur, po ja që në jetë të qëllon gjithsesi. Vështroja fytyrën e tij të mprehtë dhe sytë e hequr e si me bisht. U përpoqa t'i dalloja ndanë vetullës, nën lëkurën e butë, atë damarin mavi, që i pulsonte sa herë që nevrikosej. Po, unë e dija. Ai do t'i kishte rrähur ata. Mund të rrihte edhe pesë njëherësh. Sepse, në fund të fundit, njeriu nuk lufton me atë shtresë mishi që u është veshur eshtrave të tij, por lufton me karakerin e tij, me ndjenjat dhe vetitë e tij më të mira. Është më i fortë gjithmonë ai që dashuron më shumë atë që meriton të dashurohet dhe që urren më shumë atë që meriton të urrehet. Ne u pamë në sy dhe buzëqeshëm në një mënyrë të veçantë, ndryshe nga herët e tjera.

MINIATURA

1. Gazetari ndihej i lodhur nga rruga. Makina s'kishte dhe ai qe detyruar ta bënte udhën më këmbë. Dhe ja, kishte arritur në fshat. Fshiu djersët dhe priti t'i afrohej një burrë i moshuar; që mbante një qysqi në dorë.

«Ku janë zyrat e kooperativës?»

«Atje là,» — tha burri dhe bëri tej. Gazetari e ndoqi me sy. Burri u drejtua te një godinë e sapolyer me gëlqere. Gazetari ndenji një hop me mëdyshje. Pastaj e ndoqi tjetrin nga pas. Kur iu afrua godinës, te dera ishin dhe dy të tjerë. Një i shkurtër që, mendueshëm, duke çaluar lëvizte përpëra derës e një tjetër i gjatë, me mustaqe të kuqërrrema e me festë në kokë. Dera ishte hequr dhe muri në krah të saj qe prishur.

«Këtë gjeta, s'kishte tjeter, — tha burri dhe tre-goi qysqinë. — Mbështetje na bën punë dhe kjo.»

«O burra, se u ngrys», — u hodh tjetri. Dy nga ata i vunë shpatullat një trungu të madh rrapi dhe i treti futi qysqinë nën të. Burrat rënkuant e trungu lëvizi drejt derës. Pastaj ata rënkuant përsëri dhe përsëri rrapi lëvizi.

«Zor të hyjë», — foli i gjymtuari dhe mori frysme thellë.

«Do hyjë», — ia priti tjetri.

«Ç'bëni kështu?» — s'duroi gazetari. S'foli njeri. Gazetari u skuq e buzëqeshi.

«Ç'bëjmë the? Ja, përpiqemi ta shpiem brenda këtë.» Gazetari buzëqeshi përsëri.

«Eshtë muzeu i fshatit ky, nuk e sheh?» Burri, i gjatë me mustaqe të kuqerremta tregoi me dorë tabelen e hequr e të vënë rrëzë murit. Gazetari prapë s'po kuptonte gjë. Ai bëri një gjest habie dhe tregoi trungun.

«Po mirë, këtë pse e futni brenda?» Burri, të cilin kishte takuar në fillim, lëshoi qysqinë dhe ngriti trupin.

«I pushtetit je ti, a?»

«I pushtetit», — vuri buzën në gaz gazetari. Burri e pa një hop.

«Eshtë monoment ky, monoment, merr vesh ti?»

«Ka luftuar Birçe Sinani te ky rrap, ore baba», — tha mustaqekuqi. Ai tundi kokën.

«E njeh Birçe Sinanin tiii? Katër sahat luftë. Ja këto këtu plumbi i ka bërë. I sheh këto?» Burri u përkul mbi trungun dhe diçka tregoi me gishtin e trashë ngjyrë dheu.

«Pyjorja e preu pyllin për sistemim, — shpjegoi burri me mustaqe të kuqerremta, — dhe rrapin na e dha neve si fshat. Eshtë yni ky. Tani do ta shtiem brenda, ta kemi në muze, po ja... po na mundon ca. Prishëm dhe murin se nuk e nxinte dera.»

«Eh, o Birçe Sinani!» Burri, të cilin e takoi në fillim, lëshoi rëndë dorën e tij mbi trung. Gazetari u mendua një çast me sytë në atë trung peme. Pastaj instinktivisht dora i preku bllokun në xhepin e majtë.

E lëshoi atë përsëri ngadalë në xhep dhe iu afrua më pranë trungut.

«S'kishin për ta vrarë të mos qe ai delenxhiu i Prroskës. Ai i nxori larot te selishtja e sipërme.»

«Edhe fishekët iu sosnë.»

«Mor po s'vritej ai, jooo. Eh, Birçe Sinani, Birçe Sinani, djalë për kokë të djalit ishte.» Gazetari preku ngadalë trungun. Nën mollëza ndjeu lëkurën e ashpër e plasa-plasa të trungut. Dhe për një çast iu duk sikur ai, Birçe Sinani, ishte aty, brenda atij. trungu dhe atë çast do të dilte, do të shtynte tej të dyja gjysmat e trungut e do të thoshte: «E si jeni, o shokë?»

«O burrani, se u turpëruam me kryetarë sot, i dhamë fjalën ta mbarojmë pa derman gjersa të bjerë dielli.» Gazetari rrinte ashtu duke shëtitur vështrimin sa nga njerëzit, tek ai trungu i madh i rrapit.

2. Tek ura e vogël e qytetit ishte grumbulluar një varg i gjatë makinash. Përmatanë urës, vinin në qytet autokombajnat e rrethit që kishin korru grunjëret e Korçës. Ato vinin ashtu të mëdha e të rënda duke mbushur me zhurmë e me pluhur udhën e qytetit. Kombajnerët ngrinin kasketat dhe përshëndetnin të njohurit.

«Ehej, ç'thotë Korça?»

«Pesëdhjetë kuintalë për hektar, këtë thotë.»

«Qenke shëndoshur, o Brahim, të paska prirë klima.»

«Ç'të mos shëndoshej ky? Një brigadë e Zicishit merrej me ushqimin e tij.» Ndihmësi tha këto fjalë dhe duke qeshur u ra krahëve të ustait të tij.

«Epo... ca shëndoshen, ca martohen; kështu është ndarë,» — shkeli syrin Brahim, kombajneri i kombajnës së parë dhe, duke qeshur, bëri shenjë për nga pas. Mësuesi, që i kishte folur, qeshi dhe ai pa marrë

vesh gjë dhe vazhdonte të përshëndeste kombajnerët e tjerë. Kombajnat kalonin. Nëpër sfurqet e tyre kishte tek-tuk ndonjë kërcell gruri. Çeliku i sfurqeve shkëlqente nën diellin e pasdites. Në kombajnën e gjashtë, veç kombajnerit dhe ndihmësit ishte dhe një çupë, e cila e skuqur flakë në fytyrë shihte përreth. Te këmbët kishte një 'bohçe. Kombajneri zgjati dorën dhe i hoqi shaminë nga koka. Asaj iu derdhën flokët pas dhe nga kjo gjë u turpërua dhe më keq, saqë s'dinte ku të futej nga turpi. Kombajneri me ndihmësin qeshën. Kontrolli rrugor, Seit Veloja e ndali kombajnën pranë kthesës. Ai i zbriti motorit dhe diç zuri t'i fliste kombajnerit duke bërë me shenjë lart. Zhurma ishte e madhe dhe ata jepnin e merrnin me duar. Nga kombajna kërceu poshtë ndihmëskombajneri dhe shkëmbëu ca fjalë me Seit Velon. Pastaj të dy ata ia dhanë të qeshurit duke treguar sipër nga kombajna. Kontrolli Seit Veloja i nderoi dhe u bëri shenjë të vazhdonin. Ai i hipi motorit dhe mbërriti duke qeshur tek ura.

«Ç'kishte, shoku Seit, kundravajtje?» Mësuesi buzëqeshi dhe e përshëndeti.

«Kundravajtje, — tha kontrolli rrugor, — ishin tre vetë në kombajnë. Po nejse... nganjëherë edhe lejohet. — Ai qeshi. — Ishte martuar qerratai. Kishte marrë një deli çupë nga Korça. Kishin që vjet dashuri. E bukur, ë?» Mësuesi i ra ballit dhe qeshi me të madhe. Dikush aty pranë tha:

«Të lumtë, Telo Stefani, e kishe hak, se na ndrove, ha, ha, he!» Mësuesi, akoma duke qeshur, pa përtej. Telo Stefani dhe nusja e tij e re dukeshin larg. Flokët e saj i hapte era dhe ajo përpinqej t'i mblidhë si duajt e grurit.

3. Grupi i nxënësve kapërceu bullevardin e

madh. Ata ishin rrëth njëzet vetë. Djemtë kishin ko-ka të qethura dhe vajzat, më të shumtata, gërshteta. Ato mbanin veshur triko të leshta. Të gjithë ecnin me druajtje, sikur të kishin frikë se mos bënин pis plakat katërkëndëshe të rrugës. E megjithatë, hareja fëmijërore e mposhtte këtë ndjenjë dhe herë-herë ata thoshin diçka me zë të lartë apo tregonin diçka me gëzim. Nxënësit kishin ardhur nga malësia për të parë Ekspositën e Madhe. Me ta ishin dy arsimtarë, Edmond Daiu, tiranas dhe Besa Malaj, mësuese muzike, bashkëfshatare me nxënësit. Mësuesja ecte bri tyre, ndërsa Edmond Daiu vinte pak si në fund. Ai kishte një qehre të prishur dhe vetullat gati sa s'i bashkoheshin mbi hundë. Frynte pak erë dhe ai përpiquej ta mbante brenda kostumit kravatën, që era ia hidhte mbi sup. Besa ktheu kokën dhe pa nga ai. Po ai bënte sikur s'e shihte vështrimin e saj. U takua me një shok dhe të dy u përqafuan. Ndérkaq nxënësit ecën përpara. Po djali nuk i shpejtoi hapat që t'i arrin-te. Mësuese Besa i mbajti nxënësit.

«Ecni, ecni, — foli ai si nëpër dhëmbë, — ç'më prisni mua!»

«Mondi, ç'ke, mos je pa qejf? Apo s'i gjete mirë në shtëpi?» Besa iu afrua. Sytë e çupës ishin të ngrohtë e dashamirës.

«S'kam gjë, jo,» — bëri ai dhe pa përpara. Mësuesja u foli dy djemve që ngriheshin. Ndérkaq Edmondi qe shkëputur pak nga grupi.

«Si duket s'ka qejf ta shohin të njohurit që është me këta nxënës fshatarë», — mendoi mësuese Besa dhe u tremb nga ky mendim. «Turp, turp të ketë.» Pastaj ajo pa nxënësit e saj dhe iu duk sikur dikush po ai fyente ata, po cënonte gëzimin e tyre. Dhe ai dikush ishte aty, aty prapa, ishte Edmond Daiu. S'e

kishte parë kurrë atë djalë me këtë sy mësuesja e re. Po ja sot ajo e vuri re qartë këtë shqetësim. Ajo pa përsëri atë dhe përsëri nxënësit e saj. Po vështri-mi i kishte tashmë një tjetër peshë. Nga shpirti i gjerrë i vajzës doli aq forcë, sa të mos lejonte lotët të mblidheshin në bajamet e syve të saj. Ajo nuk u bëri zë nxënësve të prisnin mësuesin elegant që takoi dy vajza të njobura. Vajzat treguan nxënësit me dorë dhe Edmond Daiu u skuq e për diçka bëri shaka. Mësuesja i largoi sytë nga ata dhe u përpooq të largonte dhë mendimin. Ajo u tregoi diçka nxënësve përmónumentin bri të cilit shkonin. Ajo hodhi flokët pas dhë qeshi me nxënësit e saj. Kjo e qeshur mbuloi dhembjen që ndjeu pak çaste më parë. Nxënësit ndiën gëzimin që buisi në fytyrën e mësueses. Dhe mbi supet e tyre nisi të letohej pesha e druajtjes. Pas grüpiti të fëmijëve, atje në largësi, vinte, duke ruajtur distancën, Edmond Daiu.

mbushur tē tridhjetat. Ajo e di që eshtë e bukur, se s'eshtë e vështirë ta kuptosh këtë gjë. Mirëpo mua më duket se ajo jeton vetëm pér hir tē kësaj bukurie. Ndoshta s'kam tē drejtë, por kam mendimin se ajo e vlerëson këtë, që eshtë një femër e bukur dhe njerëzit, e veçanërisht burrat, e pëlqejnë. Unë këtë mendim nuk e kam biseduar me njeri, as me Uljanin. Mbështetje ngaqë ai sillet me tē njëlloj si me çdo shoqe tjetër tē punës. (Kjo gjë Dolës nuk i pëlqen.) Kur grinden ata tē dy (kjo ndodh gjithmonë brenda kuadrit tē shakasë), unë përpinqem tē luaj rolin e arbitrit. Filloreta, apo Filloja, që eshtë shoqe e ngushtë e Dolës, argaliset së qeshuri. Ajo eshtë më e re në moshë e megjithatë e trajton Dolën si më tē vogël se veten, i thotë ca emra përkëdhelës, e quan «zog», «kukull», «artiste» dhe kurrrë s'ia kundërshton mendimin. Filloreta ka dy fëmijë dhe eshtë nga ata tipa që kalimin nga vajzë në nënë e bëjnë menjëherë, aq sa tē duket se ato kështu kanë qenë gjithmonë, gra me fëmijë...

Pra, ne vendosëm që ekskursionin ta bënim tē shtunën dhe kështu bëmë. Kishim lajmëruar me telegram hotelin e gjuetisë në N. Unë s'kisha qenë ndonjëherë atje. Uljani, po. Autobusi i pronotuar u mbush me zhurmë. Shefi hip i në autobus i fundit. Shumë zëra e ftuan:

«Shoku shef, urdhëro këtu përparrë!»
«Jo, këtu te dritarja, shoku shef!» Unë u ngrita dhe e tërroqa nga krahu:
«Hajde, — i thashë, — se Uljani ka marrë tavillën me vete dhe do t'iа kalojmë mirë udhës.»
«Oho, — bëri ai. — ... Jo, jo, po shkoj këtu te gratë se pér nder tē tyre e bëjmë ekskursionin, apo jo? Dola, ku ma ke vendin?»
«Se mos më thatë ju, shoku shef, që t'ju aruaja.

Megjithaté, urdhéro. Fillo, shtyhu më tutje.» Ajo kishte mbledhur flokét pas dhe dukej më e bukur se kurré. Hodhi një vështrim me ironi këtej nga ne. Uljani luante këmbën si me sustë.

«Ta hajë dreqi! — tha. — Kush ka një cigare?» Këtë shprehje të tijën e dija tashmë. Ai e thoshte vetëm kur nxehet. Mund të kishte vëtë cigare, por ja që kështu e thoshte. Unë buzëqesha dhe folat pér diçka tjetër, duke nxjerrë paketën. Drejtori që kishte zënë vend pérpara, me shoferin, na hoqi vërejtjen se s'duhej të pinim duhan aty. Unë buzëqesha pérseri si i zënë në faj. Autobusi u nis. Unë me Uljanin folém pér ndeshjen që kishim parë natën e shkuar në televizor. Pas nesh dëgjohëshin të qeshurat e grava. «E mjera unë! — thoshte Neta aty në krahinë. — Kush edi ç'bëjnë fëmijët! Të voglin e kisha dhe me pak temperaturë.» Ajo përplaste pa zhurmë pëllimbët dhe shikonte nga dritarja. Undje kitara e Agro-nit. Gratë filluan të këndonin.

«Hej, rini, po ju pse s'këndoni?» Këtë, drejtori e kishte pér ne. Ne buzëqeshëm. Atë qast kishim filluar lojën. Kishimi vënë kutinë e tavllës mbi gjunjët tanë dhe hidhnin zaretap. Autobusi shkiste në rrugën e asfaltuar. Koha që hapur pas ditësh të téra me shi. Në perëndim rete kishin nisur të skuqeshin. Midis gazit e të qëshurave, dëgjohej pas nesh, herë pas here, timbri i veçantë i zërit të Dolës. Ajo tha një herë: «E di ai më mirë, le të na e thotë ai mendjemadhi.» Dhe një herë tjetër: «Jo, po, thoni de, ai ka tjetër mendim, ai filozofi. Shiko, bën sïkur s'dëgjon.» Sigurisht, që e kishte fjalën pér Uljanin. Por ai s'kthente përgjigje. Uljani nu kështu fjalët e Dolës. Me sa kuptoja unë, ai

s'pará ua vinte shumë veshin fjalëve të saj, ndonëse sjelljet e saj shpesh e nervozonin... Pra, dhe Uljani mendoka si unë, për të.

«Hej, Uli, dëgjon apo jo? — thirri Filloja. — Ore... pse s'i kthen përgjigje çupës ti?»
«Lëre, moj, lëre, q'i flet atij mendjemadhi.»
«Parri, Fillo, se më ka vënë përpára ky, ka një dreq shansí sot..., si i do i biën zaret.» Uljani buzëqeshi dhe u kthyesh përséri. Shefi bëri një shaka dhe gratë qeshën. Ai është një burrë i shkathët e buzëgaz. Atij s'mund t'i thuash më i ri tanë, por ama dhe i vjetër s'i thua dot. Në përgjithësi, për sa kohë që jam këtu, mua më është dukur burrë i mirë. Nuk e lë punën t'i shikasë nga dora.
Unë hodha zaret dhe futa brenda dhe dy gurët e fundit. Buzëqesha dhe pashë me bisht të syrit nga Uljani.

«Shyqyr që fitove një herë», — tha ai.

«Kë quan një herë ti? Një muaj rrësht? Se më duket se këtë muaj s'ke fituar ndonjëherë.

«E...e!» — bëri ai një shprehje mospërfilljeje, më shaka.

«Qenka rrahur duket, shihe, Fillo, shihe si i ka varur turiçkat. Bravo Titi, ia bëre mirë.» Dola përplasi pëllëmbët dhe shoqet e saj e pasuan. Uljani tundi dorën dhe vështroi nga xhami.

«S'kemi kohë, të nisnim një tjetër», — tha. Vërtet, po arrinim në N. Shoferi e ndaloi autobusin pranë agjencisë.

«Mua gjer këtu më keni, o shokë, — tha ai pasi ktheu trupin pas, që nga ndenjësja e tij. — Hoteli tre çerekë ore mban në këmbë.» Pas u dëgjuan protesta. Drejtori diçka zuri t'i thotë shoferit.

«O...o!» — protestonin gratë.

«Po jo, mor shok, më duhet të kthehem. Nesër do të vij t'ju marr prapë.» Ne të dy mblodhëm gurët e tavllës. Shoferi, duke lënë hapur derën e pasagjerëve, zbriti poshtë dhe përplasi derën e tij.

«Epo, . . . — tha drejtori, — s'kemi se q'bëjmë.» Ai u mat të ngrihej. Dola me Stelën vrapuan midis sedilieve dhe kërcyen jashtë. Ato e vunë shoferin në mes. Ai kishte futur duart në xhepat e xhakaventos. Pastaj i nxori, dhe i mblodhi përpara fytyrës duke i tundur. Të gjithë bisedën ne e shihnim si pantonimë. Dola buzëqeshë me djallëzi. Ajo tundte kokën dhe përplaste këmbën pas bordurës së agjencisë. Shoferi ngriti kokën lart dhe hapi krahët anash. Ai buzëqeshi dhe bëri një shenjë nga autobusi. Të dyja gratë e tundën nga krahu dhe erdhën me trap duke qeshur.

«Mos luani, — tha Stela. — Iu mbush mendja. Kjo i mbush mendjen dhe dreqit, jo një copë shoféri.»

«U, të keqen!» — thirri Filloja. Dola kaloi pranë nesh me një vështrim triumfues. Pastaj u kthyeshi dhe u përkul drejt Uljanit:

«Ah, të të shihja të ecje më këmbë, që të të dilte gjuha, . . . na. . . .» Ajo vuri pëllëmbën para gojës duke qeshur.

«Mos ma qaj hallin, jam mësuar unë. Shpëtuan këpucët e tua lustrine, atë thuaj.» Uljani buzëqeshi. Po unë e kuptova që ai ishte i nervozuar. Prapa nesh u bë zhurmë e u ndien të qeshura. Shefi po përgëzon te dy gratë që kishin bindur shoferin. Unë me Uljanin dhe Agronin zbritëm të pinim nga një cigare. Shoferi erdhi pas pak.

«Ikim?» — na tha neve dhe u ngjit në sedilie. Ne flakëm bishtat e cigareve dhe zumë vendet tonë. Shoferi ktheu kokën me një të qeshur në buzë.

«Ç'të bësh, — tha, — kanë festën! gratë. Ç'të bësh?!...» Ai ndezi motorin.

«U bëfsh lëmsh!» — pëshpëriti, gjysmë me vete, Uljani: «Në fakt, sikur s'na e kishte qejfi të zbrisnim se të ecnim këmbë», — fola unë.

«Edhe mua s'na kishte qejfi», — tha ai prerë. Nga pas filluan përsëri këngën. Ishte një këngë e vjetër, që këndohej gjithmonë. Në të përsëritez në fund të çdo vargu fraza: «Cohu, filan, e merr një valle!» Kur erdhi radha për të thënë këtë, Dola e ngriti zërin mbi shoqet: «Ngrehu, Uljan, e merr një valle!» Plasi e qeshura, Gratë përplasnin pëllëmbët. Tani vinte vargu tjetër i këngës: «Kape fistëkun, kape fistëkun dorë përdore!...». Uljani u ngrit në këmbë dhe zuri dorën time. Ai thirri:

«Kape Titin, kape Titin dorë përdore, mashalla, mashalla sa m'paska hije.». Drejtori buzëqeshtë me gjithë shpirt, ndërsa shefi queshtë me zhurmë, së bashku me gratë. Uljani fshiu ballin me shami. Ne të dy u pamë në sy. Shumë herë përpiqemi ta kuptojmë në këtë mënyrë njëri-tjetrin. Dhe ai, dhe unë s'kemi qejf të themi shumë fjalë. Pse u ngrit ai dhe këndoi? Ai s'kishte atë tip. Kurre s'ka kënduar. Ndoshta s'donte që në vend të emrit tim të thuhej ndonjë emër tjetër, për shembull të thuhej: «Kape Dolën, kape Dolën dorë përdore!», që ndonjë nga çupat shejtane mund ta thoshte. Ndoshta e bëri nga kjo. Ndoshta. Ku ta dish. Ndërkaq ne kishim arritur. Pse i thonë këtij hoteli Hoteli i Gjuetisë? Ndoshta vijnë shumë gjuetarë këtu.

«Nga jashtë s'duket gjë hiç, — tha Uljani, — po brenda është bukur.» Shoferi hapi derën. Ne zbritëm

nié zhurni. U futem nié hotel. Ata na prisnin. Lamé plaçkat dhe dolém përséri né oborr. Hoteli ishte vërd tet i bukur. Ai kundërmonte një erëntë këndshme pishe. Gratë lëshonin pasthirima gëzimi. Ndërkaj ishi te erruri. Ngapérëndimi i ridhni thërrimet e fundit të dritës së diellit që kishte kohë që qëfishetur në horizont. Ajri ishte i freskët dhe me lagëstirë. Dola hodhi nënqafë një shall akrilik. Siç dukej ajo kishtë qenë dhejmë parë aty. Edhe kamerieri dukej é njihtë; së përshtëndeti kushtkuam. Në vendëm ca riëpër oborr. Agroni kishtë mbështetur kokëtëmbi kitarë dhe lëshote ca akorde që dukej sikur i përpinte mbrëmja. Pranë tij ishin Maqoja dhë Zana me Sonjën. Zana seçi thoshte përnjë këngë dhe ai përpiquej ta mësonte. Orali vajti tetë dhë ne u ulëm të hanim darkë. Tavolinat ishin vënë rresht, të gjitha bashkë. Shefi qe ulur në mes të Dolës e Stelës. Në krye i kishim lënë vendin drejtorit, jo përgjë tjetëry pëse të tërë e dornin dhë e respektonim atë njeri të mirë dhe punëton.

«Pu, pu, — tha shefi si përi t'u justifikuar, — dhe vështroi nga ne të dy, — akoma më dheim bëskoka nga rruga. M' i fixorën mendtë fare gratë, përnderi.» Ai qeshi dhe vështroi anash.

«Ashtu? — Dola bëri sikur vrenjtë vetullat! — Po hë, prà, pse trimi këtu, atëherë, meqë ju paskemi mëjrrë mendtë?... Kür s'paske qejf.»
«O... o!... bënë gratë e tjera pëtretë, dhe qeshëni. Shejtan që është...», — bëri shefi dhe përséri sikur kërkoi aprovimin tonë. Unë buzëqesha. Uljani bënte sikur s'e kishte mendjen aty dhe po i thoshte përdicë që nga larg kamerierit. Ganiu, një shok yni, tha përséri një sentencë morali ashtu, me atë mënyrën e tij origjinale. Unë qeshë. Në përgjithësi, të gjë-

thë ishin të gjuar ne të kënaqur. Dollinë e parë e ngriti drejtori, Pastaj e mori fjalën (ndonëse s'ia dha njeri) shefi, i cili përpipetë të bënte shaka. Pastaj tha ca gjëra të përgjithshme. Pastaj bëri një shaka. Kënduam këngë. Ngriti një dolli dhe i uroi gratë Ganiu. Edhe unë thashë nga dy fjalë dhe urova përfestën.

«Bravo, Titi, — tha Dola, — paske damar poeti.» Pastaj plasi një diskutim: A është 8 Marsi festa e të gjitha grave pa përjashtim, apo vetëm e grave dhe jo e vajzave? Të gjithë flisnim me zë të lartë dhe mezi merreshim vesh. Pas nga dy orësh u mblohdhëm tek oxhaku i madh dhe vazhduam përsëri shakatë e këngët. Uljani seç tregonte. Zana, Sonja e Neta qeshnin me lotë. Drejtori ulej herë me një grup e herë me një tjetër. Ndërsa shefi s'iu nda asnjë çast Dolës. Hodha sytë dhe pashë Dolën që i bëri një shenjë Fillos. Shefija donte të thoshte: «C'më mërziti dhe ky!» Shefi, pikërisht atë çast tha diçka dhe ajo qeshi duke përkulur kokën pas. Flokët iu shpleksën dhe ajo i mblohdhi me dorë.

«Uf, id! — bëri. — M'ilidh një çikë, Fillo.» Shefi zgjati dorën t'ia mbante po e tërhoqi prapë.

«Eh, të kishim një magnetofon, — tha ai, — të kërcenim», — dhe i dha dorës përpjetë.

«Shih, shih, shefi!» — qeshi Neta.

«Për ju e pata, — bëri ai, — se pér ne mori fund puna», — foli, duke dashur të fuste në këtë mes dhe drejtorin. Gratë qeshën. «Nuk e besoj», — tha Dola.

«Çfarë nuk beson?»

«Ja, që ka marrë fund puna juaj!»

«Unë, s'thashë gjë», — bëri shaka dhe drejtori, ndërsa shefi qeshi me të madhe dhe përsëriti disa herë fjalën «shejtan!»

Ora kishte kaluar nga njëmbëdhjeta. Të gjithë kishim ardhur në qejf. Në fakt mbrëmja kaloi bukur.

«A, more shokë, kur s'është gjithmonë 8 Mars!» — thirri Ganiu. E qeshura vazhdoi gjatë. Nisën gjë e gjëzat. Dola u përkul nga ne.

«C'ke, që i ke varur turinjtë?» — i tha ajo Uljanit.

«Unë?... Pse, c'të bëj? Veç të bëj vertikalën, që të të mbushet mendja se jam në qejf.»

«Vertikalën të bësh.»

«Mos, moj, edhe gjysmë ore dhe kalojmë më 9 mars, — tha me shaka Uljani, — gjer në orën dytëmbëdhjetë e keni ju gratë.» Dola fliste kot, pasi unë Uljanin rrallë e kisha parë me aq humor. Arriti një moment, sa pothuajse të gjithë qenë mbledhur rreth tij dhe ai tregonte ç'bënte në stadium një shok tifoz. Gratë vdiqën së qeshuri. Dola tha me zë të ulët se do të donte një kafe tanë.

«C'afe? — bëri Filloja. — Ata e kanë mbyllur kuzhinën tanë.»

«Dua!» — buzëqeshi Dola dhe mblođhi buzët si fëmijë e vogël. Ajo i kishte hedhur krahët rreth gjunjëve. Pastaj u kthye nga shefi:

«Kush është burrë, më sjell një kafe tanë». Shefi u përpooq të buzëqeshëte. Ai u hoq si kur s'e kishte mendjen aty. Dola u përkul drejt tij. Ai qeshi përsëri.

«S'uа prishim grave sot, — tha dhe u ngrit. Pas pak (në fakt kjo «pak» mua m'u duk shumë e gjatë) u kthye me filxhanin e kafes në dorë. Uljani kishte mbledhur vetullat.

«Dreqi ta hajë, — tha, — kush ka një cigare?» Unë buzëqesha dhe nxora paketën. Ne e ndezëm dhe u pamë në sy.

«Zgjate dhe këtëj, mos u bëj kurrnac, Titi, sot

na lejohet edhe neve»! Dola buzëqëshi. Ajo e mbante filxhanin me elegancë mbi pjatë.

«Jo... ç'ne...!» — thashë.

«U, u... i paske pa filtër», — shtrembëroi buzet ajo. Shefi i zgjati paketën e tij. Ajo e mori dhe erdhi pranë mesh.

«Të paktën, ma ndizni», — tha.

«Kujdes, — tha Uljani, — kujdes mos derdhësh kafen.»

«S'ka gjë, — tha ajo. — Do shkosh ti të më marrësh një tjetër.»

«Po, kur të jetë tetëdhjetë marsi, jo tetë marsi», — shfryu ai. Sonja diç i thoshte Zaniës. Unë e dija që shumë sjellje të Dolës atyre nuk u pëlqenin. Ganiu ia mori këngës përsëri. Ganiu këndonte me pasion, me sytë pak të mbyllur dhe gratë e ndiqnin këngën me fjalë e me të qeshura. Shkuam të flimin vonë, pas dyimbëdhjetës. Unë isha një dhomë me Uljanin. Kur hymë aty, ai përsëri tha atë të famshmen: «Dreqi ta hajë, kush ka një cigare?»

«Mor, po ç'ke kështu ti? — thashë. — Mirë kaloi më duket. Ajo Dola e teproi një çikë, po lëre, ç'ke me të.» Ai shfryu. Futi gishtérinjtë në flokë dhe u lëshua në shtrat.

«Po të mos ishte e bukur, ajo do të ishte një hiç, — tha ai dhe më pa në sy. — E kupton ti këtë? Pse duhet të sillet kështu ajo? Shfrytëzon faktin që është e bukur dhe dobësitë e të tjereve ndaj këtij fakti, për të plotësuar çdo kapriçio të saj. Dhe gati gjithmonë i ecën. Dëgjo, Titi, unë e njoh mirë Dolën, ajo... ajo është e ndershme. Një grua si ajo nuk mund ta quash imorale, në asnje mënyrë. Po ç'emër t'i vëmë? Thua është natyra e femrës kështu? Nuk e besoj. Jo të gjitha sillen si ajo. E pe ç'bëri me shefin?»

«Ai ndezi cigaren dhe e thithi me fuqi. Faqet iu bënë me gropë.

«Ç'ke me të?! — thashë unë përséri. — Ai piu një çikë, ishte në qejf, fundja e çfarë se i plotësoi një dëshirë asaj? Them që ai është burrë i mirë».

«I mirë? Kush tha se është i keq? Po, mirësia është koncept relativ, ashtu si çdo koncept, mor Titi. Ohu...» — bëri ai dhe nisi të zhvishej. Unë ibuzëqesha. Nuk mendoja ashtu si fola, por doja ta qetësoja atë. Ai e fiku cigaren në tavllë dhe u fut në shtrat. Unë ndenja ashtu një kohë. Pastaj ndeza abazhurin te koka e krevatit tim dhe fiqar ditën e dhomës. Nuk kisha gjumë! Akoma taniorituk kám. Ja, mora blokun dhe shkrova këta rrreshtha. Më ndodh ndonjëherë kështu. Ç'kam shkruar gjér tani, s'm' i ka lexuar askush veç Genit e Nikos, shokëve të mi të shkollës. Ata thonë se unë mund të bëhem ishkrimtar. Sigurisht, që më bëjnë qejfin. As Uljanit nuk i kam thënë se shkruaj. Tani, ai po fle. Foli ca fjalë nëpër dhëmbë ashtu nëpër gjumë. Është djalë i mirë Uljani. Po ishite inatosur shumë. Unë i mendova me vete ato që më tha ai dhë ato që shoh, dëgjoj, jetoj vetë. Dhe më duket se ai ka të drejtë. Nuk di dhe vetë si ta shpjegoj, por ai ka të drejtë. Një njeri të dobët, Dola mund ta shpjerë në një hap mjaft të gabuar, mund të bëjë që ky njeri të ndërmarrë diçka që dëmton jo vetëm atë por dhe shumë gjëra të tjera që lidhen me të. Mos ka faj vetëm Dola, apo cilado Dolë tjetër? Jo, nuk kanë faj vetëm ato. Njeriu duhet të jetë dinjitoz. Koncepti dinjitet i shkon vetëm njeriut, asnjë qenieje tjetër. Kjo ka të bëjë diçka me pushtetin e logjikës së ftotë, racionale, mbi dallgët e ndjenjave dhe të paqioneve që i buisnin njeriut në shpirti.

Pse i shkrova të gjitha këto? — As unë nuk e di,

Po ja... më duket sikur bisedoj me veten. Është një tregim kjo që shkrova? Mbase nuk është tregim. Po a ka rëndësi kjo? Unë lashë lapsin dhe pashë fytyrën e Uljanit. Ai qe kthyer këtej, ashtu nëpër gjumë. «Ai është djalë i mirë, — them me vete, — dhe unë do ta kem një shok të mirë». Dhe vendosa lapsin mbi këto fletë letre që shkrova.

LOKALI PRANË JETËS

Kiske pak kohë që maturantja Valbona Hasimi ishte kamariere në barin e bar-restorantit «Teuta». Kur i kishin treguar punën, asaj i qenë dukur të gjitha të qarta e të thjeshta. Po kur, me bluzën e zezë e përparësen e bardhë, me koronën me frudat në flokët gështenjë, të cilat i mbledhë pas, dhe me tabakanë në dorë, u mat të dilte nga banaku në sallën e barit, mbeti një çast e shtangur dhe i erdhi sikur po i lozta e gjithë dyshemeja nën këmbë.

«Ç'ke, moj ibijë, ç'ke, moj të keqen? Hajde, me këmbë të mbarë!» Tefta, banalkierja e vjetër e shtyu lehtë dhe me buzën në gaz. Ajo bëri dy hapa dhe ja, u gjend në mes të tavolinave.

«Ouuu!» — bëri dikush,

«Shoqe, dy kafe, të lutem, dhe një sifon.» Vajza kishte në fytyrë një buzëqeshje të madhe, që ua dhronte të gjithëve... Kjo ishte dita e parë në punë.

Kurse tani i ishin bëre disa javë aty. Shumë nga frekuentuesit e rregullt të barit i ishin bëre ftyra të njohura. Ca nga ata e thërrisnin me emrin e plotë, disa «Vali!», disa «Bona!». Ajo lëvizte midis tavolinave e lehtë dhe e shpejtë. Ky burri i shëndo-

shë, në ditët e para e kishte thirrur t'i paguante dhe i la 5 lekë në vend të 4 e 30 qindarkave dhe që ngri-
tur të ikte normalisht. Ajo e kishte arritur te dera dhe
i kishte kthyer 20 qindarkat. Burri e kishte parë me
çudi dhe kishte buzëqeshur, duke formuar me buzët
e fryra një «O» saqë ajo, po të kishte pasur pranë De-
tin, shoqen e saj të ngushtë, do tia kishte shkrepur ga-
zit me të madhe. Ja dhe ai atje, mjeku K. me cigaren e
varur në cep të buzës, i shkurtër e i zeshkët, që duket
mendjemadh, në fillim e thërriste «Çupë!», me zërin
pak si të ngjirur e pa e parë fare në sy. Pastaj zuri
t'i fliste me emër por, gjithmonë, ajo pati përshtyp-
jen se ky njeri do të kishte konstatuar se, ngaqë vin-
te i shkurtër, kishte një çikë nevojë për ashpërsi e
sjellje të rëndë dhe këtë gjë përpinqej ta fitonte me
nuancën e zërit dhe mënyrën e sjelljes. Valbona vuri
buzën në gaz nga ky mendim. Në bar hyri dhe kom-
pozitori B. C. plot jetë e gjallëri. Ai u afroa te banaku
dhe kërkoi një paketë me filtër.

«C'hotë kësulkuqja jonë e vogël?» — tha ai dhe
bëri «Uuu!», sikur imitonë ujkun. Ajo qeshi. Nuk
e dinte pse i thoshte kështu ai, «Kësulkuqe». Valbo-
na çoi porosinë te dy tavolinat e qoshes dhe u kthye
përsëri te banaku. Mbështeti njërin krah aty dhe
mendua. I pëlqente puna e saj. Në fakt, më saktë du-
hej thënë: kishte nisur t'i pëlqente. Është një punë
me shumë jetë, mendonte ajo, me shumë njerëz. Lloj-
-lloj shqetësimesh e gjëzimesh vijnë e mblidhen në
këto tavolina. Përkrah njëri-tjetrit mund të rinë një
pensionist, që bën bilancin e jetës së tij, me një nxë-
nëse shkollë që së bashku me shoqen e saj, tek lëpijkenë
duke përplasur buzët akulloren e bardhë me re-
çel, mund të mendojnë gabimisht se kështu do të lë-
pijnë gjithë jetën e tyre. Vijnë punëtorë dhe nëpu-

nës, të sapomartuar e nga ata që një ditë do të martoheren, vijnë artistë, shkencëtarë. . . vjen dhe Ai. Ai? G'është Ai? (Asaj i zbehet buzëgazi dhe kërkon prej vetes një pamje të ngrysur! Pse i pëlqen Ai? Ajo e largon mendjen dhe afrohet në një nga tavolinat ku e thërrasin. Te dera ndihen zëra. Ajo kthen kokën dhe skuqet pa dashje. Është Ai me dy shokë. Të trëzënë një nga tavolinat pranë xhamit që ndan barin nga restoranti. Njëri nga ata ngrë dorën lart, po ajo bën sikur s'e sheh. Lëviz me shpejtësi nëpër sallë, si mbi akull dhe bëhet më e gjallë dhe më e qeshur se më parë.

«Bona! Një kafe, thuaj Leftës, se e di ajo si e dua tunë».

«Valbonë, moj bijë, si e harrove balbën tënd, moj bijë!» «Shoqe, dy xupa, të litem!» Këto të fundit janë studente. Ajo vrapon nga tavolinat rië banak dhe anasjelltas. Dikush nga ata të tre e thërret në emër. Ajo afrohet dhe merr porosinë. Ai s'ia ndan sytë. Valbona nuk e di se g'është Ai! Dikush i ka thënë se është një poet i ri, që ka botuar një libër me vjersha. Ajo shpie tek ata tri fërnete dhe kthehet në banak. «Gjithmonë fërnet pi», — thotë dhe përsëri kërkon prej vetes një pamje të ngrysur. E largon mendjen dhe përsëri mendon pér punën e saj. Sa ndryshon jeta e shkollës nga jeta e punës, thotë ajo. Shumë gjëra i mendoja ndryshe, i dija ndryshe. Kurse tanjami në mes të njerëzve, si në një udhëkryq. Në lokalin tim hyn e gjithë jeta e qytetit, njerëz, gazmorë e të vrenjtar, seriozë e hokatarë, hyjnë realizimi i planeve e sukseset e arritura, festivalet që bëhen, koncertet që jepen. Ja, tek ajo tavolina rrinte dje kompozitori B. C. me një poet. Ata e kishin thirrur dhe i kishin lexuar

një tekst këngë. «Na gjej një titull, — i kishin thënë, — së e këmi pér festivalin e radios. Ajo e kishte lëxuat dhe kishte nibledhur supet buzegaz. Pastaj kishte thënë: «Vërjani» Dielli brenda zemrave».» Ata të dy qenë parë me njëri-tjetrin dhe e kishin pëlqyer. «Mirë, — kishte thënë kompozitorii B. C., — të takojnë dy ftesa pér një natë të festivalit. Pasnesër do të t'i sjell, moj Kësulëkuqe.» Dhe bëri «Uuu!» si ujku...»

Nga tavolina e Atij e thirrën përsëri. Ajo u ngrys dhe shpuri përsëri atje tri fërnete. Këtë herë ajo vettë u përpoq të shihte sytë e tij. Djali mbeti si i prerë dhe diç i tha këtë së kati shokut.

«Si the, ore? — pyeti shokut i tij. — Ç'flet, mior Tos? Ç'hotë ky kështu, o Beni?» — Iu kthyesh shokut tjetër dhe qeshi me të madhe. Pas krahëve të Valbonës u ndie zhurmë karrigesh që lëviznin. Dikush i foli:

«Shoqja kameriere, kur të keni mundësi kushtojini pak vëmendje përfaqësuesve të klasës punëtore të Fierzës.» Ajo u kthyesh dhe lëshoi një pasthirrmë habbie. Pastaj u përqafua me Lekon dhe me të gjashtë shokët e saj të maturës që bënin stazhin në Fierzë. Në lokal u bë zhurmë e madhe dhe Valbona u skuq nga turpi. Duke shërbyer nëpër tavolina, ajo gjente rastin të shkëmbente dy-tri fjalë me shokët e saj.

«Vali, të paguaj unë, të lutem!»

«Valbonë, urdhëro këto të miat, tamam i ke, dëgjon, moj?!» Doktori vuri në kokë «republikën» e tij dhe ndezi cigaren e varur në buzë. Tek ngrihej nga karrigia, e gjëti të nevojshme t'i thoshte edhe se kishte shumë klientë atë ditë, po ajo të mos mërzitez e të mos ngatërrrohej. Ai ngriti lart gishtërinjtë pér pëershëndetje dhe iku. Ajo buzëqeshi me çiltërsi, pastaj u ngrys. Pa nga tavolina e Atij. Djali kishte mbetur i

ngrirë. Dy shokët e tij flisnin e qeshnin, kurse Ai vetëm sa u mbante ison. Ajo tavolinë nisi të bëhej e bezdissishme për klientët përreth. Djemtë qeshnin me zë, të lartë dhe mbështeteshin rëndë në shpinat e karrigeve, të cilat lëkundeshin mbi dy këmbët e pasme e gati sa s'binin praptazi. Valbona përcoll shokët e saj te dera dhe rendi përsëri tavolinave. Djemtë e thirrën përsëri. Këtë herë foli Ai:

«Tri fërmate të tjera», — tha.
«Fërnet nuk ka më», — tha ajo prerë dhe e pa në sy. Djali i hoqi sytë me vështirësi.

«Ou, si kështu, — tha njëri nga ata, — nuk ka fërnet?»

«Nuk ju sjell më fërnet, — tha ajo ngadalë e zë- ulët. — Si s'keni turp! — bëri pastaj shpejt e shpejt dhe sytë iu rrëmbushën. Djemtë panë atë pastaj shoku-shokun. Ai ishte zbehur në fytyrë dhe gishterinjtë e duarve iu zbardhën, tek shtrëngonte cepin e tavolinës. Heshtën e s'folën një fjalë. Ajo rrëmbeu goftat e zbrazëta dhe u largua. Kapërceu lotët dhe i buzëqeshi artistit Ramo Mezini që luante në një film të fundit. Djemtë u ngritën nga tavolina. Ai erdhë te cepi i banakut dhe vuri të hollat në tabaka. Nuk e ngrinte fare kokën. «Na fal, — tha ashtu kokulur, — na . . . ja, ashtu; ne . . . ma fal!» — Dhe u largua rrëmbimthi. Ajo e ndoqi me sy tek zbriste shkallët të arrinte shokët. Pas xhamit, të dërsirë të barit, njëri prej tyre diç i tha Atij, po Ai bëri me dorë një shenjë padurimi dhe eci përpara. Valbona Hasimi deshi, të mendonte diçka për të, diçka të mirë, me të cilën do t'i dukej se do të ngushëllohet, po s'mendoi dot asgjë.

«Vali, moj çupë, po hajde, moj xhan, këtu!»

Vajza buzëqeshi e lodhur.

«Shoqja kameriere, më duket se e tepruat tanë.

Kemi gjysmë ore që presim. Shërbim i thonë këtij? Ky i fundit ishte një i sapomartuar apo i sapofejuar, dukej. Valbona i buzëqeshi ëmbël. Buzëqeshi dhe nusja apo e fejuara. Djaloshi u çarmatos, inati iu tret dhe vuri buzën në gaz edhe ai.

«Urdhëroni!» — belbëzoi kamerierja mekanikisht, po mendjen s'e kishte aty.

Markins dříve vystudoval na vysoké škole v Praze, kde studoval filosofii a psychologii. V roce 1945 byl povýšen na kapitána a v roce 1948 na majora. Od roku 1950 do roku 1955 byl komandantem 1. pluku 1. československého letectva v Praze. Po skončení vojenské služby se vrátil do Prahy, kde pracoval jako ředitel Československého institutu pro vzdělávání v zahraničí. V roce 1968 byl povýšen na brigádního generála a v roce 1972 na generála. Od roku 1974 do roku 1989 byl ředitelem Československého institutu pro vzdělávání v zahraničí. V roce 1989 byl povýšen na generála armády.

Çiftok qendri i komandantit e ushtarakëve, qëndrueshëm i cili ka
zëvendësuar së putojët e tij, është një komandant i ri
sëllë. Nëpër çdo gjë që është i lidhur me komandantin, jeshin
një që i tashë se kurrë që nuk është i lidhur me komandantin. Në
një që i tashë se kurrë që nuk është i lidhur me komandantin,
një që i tashë se kurrë që nuk është i lidhur me komandantin.
Nëpër çdo gjë që është i lidhur me komandantin, jeshin
një që i tashë se kurrë që nuk është i lidhur me komandantin.

K O M A N D A N T I

Kishte njëmbëdhjetë ditë që vazhdonte «loja»
ushtarake. Netëve, në qafat e maleve gulçomin maki-
na të rënda, mbuluar me mushama të gjelbër e me
rrjeta. Kolonat e ushtarëve lëviznin me fshehtësi për-
mes dendësisë së pyjeve. Mbi dheun e njomë, ngopur
nga shirat e pranverës, dukeshin gjurmë rrotash e
zinxhirësh. Fshatarët e atyre anëve vinin pëllëmbën
mbi ballë dhe picëronin sytë nga qafa e malit. Ata
mbushnin gjoksin me frymë dhe thoshin me një ndje-
një të dukshme kënaqësie: «Dee, more, pa shih ç'bë-
het. I çanë malet, mor, i çanë.»

Makina që lëvizte më shumë, ishte një Gaz. E
njihnin atë të gjithë pjesëmarrësit e lojës dhe banorët
e fshatrave përreth. Ishte makina e komandantit.
Njëmbëdhjetë ditë ai s'i kishte hequr çizmet nga këm-
bët. Pluhuri kishte hyrë thellë në lëkurën e atyre
çizmeve dhe vijat e formuara nga lëvizjet e këmbëve
dukeshin si të çara. Komandanti ishte fjalëpaktë dhe
i rreptë. Në rrugët e vështira të malit apo në pllaja
e gryka pa rrugë fare, shoferi i bënte sytë katër e
shtrëngonte timonin. Po të ngekte diku, ai e dinte që
zëri i komandantit do të bubullinte patjetër dhe do

ta shante që po vonoheshin. Pastaj edhe vetë komandanti do të dilit ta shtynte makinën, gjersa ta nxirrin andej kur kishte mbetur. «Hajde tani, — thoshte ai, — jepi tani, ne po të shpiem ty, jo ti ne.» Shoferi vinte buzën në gaz si fshehurazi e mbërthente timonin. Shpesh ngapagjumësia, komandantit i binte koka përpara. Qëllonte që edhe vritej te xhami. Atëherë shante nëpër dhëmbë dhe ngrinte trupin për t'i rezistuar gjumit. Shoferi, kur shihej që nën troshitjet e makinës komandantit i mylleshin sytë dhe i anohej koka, ndalonte ngadalë-ndalë, shihej në sy me oficerin e shtabit dhe vinte gishtin te buzët. Komandanti përmendej dhe pyeste se ç'kishin që s'ecnin.

«Eshtë prishur një kandele, shoku komendant, dy minuta dhe e rregulloj.»

«Ai, more ti!». Komandanti shante sipas zakonit. Shoferi kërcente jashtë e hapte motorin. Pas pak komandanti dremiste me kokën e mbështetur mbi shpinoren. Shoferi përsëri shihej në sy me tjetrin dhe buzëqeshmin të dy. Pas pak ai zgjohet.

«More, prapë këtu ti?!»
«Si urdhëron, shoku komendant, ja, u nisëm, shoku komendant.» Shoferi i jepte gaz dhe makina tundej nga vendi me zhurmë.

... Atë ditë ata po shkonin të shihnin forcat e krahut tjeter, matanë malit. Kur zbritën në xhade, shoferi pshëretiu i lehtesar.

«E, shpëtove, ë? — bëri komandanti. — Dashke asfalt zotrote. Po në luftë, kur ta bën armiku xhadën dhëmbë-dhëmbë e me gropë, sa të hysh ti i téri benda, qysh do ia bësh, ë?» Shoferi buzëqeshi. Ai ia njihet tani të gjitha huqet e zakonet komandantit të tij. Në tonin e rreptë e si me inat të atyre fjalëve, shoferi ndiente shpirtin e mirë atëror dhe dëshirën për të

bërë, shaka pór edhe përtë thënë një të vërtelë së bashku me të. Ç'ishtë e vërteta, tensioni dhe pagjumësia e atyre ditëve e kishin bërë më nervoz komandantin. Po shoferi e njihet imirë dhe të gjithë vartësit e tij e njihnin mirë. Ata të gjithë e dinin se sa përpiquej ai pér secilin, dinte hollësira nga jetë e shumëkujt, dinte pér fëmijët e tyre dhe pér shallet që mund të kishte filani apo filani. «Dëshmi i dytë i jepur a bëj Shefi i ndërlidhjes, Azbi Sinani, që prapa e shikonte se komandanti me përpjekje të mëdha po e mbante kokën të mos i binte në gjoks. Në asfalt, ku tronditjet e makinës ishin zbutur, kjo rezistencë ishte mjaft e yështirë. «Pushejmë, pak, shoku komandant, ju u kapitët fare,» — tha ai.

«C'na thua, more?! T'i bëjmë radiogram armikut: Dy orë pushim sa të flemë një cikë gjumë. E? Jo, more.» Të tjerët qeshën.

«Hajde ti, mos u zgërdhi; po, jepi gaz se u vonumat.» Ai vuri dorën te mbajtësja dhe i dha trupit përrpara. Ishte mbrëmje me hënë. Kaluan mëpër qytetin e vogël. Te sheshi kishte fare pak mjerëz. Në të dalë të qytetit, dritat e makinës përfshinë një çift që rrinte te trungu i një peme, buzë xhades.

«Mbaje, — bëni komandanti, — jepi pas, hë, dëgjon?» Shoferi frenoi me vrull. Ferrodat kuisën. Azbi Sinani bëri një shprehje çudie dhe pa nga xhami. Makina lëvizi me zhurmë pas. Dy siluetat te pemë ishin një djale e një vajzë. Djali ishte oficer. Komandanti u hodhi dritën e elektrikut të dorës. Qe e çuditshme se si e vuri re ai oficerin në gjithë atë shpejtësi të makinës. Oficeri ngriu në drejtqëndrim.

«Pa shih, pa shih, ç'bën këtu ti, karafil, dashuri, ë? Shokët bëjnë luftë, ti bën dashuri. Jo moreeee!»

«Shoku...» — oficerit iu mör goja e belbëzoi diçka.

«Pusho!» — thirri komandanti.

«Si urdhëron, shoku...»
«Në luftë për këtë pushkatoresh. Dezertor!» Shoferi ndjeu zérin e ngjirur të komandantit dhe e kuptoi se ai ishte nxehur mjaft. «Futu brenda, të arrestoj në vend!» Shef Azbiu hapi derën e makinës dhe djali, duke hyrë, përpoqi kokën pas paretit anësor. Vajza kafshonten buzën e poshtme e skërmiste me gishtërinj koren e pemës. Oficeri deshi të thoshte diçka.

«Nisu... mos...», — u dëgjua prej tij kur gumëzhiu motori. Vajzës iu mbushën sytë me lotë, po gjëjn s'e hapi fare. Shoferi shkeli gazin dhe makina shkau më shpejtësi në rrugë. Komandantit s'i kishin rënë të tijat.

«I ç'reparti je ti?» — buçiti ai.

«Jam oficer i repartit... Reparti im s'është caktuar të marrë pjesë në lojë.» Oficeri mezi mundi t'i nxirrte këto fjalë ashtu gjysma-gjysma. Komandanti s'foli një hop.

«Hë, hë! — bëri ai. — Hë, hë! — bëri përséri. — Domethënë s'qenki në lojë ju? È...? Po mirë... gjene, duhet të jeni në gatishmëri. S'duhej të të jepnin leje atëherë. Apo ke iikur pa leje?» Toni i tij u zbut.

«Jo, shoku komandant, — oficeri diçka e kishte marrë veten po zëri përséri i dridhej. — Kishte dhënë e fejuara një provim dhe komandanti im më lejoi ta përcjell gjer në qytet. «Azbi Sinani i vuri dorën në gju. Një çast u bë heshtje.

«Domethënë ajo ishte e fejuara, ë?»

«Si urdhëron, shoku komandant.» Komandanti bëri përséri «hë, hë» dhe heshti përséri. Ai shikonte

përpara pochtuk i rrihej në sedilie. I dha trupit dhe u kthye pas. Oficeri i ri vështroi sytë e tij të enjtur nga pagjumësia dhe vetullat e rëna.

«Ç'notë mori nusja jote në provim?» Oficeri kthëu kokën anashë dhe pa me habi atë që kishte në krah. «Tetë, shoku komandant!» Azbi Sinani ndjeu se si djalimi pëershkoi një fërgëllimë e lehtë. «Hë, hë, — bëri komandanti, — kurse unë... u rrëzoja në këtë provimin me ty, or djalë, more vesh, u rrëzoja. Ktheje makirën, ti, ore!» Shoferi e pa në sy: «Ktheje, ore, të thashë, dëgjon apo jo? Ç'më sheh ashtu?» — thirri komandanti. Makina frenoi dhe u kthyë në çast. Motori futuronte. Pas pak dritat nxorën në pah vajzën që lekte me të shpejtë ndanë xhades. Ajo ktheu kokën. Mbi faqe kishte një vazhdë lotësh. Klithma e frenimit!

«Thuaji të hipëti, ore, hë, hë, dhe të më falë thuaji! — Shoferi përkuli fytyrën mbi timon. — Mos u zgërdhi ti, more vesh, shiko se mos na mbjellësh në ndonjë hendek, atë bëj.»

Oficeri dhe vajza e tij zbritën të dritat e para të qytetit. Djali mdriz drejtqëndrimi dhe nderoin.

«Shoku komandant!»

«Nisu tan! Pas pak makina rendte me shpejtësi në drejtimin e mëparshëm. Derisa u gdhë ajo natë, komandantit nuk riu var asnjëherë koka prej gjumit. Vëtëm bënte herë pas here. «hë, hë» dhe shikonte përpara.

Shoferi përfundoi shtigjet e tij. Dhe tashmë kishte dhimbë. Në këtë kohë, shikonte që makina e tij e ka mbyllur. Në këtë kohë, shikonte që makina e tij e ka mbyllur.

SIMFONIA

Ishte një koincidencë e bukur për Artan Bregun, që e ëma kishte ardhur nga fshati pikërisht ato ditë, kur do të jepej premiera e simfonisë së tij në Solmaxhor. Ata po ecnin më këmbë nga shtëpia drejt Pallatit të madh të Kulturës. Frynte pak erë dhe kompozitori ndiente, tek merrte frymë, herë parfumin e së shoqes, herë atë aromë mallëngjyese të së emës, që i kujtonte fëmijérinë. «Nunu, moj!» — psherëtiu ai padashur dhe i shtrëngoi krahun plakësi. «Bin i nënës!» — tha nëna dhe vuri kokën e vogël, mbledhur në shaminë e zezë, mbi bërrylin e tij. Në Tiranë po binte mbrëmja. Makinat e ujit kishin kaluar për të fundit herë mbi etjen e asfalteve dhe dielli si një titan i lodhur, ishte i pafuqishëm për një avullim, të vrullshëm të cipës ujore. Nëna kishte ardhur një ditë më parë. Kishte ardhur siç vinte gjithmonë shtatorëve, me hejbenë e madhe dhe bohçet. Rrushin e kishte futur në kavanoza të mëdhenj dhe napën me djathë e kishte mbështjellë bukur në celofan; «Është koridhi yt, — i tha ajo të birit, — ju, nuse, s'keni si ky këtu, jo.» Klea e kishte pëlqyer shumë atë rrush kokërrfortë me një formë të zgjatur e shije të ëmbël. Kështu,

nëna kishte ardhur si gjithmonë shtatorëve, por këtë radhë s'e kishte gjetur atë si gjithmonë, me atë rrëmujën e zakonshme dhe me këmishët e palara pas derës. Ajo puthte nusen e të birit dhe diç pëshpériste me gurgullimën origjinale të zërit të saj. Fotografia e vogël e Kleas, të cilën plaka e mbante mbështjellë tok me të hollat, në një shami, nën këmishën e leshtë, ishte prekur nga gishtat e të gjitha plakave e grave të fshatit, kurioze për nusen e bukur të Artan Bregut të tyre. «E bukur e nënës, zogëz e nënës!» — thoshte plaka dhe i puthte ballin...

Artani kishte katër vjet që e njinte atë, që tani e kishte grua. Ai dinte, ose më mirë, mendonte se dinte pikat e dobëta të saj. Dinte atë që një vajzë qyteti, si Klea, shumë marrëdhënë të tij me nënën, shumë gjëra të së emës dhe 'bile shumë gjëra të tijat të përforcuara nga prezencat e asaj plakë të brishtë e të vogël do t'i dukeshin të quditshme, të pakuptueshme dhe ndoshta ndoshta edhe të kundërtë.¹² «Po, ndoshta edhe të kundërtë», tha ai dhe vëslitroi të shoqen. Klea i búzëqeshi. Ajo rrinte në krahun e djathtë të plakës me një shprehje të papercaktuar mirë në fytyrë.

«Mirëmbërëma profesor!»

«Mirëmbërëmani!» Ai u tundi kokën studentëve të tij.

«Hej, Artan Bregu, sot ke pikën e vlimit. Mbahu, vogëlush!»

«Pusho, mor derdimen! Ti je më keq se macja e zezë, po të dole përpara.» Ai i dha dorën kalimthi inxhinier Aliut dhe Stavri Vokolës, qeshi me ta dhe nxitoi të arrinte nusen dhe nënën.

«Jemi vonë», — foli thatë Klea. Kompozitorë pa orën.

«Shokë i keshe ata, more bir? M'u panë djem të mirë». Nusja vuri buzën në gaz.» U, u... U shastisa fare...»

Kishte gjashtë muaj që qe martuar Artan Bregu. Atë kohë, ata të dy shkuant me pushime dhe e éma nuk pati rast ta njihte mirë nusen e re. Klea ishte pianiste. Në rrethet e muzikantëve flisnin fjalë mjaft të mira për të, por vetë Artani në thellësi fë ndërgjegjes ishte i bindur se ajo kurrë s'do të bëhej dot një artiste e përsosur. Vërtet ajo kishte një kulturë jo të paktë muzikore, por s'mjafton vetëm kjo, thoshte ai. Sepse, që të jesh artist, veç të tjerash, do të thotë që ta nxjerrësh elementin e së bukurës edhe në atë pjesë të jetës, ku një sy i rëndomtë do të shihte vetëm diçka po të rëndomtë e të zakonshme. Ja për shembull, ti rri shtrirë në barin e prillit në një bri-një muzgu dhe ndien një mori tingujsh rreth vetes. Është dhe dikush që këndon tej. Kënga s'është gjë por mënyra se si e thotë ai atë këngë, me copa, herë e ndërpret, pastaj e nis përsëri, është e bukur, të shtyn për diçka. Në një rast si ky Klea rrudh buzët. «Cudi, — thotë, — po të mos e dija se je ti ai që ke bërë kaq gjëra të bukura, do të besoja se ke një shije vulgare e ordinere.» Kështu thotë. Asaj i mungon aftësia dhe etja për zbulimin e së resë, e së panjohurës, nuk hyn dot kollaj në shpirtin e njerëzve, dhe pa këto... Ai kishte pasur mjaft punë kohët e fundit. Do të kishte qejf që disa ditë pas plazhit t'i kalonin në fshat, por ja që s'u bënë mbarë. Veç të tjerash, kishte përshtypjen se edhe Kleas s'i pëlqente shumë ai udhëtim; ajo s'kishte thënë gjë, por...

«Pa shih, pa shih!» — bënte plaka tek ngjitnin shkallët para hyrjes së Teatrit të Operës. «Tane, bir, dëgjove për Muçon? Vdiq Muço ziu, vdiq i var-

fri, shkoi. Të donte shumë ty, i këpûtej shpirti? Mban mend kur të mbante kalapiç dhe ti e shpoje: Dëe, dee!? Po tani ish plakur shumë dhe e kishin lënë mendtë körbin. Shpëtoi. Oi, oi! Plaka tundi dy-tri herë kokën dhe Artanin e mori me mend që ajo diçka po këndonte me vete; një refren të lashtë, burrë-ror. Ai pa të shqeqen në sy. Dhe ajo po ë shihte. Ai i buzëqeshi. S'mund t'i thoshte gjë tanë.

«Ç'saze që qenkan, mëre bir! Nusë, tu bëftë nëna, asaj së madhes i bie ti? Qysh i thonë asaj, nusë e nënës?»

«Piano, mama.»
«Të pamë njëditezaj tek i bive; kishin ngritur televizorin ata te Zykajt. I shastise tërë sa ishin aty, papo qysh i luaje ato duar pët e pët, e pët e pët,.. dritëz e nënës.» Ajo afroi kokën e Kleas te supi i saj dhë u zgjat e i puthi ballin:

Kishin zënë vend në një nga kuptetë anësore. Kompozitorit i rrahu zemra fort. Ai pa shumë të njohur në sallë. Dikush i tundi dorën. U bë heshtje. Instinktivisht i erdhë të luante duart sipas lëvizjeve të dirigjentit. Sytë i kishte ngulur në një pikë, në fund të skenës. Dy violinat iu futën një adaxhioje të butë e meditative. Kjo që aroma e arave në male, fëshfërima e drurëve dhe zhurma e ujërave. «Ado ta njohë ajo?» — pyeste Artan Bregu. Pa vjedhurazi të emën. Grushti i saj i vogël kishte hyrë brenëda në faqen e zhübavitur.

«Oi, oi! — bëri plaka. — Të shtrinë, o Myfit Rrapua, të shtrinë te gryk' e tri dhënët ta ngrinë pusinë.» «E njohu, — tha ai, — e njohu!» Ndjeu zemrën si një zog që shkundte krahët. Plaka ktheu kokën dhe e pa në sy. Pastaj, kaloi gishtërinjtë mbi fytyrën e tij. Ai nuk ia dëgjonte zërin por e dinte që tanë ajo mërmëriste lloj-lloj tingujsh e fjalësh të embia. «Nunù, e mira moi!» — i erdhi atij të thërriste. Ia mori kokën dhe ja mbështeti në supin e tij. Të gjitha harqet diq-nin tanë dy violinat. Ishte sikur t'i kishe shkuar pas një rrëkeje të vogël, fare të vogël, që nga burimi i saj dhe duke ecur me të shihje tek zgjerohej e mbledhët ujin e gjithë një mali. Zgjerohej e fiton te veti të reja, kritojeshin shtjella më të mëdha, oshëtima e saj sa vinte e rritej. Tingujt e ngjirur të violave kërkonin të thoshin dicka. Fagotat vinin e mbështetën kokat, ashtu të lodhura nga një udhë e gjatë dhe e vështirë, të lodhura por që prapë mbahen e s'duan ta bëjnë veten. Oi, oi! — thoshte violinçeli. Dhe të dridhët e të rrënqethëtë të tërin kjo oi, oi! e largët dhe njerëzo-re, kjo «oi, oi», që ai instrumenti madh, si një shpellë druri, e kishte huajtur nga nëna e tij, nga ajo plakë e mirë, e paditur, e pashkollë, nga gjithë ato plaka e nëna të tjera që kishin ditur ta juanin gazin edhe kur jetë kishte vërtitur tekët e saj më të llahtarshme.

«C'hoqëm atëherë, o bir, — pëshpëriti plaka, — unë korba isha çupë e re; vinin gra flokëlëshuara, e të lemerisura. Shkuan me muhaxhirët e tjerë për Vlorë. Sa vdiqën atë kohë! Vdisnin njerëzit si mizë e lisit. Oi, oi, c'kemi hequr!» Kompozitori ndjeu dicka të (vakët t'i ngjitej nëpër grykë, një afsh përvëlues e kaploj, të tërin. Liroi kravatën dhe shkopsitë këmishën. Tingujt kishin përfshirë sallën. Kornot flisnin dicka

mallëngjyese e të dashur, violat dhe oboet e zhvillo-nin më tej. Violinçeli, si një plak i moçëm e i mençur, ndérhynte diku dhe tregonte historitë e lashta të vendit të tij. Herë-herë tingujt mblidheshin e holloheshin si të kalonin nëpër një unazë të ngushtë, herë-herë hapeshin si grunjërat në një fushë të gjerë, kur u bie era e i lëkund herë në një krah e herë në një tjetër.

«*Çoban, çoban i malit, ç'të qan fyelli, o çoban; ku rëndojnë malet thua? Supet tonas se ç'i mbajnë!* Ç'e këndonte yt atë këtë, ç'e këndonte. Hiqte një gurmaz-raki dhe ia thoshte: «*Mbamani, ore, ju mbajtë e mira!*» — u fliste djemët. Ti s'ishe atë kohë, të keqen. Pastaj erdhi lufta. Ai mori Avninë me vete dhe vate në mal. Motin tjetër shkoi dhe Besua i nënës. Atë kohë paç mbetur me barrë tek ti. Sa i rëndë që ishe, të keqen nëna, sa i rëndë, a më dukej mua nga dertet a.» Ajo pshëretiu dhe ai ndjeu tingujt e dridhshëm të zërit të saj që endej përkrah tingujve të orkestrës.

«*Beson e zunë me plagë. Bilbili i nënës, u bë burrë e shkuar burrave. Më vrini, orë, më vrini, — tha; — se për këtë turp që më gjeti, që rashë gjallë ndër ju, gjëmën do t'ju bëj po më mbeti jetë.* Dhe, tek e vunë t'i binin, ia kishte marrë dhe një herë: *U ngjicë në mal të lartë, hapej bota tej e tej, në më dashtë nenia mua, të këndojet e të më gjejë!*» I bukuri nënës, i vogli i nënës, oi, oi! Erdhi një nga Pocomiti një natë. Ai i thosh këto. Kish qenë aty kur e vranë. I thosh dhe i këpuntej loti. Kish sosur lufta. Të lamë ty tek Esmaja dhe u nisëm me plakun. Ish dimër dhe hoqëm keq. Ndenja në gjunjë te varri sa u bëra kallkan. Plaku më hiqte. «*Ngrehu de, — thosh, — mjaft, ngrehu!*» Motin tjetër prumë dhe Avninë aty dhe i vumë tok.

Eshtë lapidari aty tani. Të shpura ty para se të vije
në shkollë, mban mend? Të shpiesh edhe nusën, dë-
gjon? Shpjere, të keqen nëna!» Atij i ziënин veshët.
E shihte orkestrën si nënjë mjegull të dendur. Ndjeu
gishterinjtë e Kleastë preknin që pas shpinës së pla-
kës. Në sallë ende një andante e bëmbël. Ish-
te momenti kur duke ndjekur udhën e rrëkesë,
përpara teje kishte dalë deti. Kisha qenë dëshmitar i
metamorfozës së asaj rrëkeje të brishtë, kisha parë se
si u rrit e u gjallua, si u bë përrua, lumë i vogël e
më pas lumë i gjerë e madhështor, që fshen në gjok-
sin e dallgës kaq energji. Dhe ja, tani përpara teje
ishte deti. I madh, i bukur, me një ngjyrë që s'e përcaktoje dot saktë. Ja dhe dy motivet e tij bazë. Ato
qenë zhvilluar veç e vec dhe tani ishte pikë e takimit
të tyre. Kompozitori e dinte se ky ishte vendi më de-
likat i simfonisë. A do të dilte ky bashkim si i qepur
keq apo do të ishte i natyrshëm e organik? Një shok
i tij, kritik i muzikës, që e kishte dëgjuar veprën në
skelet, thoshte se kjo do të ishte diçka e panatyryshme,
motivet qenë të kundërtta. Njëri baritor, fshataresk,
kishte erën e fushave dhe të mëndrës, tjetri ishte një
lirikë e kulturuar, me horizont më të gjerë.» Megji-
thatë, — tha Artan Bregu, — të dyja janë përsëri të
afërtë, kanë një burim të përbashkët, shpirtin e po-
pullit. Sepse në tablonë madhështore të jetës qëllon
të rrinë pranë një ajsberg i madh gjer në lodhje, me
një lule të vogël me pesë gramë materje të gjallë
shpérndarë në kërcellin e petalet e saj me ngjyrë të
ndeuzur; një oqean i gjithë, ku përshkëndisin reflekset,
me dy fije bari që patën për baba të mirë diellin, vi-
zioni epik i një mali vigan me tingëllimin lirik të një
brente të druajtur; një shteg ku kanë shkuar rrrotat
e qerreve dhe këmbët e kafshëve me asfaltet avulluese,

kui zhurmat e qakimave vijnë dhe ikin si një karusel
 fantastik, hoteli madhështor i qendrës së qytetit me
 stallat e lopëve. Po, këtë dy motive janë të afërta, sep-
 se një dyjabatë janë të imiatit dhei mua më pëlqen edhe
 të pi kafe në «Drinip», ku shndrisim tavolinat dhe
 zhurmone këndshëm ekspresi, edhe të së pjem bërinjtë
 në stamë me bërruzën e lesh të krähëve, tekndien të
 të shpojë trupin kashitë dhe Hundët era e bagëtisë,
 Kështu është! Në këtë është gjithë qas është gjithë.
 Bif i nenes, u thal plaka, is... En u bëre t' madhi e
 i mençur, te te shihet plakziu kështu, te te shihet!
 S'arriti mafia, jo. Ama kui kendonte e ia ktheje ti
 nganjehetë, thoshte diteziu! «Pa-pa, mój plaké, që
 tigarë që e nget këngën qerratai. «Plakziu, plakziu!»
 Plaká tundi përséri kókén dhe u struk e gjitha në ka-
 rrige. Ai pa dñe iu rrëmbushën përséri sytë. Dhe
 i hipy nje deshire tifanike ta merrte në duar atë gjë
 të vogël e të paktë, atë krijesë të brishtë, që kishte
 aq jetë brenda e ta ngrinte lart, që ta shihnin të gji-
 thë, që ta dëgjonin të gjithë çuçurimën e saj të pa-
 përsëritshme. Sepse këtë muzikë që dëgjonim s'e kish-
 te bëre vetem ai por edhe kjo plakë e shfrenjtë, me
 ato kengët që i këndonit neteve, kur e kapiste gjumi,
 edhe gurët e shkrëpsave të tij kur binte e vritej e
 prapë i ishin të dashur, edhe Klea me ciltersinë dhe
 naivitetin e saj, edhe shokët e tij të mirë, edhe qyteti
 i tij, ditet e tij të vrullshme. Ai i kishte qëmtuar këta
 tinguj me durim e pasion, si ata kërkuesit e lashtë të
 arit që lanin tonelata rërë lumi bër të mbledhur disa
 gramë metal të çmuar. «Nunù, e vogla, e shtrenjtë!»
 — pëshpëriti ai dhe i mori dorën e fa puthi,
 që i zbuloi gjithëqit që ngriti kurrë që i doli i mbrojtoj
 ndonç pëllumbat. Bëzat u përfundua që i cili përfundoi
 përfundova tollin e qëndrave. Kështu e bëzat që i doli i mbrojtoj

Ishin ndezur dritat në qytet. Ai ndiente akoma dorën e nxeh të dhe përqafimet e shokëve pas shfaqjes. Ndiente diçka brenda vetes dhe s'e dinte, saktë nëse ishte gjëzim apo krenari. Klea dhe nëna digjbi sedonin me zë të ulët. Bulevardi kishte mjaft njerëz.

«... po ja, mi me fëmijët e Remziut, e tim kuniti. Nuk më iket, moj çupë, s'më iket andej. S'më ndahet shpirti.»

«Po pse, moj mama, hajde te ne, një djale ke, të vetëm, nuk bën kështu, hajde, thuaj, thuaj se do vish!» Klea kishte përkulur kokën pranë veshit të plakës dhe mundohej të fliste ulët, që të mos e dëgjonte i shoqi...

«... hë, kështu. Atëherë të vjen nëna ty, ta rrit nëna, mos ki dert, zogëz e nënës. «Klea u skuq. Plaka u zgjat dhe e puthi. Pastaj foli për Tiranën, për dritat, për fshatin dhe prodhimet e këtij viti. Në shtëpi, hëngri si gjithnjë dy kafshita, me gjithë lutjet e Kleas dhe deshi të shtrihej. I puthi të dy, djalin dhe nusen.

«Ju paça të lumtur, — tha, — e paçi shtëpinë dritë!» — dhe shkoi matanë. Ata mbetën vetëm dhe u panë në sy. Ajo mbështeti kokën në gjoksin e tij. Ndenjën shumë ashtu, pa folur. Po ata flisnin e flisnin me zërat e tyre të brendshëm. A e kishte ndihmuar sa duhet ai, Artan Bregu, të shoqen e tij të re për ta njojur tamam jetën?! Dhe ai kishte këtu pjesën e tij të fajit. Dhe këtë gjë e pranonë tanë gjithë genia e tij, sytë dhe lëvizjet e dridhshme të dorës. Klea shtrëngonte nën kapakët e syve rruazat e lotëve. «Unë jo gjithmonë e kam kuptuar botën e tij të ma-

dhe të bukur dhe aspak vulgare, siç më është dukur ndonjëherë. U deshën 40 minuta muzikë dhe kjo plakë e dashur, që aq shumë i shkon emri «nënë», përtua kuptuar Artanin ashtu siç është. Më fal, i dashuri im».

Artani u ngrit, shkoi te xhaketa dhe kërkoi paketën. U mbështet përsëri në divan dhe nxori me forcë tymin e cigares. I kishte kapërcyer të tridhjetat kompozitori Artan Bregu. Dhe, tek rrinte ashtu, i lëshuar, hiri i djegur i cigares u zgjat e u zgjat dhe ai ndjeu ta shihte jetën e tij më një formë të gjallë e konkrete.

U ngjiçë në mal të lartë, hapej bota teje e tej. Një motiv i ri po ngjitej nëpër qenien e tij.

Artani u ngrit, shkoi te xhaketa dhe kërkoi paketën. U mbështet përsëri në divan dhe nxori me forcë tymin e cigares. I kishte kapërcyer të tridhjetat kompozitori Artan Bregu. Dhe, tek rrinte ashtu, i lëshuar, hiri i djegur i cigares u zgjat e u zgjat dhe ai ndjeu ta shihte jetën e tij më një formë të gjallë e konkrete.

Stora gärden i världen är en vacker
vacker vacker vacker vacker vacker vacker

XHIROHET NJË FILM

Skenaristi erdhi me urgjencë nga Tirana: Ai ishte një shkrimtar i njohtur. Ishte nervoz dhe këtë gjë e theksonte dhe lëvizja e shpeshtë e çantës nga njëra dorë në tjetrën. Nervozitetin e ruajti dhe kur ngjiti shkallët e hotelit dhe hyri në dhomën e regjisitorit.

«Si je? — tha ashtu sa përtë thënë dëcka si fillim. Regjisori buzëqeshi dhe, tek rrinte e mbërthente këmishën përparrë pasqyrës së dollapit, pa fytyrën e tij të shqetësuar. — Ti e di që mua s'më pëlqejnë këto gjëra. Ndryshime në skenar unë s'lejoj. Këtë ta kam të gartë apo jo?»

«S'kemi bërë asnje ndryshim, por unë mendoj se ti vëtë duhet të ndryshosh dikça, shoku Vangjel. Ke pirë kafe? Ja, zgresim e pimë bashkë tani.» Ai i futi krahun dhe e tërroqi nga dëra e dhomës. Skenaristi iu bind si pa qejf, ndonëse nuk ia pëlqente aspak këtë mënyrë sjelljeje regjisoret të ri, Eno Pristani. Ai ishte 10 vjet më i ri në moshë dhe sillej më të sikur të ishin moshatarë. Ata zbritën në kafenenë e turizmit. Regjisori nisi t'i fliste për disa momente të skenarit ku mendonte se dikça duhej ndryshuar.

«E di, shoku Vangjel. — tha, — linja e Fanes më

duket se diçka do... ndonjëfarë motivimi, kështu siç
është nuk ecën. Kemi gjetur një aktor të mirë. Është
këtej nga fshatrat, ma sugjeruan ata të shtëpisë së
kulturës. Është i shkëlqyer, do ta shohësh vetë. Mirëpo
rolin s'e nxjerr që s'e nxjerr. Po pse, o Ethem, — i
thashë, — pse s'po e arrin dot?

— E di, — tha, — ka diçka që s'vete, nuk është
kështu, or jo.

— Si nuk është kështu?

— Po ja, s'është kështu, unë fshatar jam vetë.
Nuk ndryshuam si me sustë ne, fap dhe o burra në
kooperativë. A beson, o vëlla, — më tha — ja unë, që
më skeh-këtu e që kam qenë edhe partizan, dy a tre
vjet mbast pata hyrrë në kooperativë, u binda për të
mirën e saj. U binda se e pashë, ore, që ishte më mirë,
e pashë me sytë e mi. Po jo kështu, të ardhka çupa
nga aksioni dhe fap, ta mbushka mendjen. Prandaj
s'më ecën, or mik vëllai, — tha, — prandaj s'më ecën.
Dhe ka të drejtë, kështu them dhe unë... Po a
e di ç'ke ti... rri ca ditë këtej, rri ca ditë dhe do të
bindesh dhe vetë.»

«Sipas teje unë s'e njihkam jetën.»

«Unë them se jeta është aq e gjerë, e madhe dhe
ellarmishme, saqë vitet që mibajmë ne nuk dalin për
ta njojur të gjithë atë, e aq unë tepër për të deklaru-
ar se «e njohim jetën».»

«Të lutem, shoku Eno...» Shkrimtari e ndjeu
veten të fyter nga këto «nësime elementare»

«Më duket se s'ka gjë të keqe të rrini ca ditë
këtej, shoku Vangjel. Ky do të jetë ambienti kryesor
i filmit dhe ju si skenarist duhet ta njihni. Skenari
është mjaft i minë, unë e kam thënë, po, diçka do...
diçka... pastaj dhe ca lulka të tepërtë e të kërkuar
duhen mënjaruar».»

«Flisni konkretisht, . . . ju lutem, skenari është aprovuar nga një këshill artistik.» Shkrimtari u poq prapa në karrige. Regjisori ngri mëngët e këmishës dhe zërthieu një kopsë të saj më kraharor. Ai buzë-qeshi.

«Mirë, do ta bisedojmë më me qetësi. Po ju po më trajtoni si një kritikë dashakeqës.» Ai i preku krahun me po atë buzëqeshje. Kamerieri solli kafet. Te dera u diukën syzet e Inajet Bakut, drejtorit të filmit. Ai pa nëpër sallë dhe, kur i vuri rreata, bëri një gjest shkrehjeje e shfrytë frymën me forcë.

«Shyqyr, — tha, — shyqyr që ju gjeta. Si je, shoku Vangjel? Kur paski ardhur? Mirë bëtë, shumë mirë. Kemi nevojë për ndihmën tuaj.» Vangjel Aranaj bëri toka me të dhe i buzëqeshi, ashtu si me pahir. Drejtori u kthyeshi nga Enoja:

«Autorizimin, — tha, — të gjitha i thamë e ishte më dhe atë e mbajte ti.» Regjisori i ra ballit.

«U budallallepsëm, — tha, — e kemi dhimbur farrë.» Ai qeshi përsëri dhe u ngrit.

«E kam sipoer, — foli pas pak — oja erdhë.»

Te baniaku pagoi dñe i tha kamérerit të conte dhe një kafe tjetër më tryezë.

Eno Pristani i eti me shapatë mëdhenj nëpër salle, drejt derës. Një cep i këmishës i kishte dalë nga pantallonat rigjyre mijalti. Doku i pantallonave ishte mblehdhur i zhdbifavitur prapa gjunjëve. Inajeti me ndoqi regjisoren me sy gjë te dëra.

«Xhevahir djali, — tha si me vete. — Nuk ingjendet shoku. — Pastaj u kthyeshi nga shkrimtari. — Dëgjomë mua, Vangjel, më beso, apo ç'përpinqet. Ka rënë gjashtë kile që kur filluan xhirimin. I kam vënë regjim të repte, o t'i vëre ato kile që ka humbur, i kam thënë, o bëhet hataja. Jam apo s'jam drejtori filmi.

Po ku dëgjon ai. Mendjen te puna e ka, aq sa harron dhe të hajë. E di q'bëri një ditë? Kishte marrë nja dhjetë a dy mbledhjetë pleq të fshatit. Është ajo skena e mbledhjes së fshatarëve. U lodh e u mundua Iloja, Nako Sotiri, Vangjel Topanai, dhe kur iu mbush mendja se ia kishte arritur, i pyeti pleqtë: «Mirë ishte kjo?» Pleqtë rrinin dhe tundnin kokat. «Mirë, u lumi-të, mirë e kanë, po ja...» — tha njëri. «Hë, atë po ja-në na thuaj, xha Resul. Atë duam.» Pastaj pleqtë thanë jo kjo kështu, kjo ashtu, kjo thuhet kështu e nuk thuhet ashtu. Ai e ktheu përsëri planin. Ama do li bukur që ç'ta shihje. Megjithëqë u lodhën, të gjithë në fund e pranuan që ishte xhiruar një plan i bukur.» Shkrimtari dëgjonte dhe vërtiste nëpër gisha një paketë bosh cigaresh.

«Do të iki dhe do të vij përsëri të rri ca ditë,» — tha ai.

«Mirë do të bësh, dhe ai i ri është dhe do ndonjë ndihmë. Po do të dalë një film, o Vangjel, që ç'të të them unë.»

«Po Esmanë kush e lot?» — tha ai.

«Dakina Frashëri. E mirë është, bëhet ajo... mirë del.» Regjisori erdhi dhe u ul pranë tyre.

«Na, — i tha Inajeti dhe i zgjati zarfin. — Shiko se mos kemi harruar gjë.»

«Ç'ke ti? Mos iki merak. Të kam thënë, ti vetëm me anën artistike; të tjerat... ky babaxhani. Hic mos ki merak». Inajeti hoqi syzet dhe i fshiu xhamat me shami. Në fytyrë iu dukën dy rrathë të bardhë rreth syve.

«Shoku Eno, sonte nuk ndihem në formë, nuk xhiroj dot sot.» Dakina Frashëri me flokët e bukur

gështenjë dhe më një fustani basme me lule të mëdha që i zbulonte krahët dhe një pjesë të supeve, ku dielli kishte dhënë një kontribut jo të paktë, rrinte përparrë tij dhe në gjithë qenien e saj, nga këmbët në fijet e flokëve lëvizte një shprehje naziqe e përkëdhelëse që aq shpesh gjen strehë të sigurt te një femër. Eno Pristani diç kërkonte në tavolinën e mbuluar me shkresa e letra dhe nuk po e shihte fare në sy.

«Si the? E, po. Mirë, moj Dakinë, deri në mbrëmje mbasë të vjen qejfi». Ai buzëqeshi dhe uli kokën e diçka kërkonte nëpër sirtarë.

«Shoku Eno...»

«Mos më thuaj shoku Eno, se më mërzite.»

«Mirë pra, Eno...», — tha vajza dhe buzët e gjithë fytyra i morën shprehjen e mëparshme.

«S'kemi kohë, Dakinë, duhet bërë sot. Tani, shohim e bëjmë po të jesh sémurë... Kështu?» Ai i vuri dorën poshtë bërrylit dhe bëri të dilte. Pastaj iu kujtua diçka dhe ndali në vend. «Prit, kisha dhe diçka, Dakinë, nuk them se ke punuar keq për kaq sakemi bërë, por... dua që ta kesh mendjen vetëm në roli përsa kohë që jemi këtu, më kupton?» Sytë e këtij djali, në përgjithësi të hutuar e rrëmujaxhi, që harronte shumë gjëra, që mund ta hante mëngjesin në orën 12 dhe drekën më 6 pasdite, që mund të binte për të fjetur në orën 5, kur kishte gdhirë, shikonin tani sytë e saj me seriozitetin e një mësuesi të ashpër.

Vajza u skuq dhe kafshoi lehtë buzën. Ai doli i pari dhe vajza e ndoqi pas pa thënë as edhe një fjalë të vetme. Dielli ishte i fortë dhe i nxehë. Në shtëpinë e pionierit, që rrëthi ia kishte vënë në dispozicion ekipit të filmit, kishte gjallëri e lëvizje.

«Shoku Eno, do të xhirojmë natën? E kam hallin pér llambat. T'i marrim të gjitha?»

«Të gjitha», — tha regjisori. Dakina Frashëri u shkëput. Ajo mbeti aty në oborr, nën rrezet e diellit. Eno Pristani deli nga dera e kopshtit në rrugë dhe ndjeu vapë të madhe. Piu një arançatë te qoshja. Pastaj u kthye dhe piu një tjeter. Shitetja vuri buzën në gaz me të. Djersët i buluan më me vrull. Ai shau. Brenda vetes së tij bëhej një dialog i ashpër. «C'të duhen ty këto gjëra? Po fundi, më duhet, po, më duhet se ajo është e shqetësuar këto ditë dhe po shtyn xhirimin... Pastaj është e re, ku e njoftu ajo këto tri ditë atë? Mbajmë edhe përgjegjësi pér jetën e saj. Pse, vetëm bëj filmin dhe shko tutje?! Nuk them, mbasë ajo vetë mund ta zgjidhë po kaq drejt këtë çështje, ndaj dhe është nervoze, po ai Engjell Krisiko të hulton... Le që unë s'i thashë ndonjë gjë. Puna e saj kryesore tani pér tanë është filmi, roli i saj.» Në film, kur kishte ftuar në film Engjell Krisikon pér rolin e Ajdinit, i kishte shpresat krejt të humbura, dhe i kishte ardhur çudi kur ai kishte pranuar. Roli i Ajdinit ishte një rol i dorës së dytë në film. Ndërkundje Engjell Krisikojë kishte oferta të tjera pér të tjerë filma. Ndërsa tanë e kishte të qartë. Engjell Krisikojë, me sytë e tij bojë qelli dhe fjalët me parfum dinte gjithmonë të bënte të hapej pér të gom-xha e simpatisë që fle në shpirtin e qdo vajze. E këtë herë ai, siç dukej, s'kishte zgjedhur keq. Dakina Frashëri ishte e bukur dhe e freskët. Ajo atë vit kishte mbaruar maturën.

Ai ndjeu ta thërrisin, në emër: Ktheu kokën, pastaj u kthye i gjithë në drejtimin nga erdhia zëri, me një buzëqeshje të sinqertë në fytyrë. Vangjel

Aranaj vinte drejt tij me xhaketën në njérën dorë dhe valixhen e vogël prej lëkure në dorën tjetër.

«Vapë», — tha ai dhe liroi dorën e ia zgjati tjetrit.

«Sa mirë bëre, — tha Eno Pristani. — Dhomën e ke gati. Hajde. Tamam-kur më duhes ke ardhur.»

«E lexove «Dritën» e së djelës?» Shkrimtari buzëqeshi si me ciltërsi dhe vuri përsëri syzet e diellit. Eno Pristani bëri një shenjë të papercaktuar me dorë.

«Motor? Ka motor. Gati! Fillo! Stop! Po jo kësh-tu, Engjell, ta thashë një herë, pa nervozizëm. Ajdini eshtë natyrë e qetë, e shtruar. Në kinoprovë ishe më mirë. Hajde. Gati!»

Xhirohej buzë lumit. Dielli digjte si sy i zjarrtë në ballin e qiellit, të cilat më shumë se kurdoherë i shkonte fjala quell. Mekanikët dhe elektricistët e filmit punonin me kanotiere e me pantallona të përveshura, dhe herë pas here vinin e lagnin ftyrën dhe krahët në ujin e lumit që qe pranë. Enoja kishte më kokë një kapelë letre me strehë të gjéré dhe lëvizte krahët e dobët sikur të dirigjonte një orkestër të madhe. Vangjel Aranaj, ndërsa bisedonte me Ethemin, ndoqi me simpati një copë herë figurën e regjisitorit që lëvizte majtas e djathtas.

«Gjermanët erdhën nga poshtë, nga Ballabani, — po thoshte atë çast Ethemi. — Vinin në këmbë e me kuaj. Urat i kishim prishur. Komandanti i tyre ishte mbi një kalë të bardhë, me pantallona të shkurtra, ja, si tani e mbaj mend. Naaa, e kishte leshtë e këmbës. E shihja me dylbi derrin, po kishim urdhër të mos shtinim.»

«Stop! Mjafton, pushim!» Eno Pristani kërceu nga karroceria, é makinës. «Dani, të përgatitet për mbasdite plani i Nasit me Fanën kur kalojnë lumin.»

«Po ai plan sïkur ka dhe ca ushtarë?»

«E di, ka vajtur t'i marrë Inajeti, Shokë, s'arrijmë dot të shkojmë në qytet. Unë them të hamë këtu, në mensën e kooperativës. Dakord? Në orën pesë të gjithë këtu.» Ai u fut në lumë me gjithë sandale dhe i hodhi dy-tri grushte ujë fytyrës.

«Pa hajde, o çapajev, pa hajde e ndize njëherë, — tha Ethemi me buzën në gaz e cigaretën shtrembër.

«S'e more që s'e more vesh që s'e pi duhanin, o xha Ethem. Dëgjo, mos më thirr më kështu, as Çapajev as Skënderbe, lërmë, pér nder, se ç'i dëgjon këta djemtë pastaj kur të më ngacmojnë.» Eno Pristani buzëqeshte dhe fshinte fytyrën me shami. Ethemi kishte vënë pëllëmbën mbi sytë gjysmë të mbyllur dhe qeshi një copë herë me të, me një zë të ngrohtë e të ngjirur. Vangjeli i zgjati një tog lettrash.

«Diçka kam ndryshuar, — tha. — Shikoje njëherë. Për fundin bisedojmë në darkë.»

«Mirë, shumë mirë,» — përsëriti regjisori i kënaqur. Ai i fshiu dhe një herë duart pas pantallonave dhe mori fletët. I shfletoi ato dhe u tërhoq drejt makinës.

«Dale, ore birçe, dale se s'të lë pa drekë unë ty sot, dje se qysh më shpëtovë ashtu.

«Lërmë, xha Ethem, ja...»

«S'ka ja e la, hajde se do hamë bukë!» — U afroa Engjell Kriskoja me këmishën rozë lëshuar mbi pantallonat e hekurosura.

«Eno, pér mua s'ke më nevojë besoj?»

«Jo, ik po të duash. Dëgjo, Engjell, kemi bërë një ndryshim të vogël... Mirë, mirë, ta them pastaj

në darkë.» Engjell Krisikoja bëri më dorë dhe u nis të largohej. Në rrugë u dëgjuar zhurmë makine. Një Zis mori me zhurmë kthesën. Mbi të ishin një dhjetë ushtarë. Makina frenoi dhe ngriti pluhur. Engjell Krisikoja iu shmang me shpejtësi pluhurit dhe i inatosur i bëri shoferit një shenjë me gishta pranë kokës. Pastaj ai pa që zbriti Inajeti me Dakina Frashërin dhe mbeti në mëdyshje, pa vendosur të ikte apo jo. Regjisori i buzëqeshi Inajetit. Ai bëri një shenjë të kuptueshme pëlqimi më dorë.

«Të gjitha në rregull», — tha drejtori i filmit, akoma pa ardhur te grupi. Ai i futi krahun regjisitorit dhe i tregoi punët fill e për pë. Pastaj e tërhiqi më-njanë dhe nxori nga xhepi i xhaketës prej doku një shishe aramçate.

«Pije, — tha, — se është akoma e ftohtë.»

«Phë! Ç'je çmendur ti!» — tha buzagaz Eno Pristani.

«Pije, pijë, — foli Dakina, — se n'e pime nga një dhe të sollëm edhe ty.»

Ai hoqi tapën dhe ktheu shishen. Dielli i vrou sytë dhe ai rrudhi fytyrën.

«E, e, vapë!» — aprovoi Inajeti. Erdhi Ethemi dhe e zuri regjisoren nga krahu. Ata u nisen të gjithë grup për në mensë. Në krah të Eno Pristanit e cte Dakina. Ajo shihte nga anash profilin e tij sikur për herë të parë ta vinte ré.

«Mban mend ç'më the pardje, Eno?» Ai buzë-qeshi i hutuar dhe tundi krahët.

«Për nder, Dakinë, jam bërë tym fare, s'mbaj mend as se ç'ditë është sot, — iu shmang me dashje Enoja. Dakina Frashëri hodhi flokët pas. Ajo ishte e kuqe flakë në fytyrë por ishte diell dhe dielli përligjte shumë gjëra.

«Por... ti kishe të drejtë, Eno, unë...»

Vajza ia kishte ngulur sytë e mëdhenj. Ja, ai hiqej, sikur s'mibante mend asgjë nga ato që i kishte thënë. «S'i jep rëndësi sepse s'do të më fyej». Ajo e dinte më së miri se ai e kujtonte për bukuri atë bisedë. Ç'njeri i çuditshëm që ishte ai, Eno Pristani. Ç'zemër e mirë fshihej brenda atij njeriu rrëmuja-xhi e punëtor!

— Dëgjo tani, — po thoshte Eno Pristani, — do të bisedojmë dhe me Vangjelin. Ai e bëri ndryshimin. Tani, kur të kthehet nga aksioni, do të veprosh ndryshe. Nejse do të bisedojmë më gjatë.

«Eno...! — tha vajza më një hare të habitur. — Aman, c'njeri je ti kështu?!»

«Ky, moj çupë, është një njeri që, po s'e more osh, nuk ha drekë.» Ethemi u hodhi krahët të dyve dhe i shtyu përpara. Shkrimtari Vangjel Aranaj vuri buzën në gaz nga kjo fjalë e thënë kushedi për të satën herë. Me xhaketën krahëve thithte pa pushim dëhanin.

ÇËSHTJE NË INSTITUCIONIN GJYKATORE

....Vëç sa thashë më sipër, ai në biseda me shokunë reklamon sendet e jashtme, në një rast ka thënë se «mulliri amerikan i kafes qenka më i mirë se mulliri ynë i kafes (prodhim i Gjirokastrës)». Në një meeting organizuar në kryeqytet, vetëm pas shumë presionesh, u bind të mbante një pankartë. Ky është një apolitizëm i theksuar. Vetë mosha e tij (mbi 30 — vjeç) dhe fakti që akoma nuk është martuar dëshmon për koncepte të gabuara mbi jetën, pën brendje lule më lule e shfaqje imoraliteti (që, po të vëzhi gohet më me imtësi, do t'i gjenden). Në një institucion të tillë të rendësishëm si ky yni, ndoshta nuk do të ishte me vend prania e njerëzve të tallë. Lidhur me personin në fjalë, mbetem në dispozicionin tuaj për sa do të dëshironit të dinit për të. Me nderime, Lahim Koka.

Kosta Brahimi palosi letrën dhe vështroi shokun e tij, të punës si të kërkonte një mendje. Mihallaq Shamaj, burrë rrëth të pesëdhjetave, me flokët të thinjur në tëmblat, rrithë gishtérinjtë mbi tavolinë, me një qeshje jo për këdo të dukshme.

«Ç'i thua kësaj ti,?» — pyeti Kosta Brahimi dhe

hapi duart. Duart e tij ishin të vogla, me thonjtë e gishtave të futur thellë në mish dhe të ngrënë në çaste padurimi e nervozizmi të brendshëm. Në pëllëmbët e tyre kishte kallo. Ai kishte pak kohë që punonte në komitetin e partisë si instruktor. Kishte qenë tornitor dhe vetë e dinte q'kishte hequr muajt e parë gjersa u njoh me punën e re, në të cilën nuk do të kishte të bënte me 'copa' hekuri, po me koncepte dhe njerëz.

«Ti e njeh këtë?» — pyeti Mihallaqi dhe tregoi me gisht emrin në fund të letrës.

«Jo! — Kosta Brahimi bëri një shenjë nervoziteti dhe ngriti flokët me pëllëmbë. — Po, pyeta dhe diçka kam marrë vesh. Kanë që të dy karakteristika shumë të mira. Lahim Koka është kimist, ka mbaruar studimet jashtë, punon mirë, anëtar partie, aktivist i mirë i organizatës. Ky tjetri, Lirim Skënderi, është inxhinier elektrik. Ka punuar katër vjet në linjat e tensionit të lartë. I talentuar. Ka bërë disa racionalizime me vlerë. Që prej dy vjetësh punon në institucionin C. Rrjedh nga një familje shumë e mirë, prindërit anëtarë partie. S'di q'të them.» Kos-ta Brähimi mbledhi buzët. Ballin e tij e përshkuau horizontalisht dy vija të thella.

«Në këtë letër diçka s'më pëlqen, — zgjati fjalët Mihallaqi duke vështruar mbi tavolinë. — Më duket si me tendencë keqdashjeje, sikur është nisur për keq...»

Tjetri mendohej:

«Çuditem për një gjë, — shtoi Mihallaqi i menduar. — Pse ai, Lahimi duke qenë anëtar partie nuk i bën problem organizate dhe kolektivi këto shfajqe, kur qenkan kaq shqetësuese?!» Ata të dy hesh-tën për një copë kohë.

«Ka një gjë që s'shkoni, — tha Kosta Brahimi, tashmë shtruan e i qetë, duke parë përtjetë xhamave, — Ka një gjë... Këta të dy, në çdo rast, nuk duhet t'i kishin që të dy karakteristikat të imiras. Më kupton?» I Shrua jep qëllim i këtij intervistës: «**Elikuptoj**! — tha Mihallaqi, — por ajo është punë tjetër».

«Po ti shihe më nga afër, Kostë, shihe dhe, po u desh, shtrojodhë më kolektivim e tyrë. Institucionit Cobën pjesë më dikasterin qendror, apo jo?»

«Po», — tha Kosta Brahimi i menduar. «Atje ka shokë të mirë e të zotë. Ata do të të ndihmojnë më këtë punë...» **Interesant!** Mihallaq Shanaj u zgjat e mori letrën nga tavolina dhe nisi ta lexonte përsëri, ngadalë e pa zë.

Kosta Brahimi filloi të takohej më shpesh me sekretarin e organizatës së partisë të institucionit C. Kosta Brahimi i i tha për letrën dhë përmbytjen e saj. Tjetri kishte mbledhur supet. «Tani, si të them, po quditem shumë. Unë, unë si sekretar, — kishte thënë Riza Kokozi, — nuk kam dijeni përkëtë gjë, shoku Kosta, po... tani... si të thuash. shoku Lahim duhej të na vinte më dijeni dhë ne, po, patjetër, duhej të na vinte më dijeni. Çudi, ai është njeri i rregullt. Pastaj dhe Lirimin e ikemi djalë punëtor!! Sekretari ishte vërtet i habitur, bile Kosta Brahimi pati përshtypjen se ai u tremb edhe përfaktin që kjo kishte ngjarë më organizatën e tyre. «Du-

ket, — mendoi Kosta, — përshtypja që kam pasur se ky njeri e pëlqen së tepërmisqetësinë s'paska qenë kaq e rastit».

Kosta Brahimi foli edhe me shokë të dikasterit. Njëri prej tyre, drejtori Dalip Shaqiri, burrë i shtruar, me ca syltë butë e të përzemërt, i foli fjalë të mira për inxhinier Lirim Skënderin. «Eshtë me talent, — tha. — Rrëmbehet ndonjëherë djalë i ri... duhen marrë më shtruar punët..., ndërsa Lahim Koka... burrë i pjekur, i gjallë, aktivizohet,... Punon mirë, megjithëse ka qejf ta reklamojë pak si tepër punën... ka qejf të duket...». Ai kishte buzëqeshur me buzëqeshjen e tij të madhe e të gjerë.

Ai ibisedoi dhe me Merini, sekretaren e organizatës së rinisë, e pyeti për shokët, Taqon, Rajmondin, Lenën, Lirimin. Ajo foli shumë mirë për ta. «Shkojmë mirë, — tha, — punojmë të gjithë... Lirimi? Ai harrohet shpeshherë pas punës, kështu, po ta shohësh, duket mendjemadh, po nuk eshtë ashtu. Eshtë nevrik një çikë dhe nxehet shpejt po për të mirë e ka. Kimist? Po, kemi dhe një kimist. Lahim Koka e quajnë. Ai merret me pastrimin e ujërave dhe të ajrit atmosferik nga ndotjet industriale. Përpunon metodika. Ka një laborator këtu. Nuk e di se ç'ka bërë, ... po ai punon. Lahimi, thotë Taqoja (Taqoja eshtë një shakaxhi që s'e ka shokun), ka gjetur metoden më të drejtë të pastrimit të ujit dhe ajrit nga ndotjet. Sipas tij duhet që të mos punojnë tërë ato uzina e fabrika që ndotin ujërat e atmosferën. Çfarë s'i pjell mendja Taqos.» Ajo qeshi dhe u ndanë.

... Kosta Brahimi e mendonte pa prerë të gjithë këtë problem. «Po, — thosh, — këtu s'kemi të bëjmë me një gështje të thjeshtë, për shembull: inxhinier Lirimi eshtë vërtet njeri me të meta serioze, apoli-

tik, indiferent, imoral etj., as varianti tjetën që Lahim Koka është njeri i vogël, meskin e ambicioz (përse të jetë ambicioz ky njeri ndaj Lirimit?) e që shtrembëron punën e Partisë. Cili nga të dy variantet është i vërtetë do të sqarohet në një mbledhje të gjerë dhe këto të meta do të ndregen, po shqetësimi tanë është dëcka më i madh. Këto gjëra fshihen bërnda punës së kolektivit. E keqja është se njenëzit jo gjithmonë u hyjnë thellë këtyre gjéravë, ata mund të të hedhin një llaf, të ta thonë me një buzëqeshje, të të thonë një shaka. «Në fakt unë s'ë di mirë këtë gjë, — thonë. — Kështu kam dëgjuar.» Një shok i vjetër kishte thënë: «Lahim Koka është parimor» (shiko se ç'fjalë zgjedh si për ta përcaktuar). «Punon, po amë ngarkohet pak si shumë me punë të organizatës, (ndihet që këtu ky shok nuk i thotë të gjitha rezervat e tij përkëtë gjë).» Kosta Brahimini buzëqeshi hidhur me vete. Sytë e tij u përqëndruan diku. Një damar i rrinte me forcë në qafë. «Duhet, — tha, — që gjithkush ta bëjë në veten e tij të ashpër e të parrenë luftën e klasave. Në këtë mënyrë njeriu do të jetë si déti, që nxjerit në anë të tij qëdo imbeturinë dhe nuk do të moçalohet si ujë i lindjur. Dherduke menduar të gjitha këto, Kosta Brahimini, deri vonë pas mesit të natës shënonë me laps në blllokun e tij, nga i dukej se shihte sytë e dashur të udhëheqësit të Partisë.

Të nesëmen, tek po dilte nga porta e institucioneve, atë, Kostë Brahimini e takoi Lahim Koka. Ai ishte një burrë i qeshur, me sy bojë hiri të fshëhur shpeshherë pas qerpikëve. «Ju njobhim, — tha; — shoku Kosta, ju njobhim.

Kemi dëgjuar fjalë të mira për ju.» Dhe i futi krahun e deshi ta kthente për një kafe, Kosta Brahimi kundërshtoi me njerëzi dhe ata vazhduan përsëri udhën:

«Kam dërguar një letër, tha, . . . në komitet, natyrisht këtu është çështja e punës, çështja e Partisë, se sa përvete, . . . sigurisht që nuk kam ndonjë interes, apo jo? Nuk e di . . . ndoshta e dini ju atë letër?»

«E di». Kosta Brahimi nuk i hoqi sytë nga sytë e bashkëbiseduesit, megjithëse nuk kishte aspak një ndjenjë të këndshme nga kjo gjë. «E di, — përsëriti ai, — po organizata bázë juaja nuk e dinte këtë gjë.»

«Tani, organizata . . . si të thuash, po ja . . . ka që e dinë, ka që s'e dinë. Në një kolektiv, kur familjarizohesh, si të thuash, . . . edhe s'bien në sy shumë gjëra, apo jo? Dikush edhe e mbron tjetrin se i intereson ta mbrojë, për shembull, apo jo? Po atij djalili do t'i bënte mirë të shkonte një herë në gjirin e klasës punëtore, ta shihte një herë punën . . . klasa punëtore mund ta ndihmonte.»

«Klasa punëtore nuk është çerdhe. Veç kësaj, ju vetë keni qenë në gjirin e saj, shoku Lahim?» Kosta Brahimi i tha shpejt dhe prerë këto fjalë ndërsa vetturat e tij të tendosura bënë një kënd të ngushtë përmbi sytë e zemëruar. Lahim Koka u skuq.

«Shoku Kosta, — tha, — më vjen shumë keq, siç duket nuk u shpreha saktë dhe ju s'më kuptuat drejt, . . . ju lutem!» Ai i futi përsëri krahun dhe nisi t'i fliste ca gjëra pa kuptim. Partia ka thënë kështu, njerëzit duhet të jenë kështu, kuadri duhet parë me këtë sy. . . Kosta Brahimi bëri një shenjë padurimi:

«Kështu, shoku Kosta, . . . veç kësaj, kemi dhe faktë të tjera, ai e ka përcjellë Ilira K. në shtëpi dy herë, një herë bële i kanë parë pranë pallatit të saj

fare afër, me njëri-tjetrin. Ilirë K., është e shqiptare... ju është dini, sigurisht, grua e rideruar, po... ai i vjen tro-tull, kështu del, apo jo?» Papritur Kosta Brahimi fiti kujtua një tablo e botës në Erën e Mesozoikut, me hardhuicë gjigante që rrëshqitnin mbi sipërfaqjen e saj. Atij filloj t'i dridhej trupi.

«Pse nuk i thoni këto gjëra në organizatë, që në kolektiv, shokë dashur?» Zëri i tij kësaj herë n'qen gritur aq, saqë tërhoqi vëmendjen e inkalimtárëve. Kosta Brahimi e kuptoi këtë dhëndje u se një i këtij i lëu ftytyrën. Tjetri u gjallërua. «Aja, këto gjëra duan kujdes, domosdosh, po... nuk mund t'i shtrojmë në organizatë se do të shkaktonim skandale, pakënaqësira... deri dhe divorce, po..., apo jo?» Lahim Koka rrezatonte një buzëqeshje të vajosur, buzëqeshje që pothuaj s'i qe ndarë nga buzët që nga fillimi i bisedës. Kosta Brahimi s'po dëgjonte më se ç'thoshte bashkëbiseduesi i tij, i cili fliste pa pushim. I dha dorën atij dhe, pasi e shkëputti atë me vështirësi nga e tjekrit, që ngulmonte e diçka përpinqej t'i thoshte, nxitoi hapat nën pishat e bulevardit të madh.

Në mbrëmje ai e mendoi gjatë qdo fjalë të informacionit për komitetin e partisë. Bëri një gjumë të shqetësuar e copa-copa. Kjo ishte jeta. Ndërtohej një kështjellë e tillë që se kishte parë bota. Prandaj kish te dhe probleme të shumëlojshme në të. Bota e vjetër qe shembur, po vallë ku shkuau mbeturinat e saj? Mos vallë globi i la këto mbeturina në trajektorën e tij kozmike? Mos vallë u mbuluan e u groposën nga pluhuri i kohës? Jo. Një pjesë të tyre i mbaratin me vete njerëzit, e ndonjëherë edhe njerëzit tanë, sado të mirë e luftëtarë që të ishin për të renë. Dhe kjo kështjellë e madhe dhe e re që ngrihej, kjo

kështjellë, ku njeriu do të gjente vendin e tij të vërtetë, ngríhej jo vetëm në luftë me armikun e dukshëm por edhe në përpjekje me ato mbeturina që përbënë armikun e padukshëm.

Një nga sekretarët e komitetit mori pjesë së bashku me Kosta Brahimin në mbledhjen e hapur të organizatës bazë të partisë së institucionit C. Tek kthehet që nga mbledhja, natën vonë, kur në qytet autobusët urbanë e kishin ndërprerë qarkullimin, ata rie dy biseduan gjatë për njerëzit, për punën e Partisë dhe përpjekjet e saj të vazhdueshme për të krijuar te secili një luftëtar të çështjes së saj, dhe vështirësitë e shumta që dilnin këtu.

Nganjëherë më vonë, gjatë një sërë aktiviteteve politike, që i përfshinën edhe një qendër e përgjithshme e partisë së institucionit C, që u zhvillua në qytet, kthehet që nga mbledhja, natën e kaluar, kur në qytet autobusët urbanë e kishin ndërprerë qarkullimin, ata rie dy biseduan gjatë për njerëzit, për punën e Partisë dhe përpjekjet e saj të vazhdueshme për të krijuar te secili një luftëtar të çështjes së saj, dhe vështirësitë e shumta që dilnin këtu.

Nganjëherë më vonë, gjatë një sërë aktiviteteve politike, që i përfshinën edhe një qendër e përgjithshme e partisë së institucionit C, që u zhvillua në qytet, kthehet që nga mbledhja, natën e kaluar, kur në qytet autobusët urbanë e kishin ndërprerë qarkullimin, ata rie dy biseduan gjatë për njerëzit, për punën e Partisë dhe përpjekjet e saj të vazhdueshme për të krijuar te secili një luftëtar të çështjes së saj, dhe vështirësitë e shumta që dilnin këtu.

Nganjëherë më vonë, gjatë një sërë aktiviteteve politike, që i përfshinën edhe një qendër e përgjithshme e partisë së institucionit C, që u zhvillua në qytet, kthehet që nga mbledhja, natën e kaluar, kur në qytet autobusët urbanë e kishin ndërprerë qarkullimin, ata rie dy biseduan gjatë për njerëzit, për punën e Partisë dhe përpjekjet e saj të vazhdueshme për të krijuar te secili një luftëtar të çështjes së saj, dhe vështirësitë e shumta që dilnin këtu.

VDEKJA E PLAKUT

Gjermanët u tërroqën në pozicione të reja. Me sa duket, ata pritnin përforci me. Njësiti partizan i Potomit, që ikoordinonte veprimet me iforcat e batalionit të tretë, mori urdhër ta linte fushën e luftimit dhe të zinte grykën e lumit. Lugina mbeti e shkmetë. Nuk ishte e lehtë të përceptoje tanimë se vetëm pak çaste më parë mbi ato shkurre e gërmusha, që opëra ishkëmbinjsh e togje dheu me frijet e sapombira. Stë barit, vdekja kishte shtrirë pelerinë e përgjakur. Poshtë ngjali mali dëgjoheshin është tingëllima të rralla zilesh. Mbi gjithë luginën insektet e stinës filuani. Stë zhurmëronin përsëri. Befas u ndie një rënkim njeriu, diku nën një kuckë të rralluar shqope. Një ushtari gjerman qe shtrirë aty, me kaskën e rrokullisur më njanë dhe me flokët e verdhë të përgjakur. Shkëmbi ishte i kuqërremptë, -damarë-damarë e s'kuptohej lehtë se ku qe derdhur gjak e ku jo. Ushtari gjerman rënroi përsëri. Sytë i mbante të mbyllur dhe mbi fytyrën e tij kishte hedhur hije vdekja.

Zilet u afrouan. Në fillim luajtën shqopat, pastaj u dukën kurritet e bardha e të lëmuara të dhive, pastaj një shkop, një feste e zezë dhe më pas figura e

plotë e një plaku. Plaku kishte mustaqe të bardha në të kuqërremtë, poture shajaku e një llabane të dhirtë. Ai u fliste dhive e bashkë me të folurën përziente copat e një këngë. Te këmbët e tij vinte rrotull një qen i bardhë me pulla të zeza, me bishtin që e tundte përpjetë me elegancë. Qeni lehu dhe u vërvit në-për shkurre. Plaku mbajti vesh një hop dhe hapi shqopat me dorë. «Pa shih, pa shih, jerman ky... pa shih!» U afrua tek ushtari dhe shtyu tutje qenim që s'e pushonte të lehurën. «E pusho de, e morëm vesh, të bukur gjë që na gjete, pa hiqу tej tani!» Plaku kundroi me vëmendje ushtarin e shtrirë. «Eh, lanet!, — tha, — ku e ke vatjanë e ku të bie koka! E c'kérkon këtu, o i pàudhë?» Plaku mendoi se ushtari ishte i vdekur, nxori qesem e duhanit dhe u ul aty pranë. Ushtari rënköi dhe lëvizi njérin krah. Buzët iu drodhën, dhe një plagë gjaku u shfaq në cepin e tyrefjellit.

«S'të ka dalë shpirti, jooo, — tha plaku dhe e pa vëngër. — Ky i ka vrarë, — tha, — Suatrië e Kasëmit, dëgjohet Tekinë e Danes, dëgjohet Gorishtën e Pinajin e poshtëm ky i ka dëgjur. Milet i lig, — shau plaku, — sojzës. Vjen gjer këtu male e pas malesh për të vrarë e, fundi, vritesh vetë. Ptu!» Gjermani lëvizi përsëri, fikthi i ulëj e i ngrihej pa pushim dëgjohet buzët i fërgëlluan. Plaku e pa një copë herë. Pastaj nxori nga brezi paguren, ia hoqi kapën dhe ia afroi te buzët. Gjermani s'lëvizi më. Balli iu bë i bardhë dëgjohet asnjë fije muskuli s'i luajti.

«Vate ky, — tha plaku, — gjeti c'kérkoi.» Ai i shkopsiti bluzën me gishtërinjtë e tij të fishkur. Dora i preku një zinxhir. «I krishter, — tha plaku, — i krishter qenka, ptu, lanet!» — tha dëgjohet në gjoks kryqin e vogël. Nga xhepi i bluzës u derdhën doku-

mentet e të vrarit. Plaku mori në dorë një blllok. Në përfaqët e tij kishte lule të thara të vendosura ashtu midis fletëve. Ca prej tyre plaku i njihte, ua dinte emrat po ca's'i kishte parë ndonjëherë. Nën lulet e gjethet kishte fjalë të shkruara me një shkrim të madh e të bukur. «Lanet, — bëri plaku, — po këto ç'ti ketë dashur?» Nga duart e plakut shkau një disk i vogël metalik me numrin B93765K. Ky ishte mat-rikulli i ushtarit të vrarë gjerman. Në dokumentet e tij thuhej emri: Erih Kramer Kajnc, natyralist, 36 vjeç, profesor asistent në Fakultetin e Dijeve Natyrore të Baden-Badenit.» Por plaku Kalo Çéravá nuk i njihte germat e nuk i mori vesh të gjitha këto. Pastaj ai drodhi një duhan dhe e thithi me endje. Shikonte përtej grykën po sytë i shkisnin herë-herë tek ushtari i vrarë. «Jerman, — tha, — ç'të bëjmë me ty, o jerman?» Si piu duhanin, «shop» i tha vetes e u ngrit në këmbë. Gjunjët i krisën. Kalo Çérava shau pleqérinë dhe reumatizmin. Ai pa rrëth vetes dhe mendoi që gjermanët i kishin marrë të vrarët e tjerë, po si duket këtë s'e kishin parë. «Ma paskan lënë mua peshqesh, — tha plaku. — Do të të kall në dhe, — tha, o jermanziu, rob zoti je dhe ti, mbasë të tret dhe dheu ynë me gjithë të ligat e tua.» Ai hoqi nga rripi sojakun e madh dhe çapiti aty pranë. Pastaj gjeti një vend si më të mirë e nisi të rrëmihte me sojak. «Lanet, — tha, — nuk rri në vendin tênd, me grua e me fëmijë, me fis e miqësi, po vjen kërkon belanë kaptuar kaq male e kaq dhera. Lanet!» Plaku rënkoj, dhe hoqi dheun nga gropë. Rrëmoi përsëri dhe përsëri hoqi dheun. Dheu qe i butë e i njomë e nëpër të, degëzoheshin rrënët e kafenjta. Plaku dëgjoi zilet e dhive dhe mendoi se mos i shkonin larg ndaj thirri disa herë me zërin e ngjirur emrat e tyre. Tek bëri

kështu, ngriti kokën e pa diellin. «Eshtë zgjatur di-
ta», — tha. Tej u dëgjuan gjëmime armësh. «Luftoj-
në djemtë, luftojnë, eh!» — bëri dhe u ngrit në këm-
bë. «Hajde, o jermanziu, kaq mund të bëj pér ty unë
Kalo Çerava nga Trebanishti. Gjete ç'kérkove, o la-
net, na ke djeguir e na ke pjekur sa edhe gurët të sho-
hin ligjshëty. Po hajde, ndoshta të tret ky dhë ku ta-
dish, se ç'nuk tret dheu, ç'nuk ka tretur ky dheu ynë
kohë më kohë». Ai e zuri ushtarë gjerman nga supet
dhe e hoqi osh. Plaku u lodh e rënkoj. «Eshtë i rën-
dë; — tha, — i ushqyer mirë, po... i ushqyer, laneti!»
Qeni lehu me lehje të egra e të shpeshta. «Pusho,
Çetel, hesht të thonë!» Qeni u erdhi rrrotull këmbëve
të të zotit dhe i vuri të dy putrat në gju. «Po ik, o
gjeç belanë, lërmë ta gropos këtë kolerën!» Çeteli
u hoq mënjamë dhe lehu përsëri. Sytë e tij si prej
xhami shkëlqenin. Ai u kthye dhe u vërvit nëpër
shkurre duke lehur. Andej u dëgjuan zëra. Një e
shtënë e gjatë automatiku i gjëmoi plakut në vesh.
Pastaj erdhi angullima e përvajshme e qenit. «E
vranë, — tha Kalo Çerava, — e vranë Çetelë e gjorë.»
Ai lëshoi të vdekurin dhe kërkoi rrëth stabin e tij
të gjatë. Zërat u afruan. Kalo Çerava mblođhi vetu-
llat mbi sy që të shihë më mirë. Dhe shqoi ca uni-
formë të gjelbra. Dielli ikuq po fshihej pas malit.
Dhe, tek ikte ashtu, hodhi dhe një vështrim të fun-
dit mbi pllakat e mëdha metalike në formë trekë-
ndëshi që kishin në gjoks ushtarët gjermanë dhe nga
ky vështrim, nëpër hapësirë u përhapën reflekse të
shumta. Çetali angulliu përsëri gjatë e thekshëm dhe
pastaj heshti. Plaku shau nëpër dhëmbë. Gjermanët
u afruan dhe e parië plakun. Pastaj vështruan me
kujdes përreth. Ata ishin tre, me mëngë të përv-
shura dhe automatikë krahaqafë. Rrinin përpara

plakut, të egër, të şertë, me gishtat në këmbës, të armëve.

«Ptü, — bëri Kalo Çerava, — lanet paçi e ju shof-ymri, ju shoftë! Po ç'ju bëri qeni, more jezitër?! Unë plaku i bëj varrë këtij mysybeti, shokut tuaj, mos e hanë kafsha e gjëja . . . — ai tregoi më dorën që i dridhej nga inati, të vrarin, — dhe ju po . . . derra se derra . . . ptu, lanet!»

«Der ist ein Schafer, nicht ein Partisan»,¹⁾ — tha njëri nga gjermanët dhe pa përsëri rreth e rrötull.

«C'mollois ashtu, more lanet, — bëri plaku. — Si turinjtë dhe gjuhën e keni. Hy, u shofshi me soj e sorrë!»

«Die sind alle Partisanen»,²⁾ — tha ushtari i gjatë që ishte në mes. Pastaj ai hapi këmbët dhe tha një breshërimë duke shtrënguar fort automatikun. Krismat u përhapën nëpër luginë gjervishtëse e plot jehonë. Kalo Çeravës i ngriu fjala në buzë.

«Lan . . . phë, phë . . . » — bëri ai dhe çapiti dy hapë me duart në gjoks. Gjermani shtiu përsëri. Buza i kishte shkuar shtrembër dhe flegrat e hundës i dridheshin. Plakut iu var koka përpara dhe nga goja e hundët i plasi gjaku si lumë. Pastaj gjunjët iu kaptën dhe ai ra heshturazi. Llëbania e tij e hirtë u ngjye e gjitha në të kuq. Mustaqet e njomura me gjak i kulluan në mjekër. Sytë e plakut ishin të hapur më shumë se kurdoherë. Nëpër ta lëvizën, si të vagëllaura mali dhe pemët, që lëkundeshin si nga një erë e fortë,

1) Ky është një bari, nuk është partizan.

2) Këtu të gjithë janë partizanë.

pastaj ushtari gjerman që shkrehu për të tretën herë automatikun. Fytyra e ushtarit iu drodh e iu deformua si një pasqyrim në cipën e ujit kur hidhet një gur në të. Pa staj plaku nuk pa është nuk ndjeu më gjësend. Sytë e tij të thapur e të drejtuar lart, ishim të mbushur me qiell. Kishte vdekur plaku Kalo Çerava nga Trebenishti, që kishte në shtëpi një plakë dhe që kishte në mal dy djem partizanë.

KOVACI

Djemtë përpara repartit mekanik qeshnin e bënin zhurmë.

«Jo, s'e kishim ashtu, pa mbështetje, pa mbështetje!»

«Lërjani Nikos, ky mburret, pa ta shohim.» Elsa Gjebrea ishte në rolin e arbitrit.

«Ej, djema, kovaçi, jepjani atij, pa të shihni.»

«Vërtet . . . o Sefë Ajdini, pa hajde, hajde!» Kovaçi Sefë qeshi e shikoi nga ata.

«Hajde de, pa merre këtë shufër e përkule. Pa tê shohim, po s'e bëre ti, s'e bën njeri. Ja, zëre me dy duart dhe përkule. E bën dot?» Sefë Ajdini buzëqeshi përséri dhe, duke bërë një gjest, «S'jua kam ngenë!», shkoi tutje, nga hyrja e repartit. Te qoshja ishte vendi tij i punës. Ai hoqi xhaketën, veshi kominoshet dhe filloi të thërrmonte qymyrin për forxhën. E hodhi në të, vuri dy-tri copë dërrasa dhe u dha zjarr. Pastaj ndezi motorin dhe i futi ajër forxhës. Gjuhët e flakës nisën, të ngjiteshin lart të kaltra e transparente. Ai hodhi pënséri qymyr dhe afroi arkën me bullona. Bullonat i vuri me radhë ndanë qymyrit të indezur. Pastaj, tek priste të bëheshin, i hoqi një fshesë

vendit rrëth e rrëth. Bullonat u skuqën. Ai shtypi buttonin e çekiçit pneumatik. Motori gumëzhiu, Kovaçi mori me mashë një bullon inkandeshent, i futi fundin në ujë, pastaj e vuri mbi formën metalike në kudhër. Shkeli pedalin dhe çekiçi goditi me forcë «bum, bum!» Ai ktheu formën përmbysh, e rrahu përdhe me forcë dhe bulloni doli që andej, por tani me kokën e rregullt gjashtëkëndëshe. Kovaçi shkoi përsëri në forxhë e përsëri te çekiçi. Një ndjenjë e pakëndshme po i rritet brenda. Ajo kishte kohë që i nxirrte krye, po sot po e mërziste shumë. Ndoshta për këtë e kishin fajin djali i tij dhe ata djemtë e repartit mekanik. «Kovaç, ç'kovaçzeza, — tha ai, — kovaç është ky... korenti, jo unë.» Përsëri iu kujtuam ata djemtë e repartit mekanik dhe i erdhi turp nga vetja. Në pushim ai doli te dera dhe pa rrëth e qark. S'kishte njeri. Sefë Ajdini shkoi dhe mori në dore shufrën e hekurit. Shufra ishte me diametër 20 mm. Ai e zëri në të dy fundet dhe shtrëngoi muskujt. Balli iu rrudh dhe te temblat iu bënë xhungë damarët. Shufra mbeti e drejtë. Ai ndjeu të dwersitej. U kthyë te vendi i punës.

«Je squllur fare, — tha, — je bërë si grua. Ti, Sefë Ajdini, që ke qenë miburrja e shokëve. Po, po, atëherë e ngrije çekanin lart dhe e rrihje hekurin sa përshkënditej gjithë vendi, kurse tani t'i bën korenti të tëra. Mirë e kë, o Sefë Ajdini, tani vetëm bark të ka mbetur të vësh. Vërt edhe ca bark dhe gjeddis tûhëve pastaj.» Kështu thoshte, tek merrete nga forxha e rrihje bullonat. Bum, bum. «Kot bile më thonë ekonomi kovaç. E ç'kovaç jam unë!» Bum, bum! «Dikur i 'kisha' krahët hekur se me hekurin matesha, po tani...» Bum, bum!

Tërë atë ditë nuk bëri dy para punë. Foli e foli shumë me veten Sefë Ajdini. Dhe po fole shumë me

veten, tha ai, ke folur pak me punën. Në të mbaruar, hodhi xhaketën krahëve dhe bëri përmgjatë zyrat. Në korridor dikush i foli. «Si je, kovaç Sefa?» Ai përshtëndeti, megjithëse fjalët e tjetrit e shpuan si gozhda në këpucë. Sefë Ajdini trokiti dhe hyri te sekretari i partisë. Ymer Arbana ingriti kokën.

«Ç'kemi, o Sefë? S'të kam parë, pa hajde, qulu aty.» Sefa u përpooq të buzëqeshëte.

«Hic, o shoku Ymer, ja... punë.»

«Pa hë, ndize njëherë!» Kovaçi mori cigaren nga paketa e tjetrit dhe zgjati fytyrën ta ndizte. Të dy thithën duhanin dhe u panë një hop.

«Dua të iki, shoku Ymer, dua të iki që kandëj, më shpini në një vend tjetër, që të këm punë tamam më krahë.» Kovaçi i shihte përdhe. Ymer Arbana fërkoi njekrën e tjetrit.

«S'të kuptoj, o Sefë, pse nuk je mirë aty?... Mos je zënë më njëri?» Sekretari mbloodi supet i habitur. «Jo, o sekretar, jo. Po ç'kovaç jam unë aty?... Dua një punë ku të më punoje krahut tamam. Ja, më shpini në girore të thyej gurini.» Sekretari u mbështet përapa, në karrige. Ai buzëqeshi dhe e pa një copë herë kovaçin me këtë buzëqeshje.

«Ja ç'na qenka! Hajde, hajde, o Sefë! Ne shkoijmë përpara, ti dashke të ma lkhesh përapa, or vëlla. Po ky është progresi, mor i dashur, nuk e menj vesh t'i? Kështu përparon injerëzimi. Pse, mos kujtoni se injeriu, qoftë dhe fizikisht, u bëkërkë më i dobët kështu? Jo, or Sefë, e ke gabim.»

«Po ja, se si më duket, o shoku Ymer, ç'kovaç jam unë tani? Më parë po.»

«Po mirë, mos e quaj veten kovaç; quaje punëtor, si të duash quajt. Ç'të keqe ka këtu? Mjafton që ti punon, me krahë punon përsëri. Po puna tani është

ndryshe, o Sefë. Pse rrihen me çekan dore të gjitha ato detaje që bën ti sot? Dje kovaçi rrihte një potkuia e një sépatë prandaj ia dilte.» Sefë Ajdini kishte mblëdhur duart dhe shihte poshtë, nën tryezë. Sekretari ndezi përsëri cigaren:

«Ke hak, — tha Sefë Ajdini, — ke hak, po se qysh më duket. Kam një djale në shkollë, për pikturë. Ai më solli një kovaç, e kishte bërë në letër, me bojra e kishte bërë. Ishte një burnë i madh, që kishte ngritur lart çekanin me krahët të fryrë nga muskujt. Kishte dashur të më bënte mia. Ia bëra copë-copë. Djali u skuq. «Po kështu është kovaçi, baba, — tha, — pse nuk punon kështu ti?» E ja, se si më vjen rëndë. Më duket sikur s'punoj sa më parë.»

«Sa për djalin, mirë i bërë që ia grisë pikturën. Të vijë e të të shohë ty qysh punon pastaj ta bëjë. Po për këto, të tjerat nu ke të drejtë, o Sefë! Njeriu sot është më i fortë nga ç'ishte dje. Këtë ta dish mirë. Tani edhe mosha bën punën, plakemi, po s'jemi bërë akoma për të zënë në gojë pleqërinë ama. Ti, Sefë, je pò laq i fortë, sa ç'të mbaj mend kur kemi ardhur të dy në fabrikë, të kujtohet?» Sefë Ajdini mendohet me duart mbi gjunjë. Pastaj ai ngriti kokën dhe të dy buzëqeshën. Pinë dhe nga një cigare, folën për familjet dhe kovaçin u ngrit e iku. Këmbët po e shpinin nga dalja e ndërmarrjes. Po një mendim e bëri të merrte udhën e repartit. Punëtorët e turnit të dytë po zhvisheshin brenda. Nga porta po dilte Elsa Gjebrea me dy djem. Sefë Ajdini u bûzëqeshi.

«Pa të shohim, — tha. — Ç'ishte ajo lodër që thate ju?» Ai la mënjanë xhaketën dhe mori në dorë shufrën e hekurit. Përqendroi veten dhe u dha krahëve. Gjaku i vërshoi në fytyrë. Hekuri u ep. dhei copëra të vogla ndryshku ranë nga trupi i tij.

«E përkuli!» — thirri Elsa Gjebrea dhe përplasi pëllëmbët. Kovaçi e hodhi hekurin përdhe dhe shkundi duart. Djemtë qeshën dhe i rrähën krahët.

— I fortë, i fortë, o Sefë Ajdini. Tamam kovaç, — thanë ata dhe i rrähën krahët me admirim.

«Tjetër lloj kovaçi, — tha Sefë Ajdini, — kovaç elektrik, kovaç me korent.» Ai hodhi xhaletën në sup dhe buzëqeshi.

GJYSHI IM MUHARREM

Ai rri shtrirë, mbështetur mbi jastëkët e lartë, me vështrimin humbur diku nëpër vite. Buzët i lëvizin lehtë. Ai flet me vete. Ç'thotë ashtu? Ndoshët thotë jetën e tij. Është gjyshi im, Muharrem Pagria. Ditëlindja e tij ka humbur diku përtej, në shkretëtirën kohore të shekullit të kaluar. Thonë që ai është mbi 100 vjec. Kur i flet për këtë, lëviz dorën ngadalë nëpër ajér: «E ç'pyet? — thotë, — kush i mban mend?! Vitet janë si uji.» Këto kohë të parët i është dobësuar. Edhe veshët e kanë lënë dhe duhet të thërrasësh fort, sa të dëgjojë e gjithë mëhalla. Më rrëqethet trupi kur mendoj se këto janë ditët e fundit të tij. A i vjen keq atij për këtë? Ngul sytë mbi sytë e tij të zbardhur si një film i nxjerrë në diell, mbi buzët dhe mustaqet e zverdhura nga duhani. Nuk dalloj gjë aty. Ndoshëta ai s'e jep veten. Një ditë, tek hyja ngadalë e pa u ndier, ai shihte tej, nga xhami i dritares. Duart i mbante të nderura përpëra. Nën rrudhat e syve kullonin dy lotë të mëdhenj e të rendë. Fytyrën e kishte si të ngurrosur. Buzët i fërgëlluan dhe ai pëshpëriti: «O nënë!» me një zë të ulët zemre, të mbledhur tinguj-tinguj nëpër ndjesitë e tij e të

nxjerré nē hapésirén e njerézve. Trishtimi silkishte vend nē até fytyré. E megjithaté dhe ata dy doté tē mēdhenj kishin tē drejtén e tyre. Kisha mbetur si i shtangur dhé ndiqja rréshiqitja e tyre ité ngadalshme mbi até lékure tē zbehté e tē rrudhur. Po aitmē ndjeu. Nuk mē pa. Mē ndjeu thjeshtime intuitten e njeriu qé ndien se dikush éshté pramé tij.

«Hajde, — thoté, — ti, Čapo, je? Hajde, pa qasu tēhu!» Ai e mblodhi veten.» Pa shih c'meškané kéta sy, qé mē dotojnë, o libir. Pa shih se mos mē ka hyrë ndorjé lémizhdë.» Uné nuk i thashë gjé, dhe i fshiva lotét qne teftun e pëllëmbës. Dhe ai bëzëqeshi. Po, oai përpinqet ta fshehë dobësinë e tij. Po vallë a dûhet quajtur dobësi kjo?! Ky plak ka rröjtur mbi 100 vjet. (Sa sekonda përmibën kjo kohë?) Ai ka lëvizur nëpër këto sekonda. Në shpirtin e tij, qé nga dita e lindjes, éshtë mbjellë pema e kujtesës. Tani ajo pemë éshtë rritur shumë, éshtë bërë një baobab. Ca nga degët e tij janë tē thata e pa jetë po tē tjera gjelbërojnë, e bëjnë lule. (Sa herë ka qeshur e éshtë kënaqur ai më kéta 100 vjet? Sa herë éshtë mërzitur e ka shanë jetën e tij?) Ndaj gjithçkaje njeriu ka një pikë ngopjeje. Po ndaj jetës, vallë, e ka këtë pilkë? Jo? Sado tē pijë prej saj, kur ajo éshtë e pastër dhe e pamogjaluar, ai niuk ngopët.

Plaku më mëndorën nē duart e tij. Gishtat e tij shkasin mbi kurrizin e dorës sime. Gishterinjtë e tij janë tē gjatë, me damarë blu tē fryrë nē anët e tyre.

«Të keqeh, o djale, — thotë ai, — puno mirë, ipuno shumë, po veten mos e vraj se, po e vravë veten, as pér vete e as pér njerëzit s'je. Puno me karar. Po hilë ama mos bëj. Hileja s'te nxjerr kurrë nē selamet.»

«Hajde, babaplak, — i them unë, — m'i hidh një herë tespihet.»

«Léri, — thotë, — ç'i do ato përralla, ti ke gramë e shkollë; pse, mos e di ti se ne i bënim tërë ato nga mëndtë e shumta? S'dinim, or, jo, pa i bënim.»

«Mirë, — i them, — hidhi, s'ka gjë.» Kjo është një lodër e vjetër, që ai ma bënte që kur isha i vogël. Ai i hedh tespihet dhe ato bien mbi minder.

«Të pakat apo të shumat do?»

«Të pakat!», — i them. —

«Mirë, — thotë, — më mirë mos ji tamahqar.» Pastaj merr tespihet në dorë, duke ndarë veç truazat që ishin në pjesën e paktë. Ai kalon nëpër gishta ato kokrra të verdha me shkëlqim fildishi dhe belbëzon: «Allah, Muhamet, Ali, Buxhel... Allah, Muhamet, Ali, Buxhel! Tyt, lanet! Ke bërë ndonjë prapësi sot, se të doli Buxhel.» Ky Buxheli është si biçim lugati. Më mirë është të të bjerë. Allah, po edhe dy të tjerët s'janë keq. Po Buxheli është keq.

«Duhet ndërruar dhe kjo lodër, — thotë ai, — u vjetërua, i duhen lojtur emrat. Në vend të Allahut e Buxhelit duhet të themi Maks e Kruçov, a ndonjë sy-fet tjeter si ky.» Qeshim të dy dhe ai përsëri ma merr dorën në duart e tij.

Më kishte dërguar plaku në Përmet të shisja ca kashtë. Kishim një pelë flori. Tek kthehesha, pela luhod e u djersit. E ndieja që më ishin lagur shalët nga djersa e saj. Atje tek ngjitet Guri i Capit, dy-tre kalorës vinin më të poshtë. I shqova kur u afroan. Ish-te Hasan komiti, Hasoja, siç i thoshin. Mbante hedhur krahut një dogra të shkurtër. Sytë i kishte të zinj si nata.

«Ç'i ke bërë pelës, or t'u shoftë? Po ti e paske ngordhur, o jezit.» Unë mbeta. Ai më pa një copë herë. Pastaj sikur u zbut.

«I kujt je, o trim?» — tha.

«I Asim Pagrisë.»

«Flori paska yt atë e jo djalë. Po pelës ama s'ia ditke tabiatet. Pa hiqe gunën dhe hidhja mbi kurriz se eshtë djersirë e do të ftohet. Bëji të fala tyt eti nga Hasoja i Rrapajve.» Pastaj nduku mustaqen dhe u var poshtë. Trimat e tij e ndoqën. Ja, sikur e shoh tanë më duket. Ç'trim që ish, ore, ç'trim! I thoshte plumbit «Hiqu tej!» I thoshte vdekjes «M'u bëj def!» Qe tmerri i turkut e i zengjinit. Qeshë i ri atë kohë. Më pas shkova tej, në kurbet. Ishim dymbëdhjetë shpirt në shtëpi. Duheshin mbajtur e shpirti s'mbahet veç me frymë. Ndenja vite në Stamboll. Isha bahçevan. Mora një copë tokë me qira, lidha kontratë dhe ç'bëja në të, zarzavate, jeshillëqe, i shisja shtëpi më shtëpi. E, që ta paç llafnë, atje ishte një doktor i famçim, Franciz Aga e thoshin. Se mos shihte fukarenjtë ai. Ish doktor te sulltani, thoshin, pesë mexhide të parën e kish. I shpura një herë ca angjinare, i hante shumë ato dhe këmbeu dy-tri llafe me mua. «Në sabah, — tha, — lipset të haç një gjë t'embël; një llokume, një lugë sheqer a pekmez. Kur bie eëmbla në stomak, gjithë mikrobet e trupit, ç'janë e nga janë, vijnë e mblidhen rrrotull saj. Atëherë të hedhësh mbi të një kupë raki, ténk. Ajo u bie kokës e i përvëlon.» Kësh-tu thosh, . . . po, Franciz Aga e thoshin, . . . po, ish doktor me famë. S'ishte turk, jo. Po se mos kishim ne që ta bënim këtë marifet?! Farmak s'kishim e jo t'embël. Mezi shpinim ca mexhide të qelbura në shtëpitë tonë. Shkuan mote e u ktheva. Shumë s'u kthyen. . .

Unë lëviz nëpër degët e gjelbra të pemës së tij të kujtesës. Shpeshherë ai harron dhe ma thotë një histori një herë, dy herë, tri herë. Po unë e dëgjoj

e s'i them që ma ka thënë. Këndoja librat e historisë dhe, duke dëgjuar tregimet e tij, vë re se si lëviz e gjallërohet ajo. Dhe aty nëpër këtë tablo është dhe ky plak, Muhammed Pagrija, janë dhe të tjerë e të tjerë me emra të gjatë e të shkurtër. Them me emra të gjatë e të shkurtër, pasi ai më tha një ditë se njeriu e ka emrin më të gjatë apo më të shkurtër, jo nga gërmat që përbëjnë emrin e tij po nga ajo se sa ndihet emri i tij rrëth e rrëth. Kështu, si mund ta ketë emrin të gjatë e të shkurtër.

Kur ai ishte mirë e shëndoshë, zbriste shkallët e dikte jashtë. Në kafe, rrëth tij, mblidheshin njerëz, sepse kishta shumë të njojur. Një herë unë i thashë atij se s'bënte mirë që pranonte t'ia paguanin të tjerët kafen. Ai tundi kokën dhe shtroi mustaqet fajqeve. Pastaj qeshi dhe më zuri veshin: «Tyt, shejtan! — bëri. — Ke mësuar edhe të kritikoj pa le! Moski dert, o, jobo, se e njojin njerëzia Muhammed Pagrinë e erdinë që s'është as kornac e as delenxhi. Bëjmë muhabet të gjatë ne; dhe s'mbetemi me një kafe.»

Dhe tani, që e shoh atë, më vjen si çudi që në gjithë historinë e popullit tim është dhe historia e tij, me gaz e me brenga, me fatkeqësira, me luftë e me përpjekje. Por logjika të bën të mendosh se s'ka gjë përfunduar t'u guditur. Historinë e bëjnë njerëzit, ata i jatin fizionominë dhe ngjyrën dhe bëjnë që të dallohet një epokë nga një tjetër.

«Pa po kur ma solli djali në pshat atë potografinë e atij Maksit. Ai ishte tërë lesh, si dervish Temja.

«E ç'është ky, o bir?» — i thashë.

«Ky është armiku i borgjezisë dhe i shfrytëzuesve», — tha ai. Në fillim unë s'i zura besë. Do jetë ndo-

një fe e re, thashë e unë feve s'u kam besuar kurrë. Plaka ka qenë myhibe, po unë jo. Me zotin na u mësua gojë; na u bë allahu si opingat që mbathnim, ndaj edhe s'na hiqet nga gjuha. Po se mos na bënte gjë, a? Aq sa na bëje ti që s'ke qenë. E që ta paç llaflnë, do jetë ndonjë fe e re, thashë. Po ajo ish tjetër, o bir, ish shpëtimi i njerëzisë. Zengjin i madh thonë që ka qenë kij. Maksi me gjithë atë tjatrin, po i lani të tëra, gjer edhe jetën për fukaranë. Kur kam parë Leninin, të zografisur, më pëlqeu sakaq. Dukej që në sytë që ish burrë i mirë. Më thoshte djali atë kohë, po, po ç'ish munduar e ç'kish hequr i varfri më syrgjyne e me arratira. Më hyri në zemër, fap. Njihet njeriu i mirë, ore, njihet që në sytë. Njëherë shkonte një njeri në arat tonë. Shkonte në të errët. Unë ktheshesh në shtëpi. Keshe vadir tej, në Kososevë.

«Ku vete, o njeri, — i thashë, — kthehu ndër ne, se një copë bukë e një jatak e kemi në shtëpi.» Ai qeshi.

«Falemnderit! — tha. — Duhet të shkoj në Frashër.»

«Po. Frashëri mban katër sahat udhë, o burrë. Hajde, pa të nisim në sabah me njeri, po hajde.» Ai u bind e u kthyesh në shtëpi. Ishte njeri i ditur e kiste, gjezdisur shumë.

«Nga të kemi? — i thashë. — Sikur s'je nga anët topa.»

«Jam nga Veriu», — tha. Ai dinte të qëshët me sy dhe, tek të shihtë, të dukej sikur hop, të kallej mu brenda në shpirt. Na foli e na foli atë natë, sa na la pa mënt. Pa po ç'i lidhët ato fjalë, usta ish! Kur shkoi, mora vesh se ish komonist i rrezikshëm ai. Zogu e kish bërë syrgjyn. Djalin s'e kisha atë vaft, ishte në shkollë. E kush i mban mend të tëra, o bir... Ka he-

qur i ziu popull, ka hequr, kjo mbahet mend më mirë se gjithë të tjerat. E rëndë ish ajo qerrata jetë. E rëndë dhe s'e mbante dot kushdo. Donte shpatulla të forta ajo. Mos shih sot ti, sotjeta është e lehtë pendë. Të mban, në vend ta mbash.

... Erdhën pastaj motet e luftës. Luftonte itali-anë me grekun. Ish greku i dytë ky. Dha e mori gréku po tri avgatë e Kiçokut s'i mori e s'i mori dot. Pastaj i hyri gjermani pas dhe e këputi. Ta shihje tërë atë ushtri, me ato uniforma e ato bukurira, si ish katan-disur kur têrhiqeji. Iknin e iknin shpirtvurarë dhe i hidhnin të tëra ç'kishin tek iknin, me rroba, takëmë e armë. Atë kohë gjeje e ç'nuk gjeje, stafidhe do a, matara me gjalpë, batanije a plaqë soj-soj. Eee... Gjermani erdhi më pastaj. S'kish shaka me të, të vris-te ai. U ngjit një herë në fshat dhe ne ikëm me kuç e me maç. Djemurinë e kishim partizanë. Ne plegtë dhe gratë me fëmijë keshëm mbetur. Iu futëm dush-kut të dilnim la në mal. Po ata na u lëshuan e na zu-në mb'udhë. «Açt, içt!» — seç thërrisin dhe na futnin tomatikët brinjëve. Burra trima kisha parë shumë edhe vetë, ku jeshë djalë, më mbanin për trim e kokërkrisur, po e vërteta është se s'ma nxinte mendja se do ta thyenin djemtë gjermanin. Ish i egër jeziti. Po ja që e çporrën, më ju lumtë dhe i humbi sporua ndër ne.

«Në darkë, kur kthehet nga puna i biri, që është dhe babai im, plaku zë e pyet gjéré e gjatë për punët.

«E zutë grurin? — thotë. — Zëreni tanë, se fillojnë shirat e janë toka të buta këto.» I biri i tregon për bagëtinë, për lopët e derrat. Derrat plaku i ka zët. Ai mbledh buzët dhe rrudh sytë sikur ata t'i kenë dalë përpara, ja, mu aty. I biri i vë në duar një kulaç lulledielli dhe plaku gjëzohet si fëmjë. «Të keqen, o

lule!» — thotë. Dhe shkon pëllëmbën mbi faqen e saj, ku bëjnë majë kokrrat e zeza, të pjekura e pëshpërit e pëshpërit me vete i kënaqur e i mallëngjyer.

«Po fol, o, fol fort, — i thotë të birit, — mos fol me vete». Dhe djali i tij s'ka se ç'bën dhe tanimë nuk flet po thërret pranë veshit të të atit për serrat me kaldaja dhe pularinë moderne, Plaku tund kokën dhe thotë: «Ashtu; ashtu, ju lumtë e ju paça!» Pastaj tund kokën përsëri e përsëri psherëtin. Po ne s'kemi ditur, mor bir, mbillnim dy koqe misër dhe me të mbanim frymën. Dhe na dulkej se ia dinim tokës të gjitha. Hajde, dynjazeza, hajde!» Dhe lëviz dorën e tij eshtake sikur përcjell me të prapa diellit, «dynjazezën.»

Mëngjeseve ai pyet se ç'ditë është. Kur i thonë që është e diel ai më thërret mua.

«Pa hajde, — më thotë, — pa hajde, o Çapo, e më rruaj një çikë, të shkretën. Pa më merr një çikë këtë qerrata mjekër. Po shih, të më bësh të bukur, poooo, se kam qenë një levend djalë unë në vaftit tim që... pyet plakën të të thotë.»

«Pika!» — thotë plaka e tij me të qeshur që prapa derës. Unë e rruaj dhe i fshi fytyrën me peshqirin e njomur me ujë të ngrohtë.

«Të keqen, o'djalë, — thotë ai, — të rrjedhë e mira si ujë! Në Stamboll vetëm një berber rruante kaq mirë sa ti. Asnjeri s'më rruan kështu, vallahi.» (Të dielen që shkoi atë e rroi ime motër dhe ai po këto fjalë i tha. E me se mund të na shpërblejë tjeter ne ai? Po vallë a meritojmë shpérblim ne, degët e reja nga ai, trungu i vjetër i familjes?!)

Lumi i jetës lëviz brenda tij ngadalë-ngađalë. Bile herë-herë kjo lëvizje mezi vihet re. Ky lumë i lodhur kapet pas brigjeve më krahët e tij ujorë, mba-

het pas tyre e mezi bën tutje. Plaku e ndien këtë. Ai më thërret mua pranë dhe kérkon që ta ngrë më këmbë. Unë i vë duart nën squetulla. Trupi i tij dridhet. Ngrihet shumë rrallë nga shtrati dhe çdo herë mua më duket si një fëmijë që provon pér herë të parë të qëndrojë mbi këmbët e tij. Trupi i tij i gjatë e i kërrusur lëkundet. Nuk qëndron dot. «Lërmë, — thotë, — lërmë! Mbëta ulok, pér zonë e vërtetë!» Dhe, si rreh pëllëmbët mbi kofshët e tij të dobëta, diçka belbëzon. Fytyra i zbutet e i zbutet dhe mustaqet i varen poshtë. «Mirë, o bir, — thotë, — shko ti, shko se ke punë.» Dhe më përzë mua. Ndoshja më përzë që të mbetet vetëm e të qajë lirisht, me veten e tij. Sejeta i dhembka njëloj të riut dhe plakut. Unë shkoj matanë dhe pas pak dëgjoj një këngë të vjetër, që ai e mban gjallë me zërin e tij të zvargur. U vë veshin fjalëve po ato s'merren vesh. C'thotë vallë ajo këngë?

Kur u çporr dushmani e u bë e gjitha Parti, djali dërgoi e na mori. «Të vini, — tha. — Ju, dy pleq të vetëm, s'rri ni dot aty. Do t'ju marr në qytet, — tha, — tokën ia japim shtetit, shteti eshtë yni tanı.» Edhe s'paç shumë qejf c'është e vërteta, po më erdhi ligjht pér djalen, le që s'mbahej plaka pastaj. «Korba, djali, — thosh, — Qysh bën vetëm ai?!» Kështuuuu. Erdhëm në kasaba. Kështu i thosh turku qytetit, kasaba. Po ky qyteti, që thua ti, kish të tjera tabiate. S'të thosh njeri tek shkoje udhës. «Qysh u gdhive, o burrë?» U bënë tridhjetë vjet e prapë s'jam mësuar. Ja, rri e rri e më zë malli. S'ka si dhei yt, jo. Të vjen mall dhe pér erën e bajgës. Beh! Ndrysuan të gjithë, qytet e pshat ndrysuan. Erdhi një herë Bali Mejdanë ndër ne. E mora ta gjedhis nëpér qytet. «Mbamë, o Muharrem, — tha, — mbamë e mos më lësho se hum-

ba unë, oreee!» E ç'ta mbaja unë?! S'kisha dalë nga ato lagje, ishin bërë të tjera pallate. Humbëm që të dy e s'dinim nga t'ia mbanim. Humbëm, or, për nder. U ndodh një polic, ai na nxori gjer te stacioni i autobusit. Ndrysroijeta, or, ndrysroi. Po juve, që s'keni qenë më parë, s'ju duket gjë, o, jo. Tani zien dynjaja e gjithë. Ja, dëgjoj radion. I çkoqit ajo të tëra. Bën luftë botë e varfër, lëfton fukaraja. S'u ndreq kjo dynja një herë! Të lumtur jemi ne që kemi Enverë. Lum si ju, or bir, do rroni e do gëzoni! Po neve na qëlloi keq. Na erdhën ditët e bardha tani në fund. Të kishim qenë më të fuqishëm, më të rinj, më mirë do kishte qenë...

Zëri i tij ngrihet e ulet sipas atyre që tregon. Herë-herë, kur flet për diçka që e mallëngjen, mbi lugjet e zhuravitura të fytyrës, nën të cilat ravigohen eshtrat e dala, i ndehet një cipë trishtimi dhe sytë i bëhen të qelqtë. Këta sy i mbaj mend që kur isha në klasën e parë të fillores. Atëherë unë mësova të shkruaja dhe ai më vinte t'u bëja letra të afërmve e miqve të tij në fshat. «I dashur filan e filan, — shkruaja unë, — jemi mirë, lus që edhe ju të jeni mirë, me miqësi e me bereqet.» Pastaj, në fund, kur ai niste me të falat, mbushej një faqe e tërë me emra. Ja, dhe tani ai ka po ata sy. Përsëri po thotë copëra-copëra atë këngën e tij të çuditshme. E mbaron dhe me një dufmë të thellë psherëtin: «Eh... mos qofsh, o pleqëri!» Sytë e tij shikojnë të mitë. Ata kanë një shkëlqim të veçantë. Zëri i ulet fare. Diç kërkon të më thotë. Unë afroj kokën pranë tij. E kuptoj ç'kërkon. Jam mësuar me të dhe tani s'më bën përshtypje asnjë nga kérkesat e tij. E megjithatë një korent i brendshëm m'i dredh qelizat. Shkoj në ballkon

dhe ngul gishtérinjtë në dheun e njérës prej vazo-
ve. E marr atë dhé të ngrohtë në dorë dhe vij tek
ai. «Na, — i them, — babaplak.» Sytë e tij janë
të hapur. Ata shikojnë jashtë, tej xhamave. Por në
duar e në fytyrë ka një tendosje të çuditshme. E vë
dheun në pëllëmbën e tij të ngrirë dhe ndodhem
përpara mendimin jo të papritur, por mjaft tron-
ditës, se ai s'është më gjallë. Po, ka vdekur ai,
plaku mbi 100-vjeçar, bujku dhe njeriu i mirë
Muharrem.

edhe edhe gjatë që këtij muak i tashmë i kthyes së shumë
dëjësh që nuk mund të përfundojë me vështirësi e
të marrë përshtatje. Në këtë kohë, që është
një kohë e lartë, këtia që është këtia që
në këtë kohë është këtia që është këtia që

do që është këtia që është këtia që është këtia që
do që është këtia që është këtia që është këtia që

ALBANA

«Sa daja ke ti, Albana?»

«Një dajë të vogël.»

«E do shumë dajën ti?»

«E dua.»

«Sa e do?»

«Kaaç!»

«Të merrin këtia që është këtia që është këtia që

Ajo hap duart e saj të vogla sikur do të pushtojë
qiellin. Ajo është mbesa ime katër vjeçë. Unë jam
daja i saj, tridhjetë vjeç. Unë e dua shumë atë. Sa
thjeshtë dhe kollaj thuhet kjo shprehje «E dua shu-
më atë». Po kur rri pranë saj dhe kaloj pëllëmbët e
duarve mbi flokët dhe qafën e saj delikate, më vjen
një ndjenjë sikur duhet t'i ruaj duart e mia se mos
i shtrëngoj shumë. E dua këtë çupë gjer në qmenduri.
Ajo fut ftyrën e saj në gropën e supit tim dhe seç
më thotë, me muzikën e shushurimës së saj për kop-
shtin, për shoqet, për mamin dhe babin e saj. Unë e
mbaj ashtu të shtrënguar pas vetes dhe pastaj zë e
puth duke i thënë pranë veshit ca emra përkëdhelës
pa kuptim e thuajse të pazëshëm. Pastaj ajo kërkon
t'i tregoj përralla dhe unë i flas për Kësulëkuqen dhe

dhinë me kecërit. Kur ia kam thënë të gjitha dhe s'kam ç'ti them më (sa e nevojshme është pér një dajë zotësia e përrallëtarit), atëherë nis t'i tregoj një përrallë pér gjysmagjelin që u nis pér kësмет. «Gjysmagjeli ec e ec ec e ec... e ec». Po mirë mo daja, po pastaj?»

«Prit i them, se është rrugë e gjatë shumë. Ec e ec e ec e ec... dhe vazhdoj kështu derisa kjo monotonji bën që asaj t'i mbyllen sytë e të futet në botën e gjumit. Shoh fytyrën e saj. Sytë e saj kur hapen janë të mëdhenj e të bukur. Flokët i ka të shkurtër, krela-krela, (kur ia prenë flokët daja i saj i mibajti inat pér shumë kohë së ëmës). E dua gjithçka të saj, si lëviz, si i bën buzët kur flet, si qesh e inatoset, si i shqipton fjalët me «j» në vend të «l»-së...

«Uu... po pse do ikësh ti, daja?»

«Po daja ka punë, moj nuse.»

«Bana të ka xhan ty, daja. Pse s'rri këtu sonte? Tani është natë.»

«Po kam punë, të keqen daja.»

«Po mos shko në punë ti, daja. Rri këtu me Bannë. Kush të shan ty po mos shkosh te puna?»

«Më shan shteti?»

«Mos shko ti, daja, se i thotë Bana atij shtetit që mos të shajë.»

Po t'i kujtohen këto fjalë kur të rritet, ajo do të qeshë me to. Dhe daja i saj atëherë do ta ngacmojë me shaka: Moj Albanë, thuaj një çikë shokut shtet që të mos e shajë dajën tënd që nuk do të shkojë në punë». Ajo do të qeshë, sepse atëherë ajo do të kuptojë diçka nga ky mekanizëm që quhet shtet dhe që baballarët tanë e ngritën mes zjarrit e flakëve të Luf-

tës e të cilin ne bashkë me ta, dhe ajo me shokët, do ta forcojmë dhe ruajmë të fortë e të pamposhtur.

Ajo do të rritet ngadalë dhe shpejt. Them ngadalë, se nganjëherë më pëlqen që fëmijëria e saj të zgjasë e të zgjasë kështu pa fund. Them shpejt, se e di që ajo vetë do që të rritet shpejt e të bëhet e madhe. Po, ajo do të rritet dhe çdo vit do t'i sjellë diçka të veçantë, të vetën. Do të rritet e do të mësojë shumë gjëra. Është fëmijë e lumtur në një vend të lumur. Do të mësojë për vendin e saj dhe tokën e saj, për popullin e saj dhe historinë e tij. Ajo do të hyjë dalngadalë në jetë dhe bota e saj do të rritet. Duke thënë këtë përfytyroj se si rritet bota e saj në formën e ca sferave koncentrike që kanë për qendër kokën e saj të vogël e që hapen e hapen vazhdimisht duke rritur rrezen e tyre. Këto sfera janë fluide, të pakapshme dhe në brendësinë e tyre kanë gjëegjëzat e jetës.

«Daja, atje te kopshti u ajnova me Ajketën.»

«Po pse, moj xhan?»

«Po ajo Ajketa, daja, tha se Ajbana është gjennjeshtare, se unë, daja, thashë për fotografinë e Maksit, Ejksit, Jeninit e Stajinit që ata janë shokët e dajës.»

.....
«Pse nuk janë ata shokët e tu, o daja?»

C't'i thotë daja asaj? A t'i themi që Marks, Engelsi, Lenini e Stalini kanë qenë dhe janë shokë të mirë dhe mësues të mirë, shokë të mëdhenj e mësues të mëdhenj jo vetëm të dajës së saj, por edhe të shumë dajallarëve të tjerë? Po ajo do të rritet dhe do t'i kuptojë vetë të gjitha. Do t'i kuptojë radhë-radhë, ashtu siç kuption tani se «gjermani» është i keq e

«partizani» i mirë. Kur është vetëm në dhomë ajo luan, bëhet «partizane», «lufton», futet poshtë tavolinës, poshtë minderit. Por një ditë ajo do të bëhet vërtet partizane, partizane e së resë, e progresit, për ta çuar më larg e më lart, drejt lumturisë, vendin e saj. Kurse tani është kështu... e imtë dhe e brishtë. Unë rri në minder dhe ajo vjen e struket pranë meje. E di pse vjen e më struket kështu ndërsa në dhomë luhatet drita e kaltër e televizorit. Po t'i shohësh sytë këtë çast, ajo i ka të mbyllur. Ka frikë. Ajo trembet kur filmi është me luftë ose me kafshë. I flas që të mos ketë frikë se ato nuk janë prej «vërteti», por ajo e ka të vështirë të më kuptojë. Natën ndodh që shqetësohet në gjumë dhe thërret dajën e saj, i cili ka pushkë dhe «gjejmani ia ka fikën»...

Si i liind njeriut kjo ndjenjë, që të dojë kaq shumë një qenie të tillë si Albana?! E ruaj tek ecën nëpër dhomë e korridor, kur zbret nga minderi e kur i afrohet sobës dhe herë-herë nëpër gjithë trupin më kalon një rrëqethje. Kjo, sepse kam frikë për të. Nuk e shfaq por ndodh që mendoj si ndonjë budalla se mund të vritet këtu apo atje, se mund të ketë këtë apo atë rrezik, se mund ta kërcenojë kjo apo ajo gjë, se, në fund të fundit, fëmijë është. Në këto çaste ndjej se bëhem nervoz.

«*Kul do vish plapë ti daja?*»

«*Nesër.*»

«*Po kul është nesël, të shtunën?*»

«*Jo të shtunën.*»

«*Po kul, kul të fje gjumë e të ngihem plapë në mënixhez?*»

Po, kjo është nesër, kur ti të flesh gjumë e tē ngrihesh prapë në mëngjes. Po kjo është një e nesërme e thjeshtë, moj Albanë. Kjo është një e nesërme që vjen nga rrotullimi i Tokës rrëth boshtit të vet. Po veç kësaj së nesërmeje, ka dhe një Nesër tjetër më të madhe e cila nuk varet nga Toka, po nga njerëzit që janë përmbi të. Me këtë Nesër, ka lidhje gëzimi juaj i sotëm dhe ditët e bardha të kopshteve, lodrat dhe kënga juaj e bukur. «Ne jemi pranvera që solli Partia». Kjo Nesër do të jetë e bukur për ty jo si e nesërmja e zakonshme, kur ti do të gëzohesh se do të vijë daja yt, por do të jetë e bukur sepse do të jetë e bukur për gjithë fëmijët e botës. Dhe ti do të jesh një partizane e vërtetë e kësaj së Nesërmje, dō të luftosh për të dhe t'i vësh fishekët e ditëve të tua në shërbim të saj. Sepse nuk ka gëzim më të madh, moj Albana, sesa të jesh luftëtar i asaj èndrrre për të cilën punuan mendjet më të mira dhe zemrat më të mira të njerëzve të të gjitha epokave. Jeta është e bukur dhe këtë gjë nuk është e vështirë ta kuptosh. Po ajo është dhjetë herë më e bukur kur dihet pse jetohet, kur në sytë e tu shkëlqen fuqishëm një pjesë e atij dielli të madh që quhet Komunizëm. Atëherë, ata shokët e mëdhenj të dajës sat, që ti ia tregove Alketës, do të bëhen dhe shokët e tu të mëdhenj dhe ti do të jesh një pjesë e vogël e saj organizate të madhe që ju sot i thoni «Nëna Parti». Kur të vijë kjo kohë, daja yt (edhe ky dajë dëshiron të rrojë shumë e shumë), do të bisedojë me ty jo për Kësulëkuqen e dhinë me kecër, po për Botën e Njerëzit, për Kohën dhe Jetën.

KAPERCIMI I MADH

Partizani Xhelo Merdani kishte ditë që ndiente një si angushti të madhe në zemër. Netëve thuajse nuk fliste fare dhe, edhe kur e zinte gjumi, shihte copëra, ëndrrash, sikur plagosej, vritej, ndiqej, zihej rob. Kishte kohë që batalioni s'kishte rënë në përpjekje. Flitej se gjermanët po përgatitnin një operacion të madh. Në kompani kishin ardhur shokë nga komanda e brigadës dhe u kishin folur partizanëve përsituatën, ku është armiku, c'forca grumbullon, c'bëm reaksioni etj. Partizani Xhelo Merdani kishte katër muaj e gjysmë, në mal. Ai kishte qenë pjesë-marrës aktiv i Lëvizjes në qytet, dhe në celulë. Me qenëse ishte i shkolluar, u komenton te shokëve ngjarje e situata, u tregonte lajmet e jashtme që dëgjonte italisht në stacionet e huaja. Ai kishte shpërndarë trakte e kishte propaganduar idëtë e Lëvizjes, në pull, po kurrë s'i kishte rastisur të merrte pjesë, në aksione me armë. Dhe ja puna e deshi që të dilte partizan.

Shqetësimi që e kishte pushtuar nuk ishte i besafishëm. Ky shqetësim po e shoqëronte që nga dita e parë që ndodhej aty. Partizani Xhelo Merdani ki-

shte frikë. Kjo ishte e gjitha. Por ai kishte dhjetë herë më tepër frikë t'ia pranonte vetes këtë gjë. Askush në kompani nuk mund të thoshte që ai, Xhelo Merdani, ishte frikacak. E megjithatë, frika ishte, e fshehur diku thellë shpirtit, por ishte e gjallë dhe tmerruese. Vetëm ai e dinte atë ndjenjë të dridhshme, që ngulte kthetrat në krejt qenien e tij, apo fillonte beteja. Me gjermanin s'ishte e lehtë të luftoje e ta shkulje nga pozicioni. Veshët të shungullonin nga gjëmimet dhe krismat krijonin një zinxhir të paprerë, sikur një teh i mprehtë brisku të griste me dhembje timpanet. Përreth bëhej luftë. Nga casti në cast mund të të kafshonte një nga ato grerat e nxehtha të saj me emrin njërrökësh «plumb». Ai mund të vinte nga çdo anë, nga çdo armë armiku, mund të të zinte në kokë, në gjoks, në bark, mund të të mbërthente ijeve, bri njëve, të të thyente kockat, kafkën, të të shpërthente muskujt e të të zhalaviste enët e gjakut. Njeriut i shuhej motori i jetës dhe binte i këputur. Kjo ishte vdekja. Atij i vinin në kokë të gjitha këto sa herë që batalioni nisej në luftë.

Partizanin Xhelo Merdani nuk e kishin nxjerrë me zor partizan. Bile këmbëngulja e tij kishte qenë e madhe deri atë ditë që Qarkori vendosi, dhe njëkohësisht plotësoi edhe dëshirën e tij, që ai të shkonte në mal. Atëherë c'qe kjo? Shpeshherë pyeste veten: «C'është frika? Pse njeriu ka frikë? A kanë të gjithë njerëzit, në të gjitha rastet, frikë nga vdekja?» Duke menduar këto, ndodhë që ai hynte thellë e ngatërhohej më lloj-lloj fragmente teorish psikologjike që zoteronin në botë e që ai i kishte lexuar lart e poshtë në përshtypin e kohës. Ndonjëherë mendonte se të gjithë njerëzit kanë frikë nga vdekja po të gjithë e fshehin këtë gjë. Mirëpo ky mendim s'i qëndronte, kur

shihte Ali Myftarin, Fahredin Ickën e ndonjë tjetër, që mes flakës së betejës vërtiteshin si të tè tèrbuar, a thua se shkonin jo mes plumbash por mes një shiu që freskonte tèrbimin dhe dufin e tyre të brendshëm. Kur ishte akoma në shkollë, ai kishte lexuar teorinë e profesorit Franc Konig, i cili thoshte se njeriu është një kafshë me arsyе. Veç arsyes, thoshte ai, njeriu nga asgjë tjetër nuk ndryshon nga kafsha, ai ndodhet i rrëthuar nga instinktet e veta, kërkon të ushqehet, vret që të mos e vrasin dhe rigjeron fisin vetëm pse ky rigjeronim i plotëson një kënaqësi fizike. Frika lind bashkë me të dhe, ashtu si çdo instinkt tjetër, njeriu nuk është në gjendje ta mposhtë; frika dhe të tjera instinkte bëjnë jetën e tij. Xhelo Merdani e kishte diskutuar me shokët në qytet këtë teori dhe bashkë me ta kishte qenë i bindur se ajo është anti-shkencore, antihumanitare e reaksionare. Atij tani i erdhi turp kur mendoi se, i humbur mes arsyetimeve të tij të brendshme, qëllonte që gjente strehim pikërisht nëpër fragmente të kësaj teorie.

E gjihë kjo ishte një peshë e rëndë, që ai mezi e mbante. Fakti që është ndjenjë i duhej ta mbante fshehir nga shokët, skuadra, kompania, bile fshehir edhe nga vetja (sa e çuditshme i tingëllonte kjo; fshehir nga vetja), ia bënte këtë vuajtje shumë herë më të rëndë. Ndryshe do të ishte puna sikur ai ta shprehte: «O shokë, më falni, po unë kam frikë, kam frikë, ju lutem më ndihmoni!» Ndoshta atëherë do ta kishte më të lehtë. Vërtet më të lehtë?! Po pse, a du roheshin përbuzja ndaj frikacakut, talljet, mosbesimi, shikimet e vëngëra? Jeta partizane, më pak se të gjitha frikën duronte. Jo, edhe ashtu nuk do të ishte më e lehtë. Po prapë partizani Xhelo Merdani ndiente një shtypje të tillë brenda kraharorit, saqë i dukej si-

kur s'do të duronte dot më, ashtu siç nuk duron dot një tra i drunjte mbingarkesën për një kohë të gjatë por «lodhet», «lodhet» dhe vjen çasti që thyhet. Mos vallë do ta kishte Xhelo Merdani atë çast? Më shumë ishte ligur e tretur nga kjo ndjenjë, sesa nga mundimi e jeta e malit.

I dukej se i vetmi që ia dinte ankthin e tij ishte zëvendëskomandanti i kompanisë. Ai sikur e shihte në një mënyrë të veçantë, me një lloj buzëqeshjeje që atij i dukej sikur ai, Asim Korabi e shfaqtë në buzët e tij vetëm për ta mishëruar atë, Xhelo Merdanin. Kur u ndesheshin sytë, Xhelo Merdani i shkëpuste ata menjëherë, sikur sytë e zëvendëskomandant Asimit të ishin dy copa çeliku inkandeshente. Kurse komisari, gjithmonë në mbledhje e analiza betejash në kompani, vlerësonte kujdesin dhe gjakftohtësinë e tij, të Xhelo Merdamit në luftë, «sepse Partia na do të gjallë, — thoshte ai, — që të vrashim e të mos vritemi». Por ajo gjakftohtësi që kishte ai në betejë, nuk ishte normale, ajo ishte gjakftohtësia e një njeriu mendje-humbur, i paralizuar nga frika, që e ruan më shumë se ç'duhet veten. Dhe kaq herë, partizani Xhelo Merdani e kishte përbajtur me zor veten që të mos shpërthente gulshin e mundimshëm dhe aty, tek ishin të gjithë, të thërriste: «Shoku komisar! Shokë! Nuk meritoj asnjë lavdërim. Unë, Xhelo Merdani, jam një frikacak... Ja kjo është!»

Batalioni, që mbronte rrugën e Përmetit nga ana e Leskovikut, pas dy betejash të shkurtra, mori urdhër të lëvizte në drejtim të Qafës së Bimlit. Kongresi i kishte përfunduar punimet dhe te të gjithë partizanët mbretëronte një gjësim i madh. Një frymë e re,

veçantë lëvizte tani pas Kongresit në batalion. Këtë frymë e shprehnin urdhrat e udhëzimet nga brigada, sjelljet e shokëve të shtabit, fjalët në popull dhe diçka e papërcaktuar që lëvizte. Tani lufta kishte marrë një formë më konkrete, dhe partizanët e dinin se nuk luftonin vetëm për çlirimin e vendit por edhe për të vendosur pushtetin e tyre, pushtetin e popullit.

Kishte ditë që kishte filluar Operacioni i Qershort. Ushtarët e fanteris gjermane, me pantallona të shkurtra e automatikët krahaqafë, dukeshin nga larg si gjarpinj të gjelbër, që zvarriteshin me shpejtësi. Reaksiioni i atyre zonave mori gjallëri. Venin e vinin njerëz të ikur nga fshatrat që digje gjermani. Xhelo Merdanit iu afroa një plakë me dy fëmijë të vegjël që s'ia lëshonin kindat e leshtë të fustanit. Plaka zgjati dorën dhe preku faqen e tij.

«Trimi i nënës, — tha plaka, — sa më ngjet me tim bir, o të keqen! Na dogji gjermani të keqen nëna, na dogji e na shkrettoi i mallkuari. Plakun me të vëllanë e tij, m'i muarr. Kur u vunë flakën shtëpive, plasën xhephanetë që kish fshehur plaku kur iku greku e që ruante pér djemtë e maleve. Ata po, u xhindosën dhe e hoqën osh të ziun plak. Thonë që i shpien në Korçë, ku di unë e zeza. Këta i kam të djalit, janë trembur zogjtë e nënës.» Xhelo Merdani shkoi dorën mbi kokat e fëmijëve. Në fytyrat e tyre të pluhurosura nga udha, dukeshin gjurmët e lotëve.

«Mos u mërzit, moj nënë!» — tha ai sikur t'i fliste vetes.

«Jo, të keqen! Ju ka ju nëna, trimat e nënës!» Plaka përsëri preku me gishtërinjtë që i dridheshin faqet dhe qafën e tij. Xhelo Merdanit i dhembti shpirti. «A mendohet vdekja kur sheh këtë pamje, — tha

ai. — Prej çfarë lloj materjeje je bërë ti, Xhelo Merdani, që paska gjetur tokë të mirë te ti gjembi i frikës?!» Plaka futi dorën në torbë dhe i zgjati një copë kulaç. Kulaçi u end disa herë nëpër duart e të dyve.

«Jo, — tha plaka, — merre, të keqen, ka tjetër nëna, merre, se jeni përvudhë e përluftë.» Pas pak partizani rendi pas kompanisë ashtu i hutuar e i vrarë në shpirt.

Befas kompania u gjend e rrëthuar. Ajo ra në përpjekje në tri anë dhe u zembraps në thellësi të luginës. Gjermanët, të ndihmuar nga kallauzë të reaksi-onit, zunë grykën e lunit. Lufta vazhdoi gjithë ditën. Natën, komanda e kompanisë dhe komunistët bënë mbledhje dhe vendosën të sulmonin nga verilindja, pasi në atë drejtim duhej të ndodhej dhe pjesa tjetër e batalionit. Përleshja zgjati rrëth një orë. Kompania nuk çau dot. Në përleshje, nga partizanët u plagosën Ali Myftari dhe Ollga, një nga çupat e kompanisë. Ashtu nëpër natë, kompania rrëshqiti në pyll gjer rrë-zë Nemërçkës. Partizanët u futën nëpër shpella. U gdhi. Gjermanët filluan të hidhnin mortaja më kot nëpër pyll. Tymi ngrihej gjer lart përmbi ahet. Degë të rënda thyheshin me zhurmë. Komandanti i kompanisë shtrëngonte nofullën me dorë. Komisari rrinte pranë Ollgës, që ishte në kllapi. Ajo kërkonte ujë, kërkonte mënën, pastaj përsëri ujë. Në heshtje e gjithë kompania kërkonte ujë. Shkëmbi i shpellës ishte i thatë e i zhuritur. Partizanin Xhelo Merdani e thirrën te komandanti.

«Do shkoni la, — tha ai, — ti, Xhelo, me Hasanë, ngjituni la, kërkoni skërkat, kanë dëborë skërkat. Ti, Isuf, jepu thasë. Mbushini thasët me dëborë. Muarrtë

vesh? Me kujdes! Mos u vrini, se vritet e gjithë kompania. Muarrtë vesh? Hajde, o burra!» — Komisari u buzëqeshi.

«Sa më shpejt, shokë!» — tha ai dhe ngriti grush-tin. Ata u nisën të dy. Lart, përmbi shpellat, krisën «Sharset». Ciflat e gurëve kërcenin përpjetë, sikur i gjerriente dikush me dhëmbë. «Tani mori fund», — tha Xhelo Merdani. Hasani shkiste përpara si kundhe. «Kush mori fund, ti, frikacak? Ec përpara dhe hiqe mendjen andej.» Partizani Xhelo Merdani grindej me veten e tij. U deshën tri orë të ngjiteshin lart. U gjakosën në pëllëmbët dhe poturet e të dyve u bë-në pér ibret. Ata u kthyen pasdreke. Erdhën dhe hodhën në shesh të shpellës thasët e dëborës. Xhelo Merdani lëshoi thesin dhe u ul rrëzë shkëmbit. Ai buzëqeshi i lodhur. Partizanët lëvizën drejt dëborës.

«Ndal, — thirri komandanti, — asnje mos hajë dëborë si i babëzitur! Isuf, ndaju nga një copë sa të shuajnë etjen!» Partizanët shtrydhnin dëborën në buzët e zhuritura. Te thesi i Xhelo Merdanit u gjetën dy plumbë.

«Urime, — tha zëvendëskomandant Asimi, — e shkove radhën, Xhelo. Tani s'të zë më plumbi ty.» Xhelo Merdani buzëqeshte si nëpër èndërr. Në darkë Ollga vdiq. Kompania e ndjeu thellë këtë humbje. E varrosën përpara shpellave. Pastaj u dëgjuan krisma. Batalioni kishte hyrë në luftë, në verilindje. Kompania u ngrit dhe lëvizi. Në mesnatë ajo u bashkua me forcën kryesore të batalionit, që kishte pushuar luf-timet e së bashku me të ajo përparoi drejt Qafës së Bimlit.

Tempi i lëvizjes qe i shpejtë dhe partizanët ndiheshin të lodhur. Kompanitë zhvendoseshin jo shumë larg njëra-tjetrës. Në ndalesën e fundit, komanda e

batalionit nisi një pararojë të avancuar, e cila tani ishte shkëputur mjaft prej nesh. Po ngrysej. Xhelo Merdanit iu kujtua Zara. Mos ka dalë partizane dhe ajo? Ai ka thellë në një xhep shaminë e saj. Ka katër muaj e gjysmë që e ka atë shami. Kur erdhi në mal nuk mundi të ndahej vetëm për vetëm me të. Megjithatë, çastin e fundit i tha: «Zarë, harrove shaminë.» Ajo e pa në sy. «Mbaje, — ia ktheu, — ndoshta të duhet. Ma jep kur të takohemi.» Dhe bëri me shenjë lart nga mali. Ka dalë partizane ajo vallë? Ai nuk ka asnje lajm. Xhelo Merdani shkund kokën që të mos e zërë gjumi. Pse s'e caktuan atë me pararojën? Ai kishte kërkuar të shkonte. Po komisari i buzëqeshi e i rrahu krahët. «Rri ti, Xhelo — tha ai, — duhesh këtu. Ti di të përmash mirë veten dhe shokët në betejë.» Xhelo Merdanit i erdhi ligsht. Sigurisht që me pararojën shkuantë zgjedhurit. Rreziku aty ishte i madh. Ata mund të ndesheshin çdo çast me gjermanët, që kërkonin të zinin të parët Qafën e Bimlit. Shkoi dhe Aliu, Fahredini, Merzo Osmani me gjithë të birin 16-vjeçar, Dalipin. Merzo Osmani i thoshte djalit: «Pa shih se mos merr ndonjë plumb në vend të lig, se do të t'i bëj veshët opingë, ta dish.» Ishte shakaxhi dhe ku ngulej ai, ngjallej gazi. Atë djalë të rritur kishte. E kishte lënë gruan me tre vocërrakët dhe plakun e tij. «E kam kapedane gruan, — thoshte. — Mos kisha ata këlyshërit, do dilja në mal familisht.» Këto vërtiste në kokë Xhelo Merdani dhe shtrëngonte pushkën pas shpine. Dy ditë më parë, në një bisedë me një rreth partizanësh, komisar Veliu kishte thënë: «Trim është ai që e di pse e bën trimërinë, ai që e do jetën sa s'bëhet dhe e jep pjesën e tij nga kjo jetë, për ta bëre dhjetë herë më të mirë për ata që vijnë më pas. Ky

është trimi.» Dhe komisari kishte parë shokët në sy e sytë i kishte pushuar më gjatë te Xhelo Merdani. Pse i kishte mbajtur sytë tek ai komisar Veliu? «Trim është ai që e do jetën...» «Edhe unë e dua jetën, Çdo qenie e gjallë...» Atij iu kujtua profesori Konig. «Në dreq!» — shau me vete partizani Xhelo Merdani. Po të kishte pas shpine pushkën e tij ai profesor me gjyzlykë (atij i dukej se patjetër ai duhej të kishte gjyzlykë), dhe të kishte ecur dy ditë kështu, me dy orë gjumë dhe të kishte përpara një ditë lufte të përgjakshme, atëherë të shihnin si do ta bënte teorinë. Xhelo Merdani shau përsëri. Pastaj u pengua pas një guri në errësirë e desh ra.

«Të zuri gjumi, o Xhelo?» Krah tij u afrua Asim Korabi.

«Jo, shoku Asim,... ja ashtu...» Nga përpara erdhri urdhri për të ecur më shpejt dhe në heshtje.

«Kemi kohë të mirë nesër,» — pëshpëriti Asimi.

«Të mirë», — foli Xhelojë dhe pa vilat e yjeve që vareshin nga qielli, Yjet kishin misur të zbeheshin. Dalngadalë po zbardhë. Batalioni bëri një pushim të shkurtër dhe u nis përsëri. Tej u dukën konturet e maleve, Qafa e Bimlit ishte fare pranë. Befas u dëgjuan armë. Komandanti e ndau kompaninë më dysh, ai doli në krye me një mauzer të shkurtër në dorë.

«O burra, — tha, — atje po vritten shokët. Po u mbyll Qafa e Bimlit, rrezikohet gjithë brigada.» Xhelo Merdani vrapoi pas Hajredinit, komandantit, të skuadrës. Qafa e Bimlit ishte e ngushtë, me një luginë të sheshtë në krye. Shokët e parojës ishin përplasur aty me armikun. Xhelo Merdani nuk kishte kohë të mendonte. Kjo nuk ishte një betejë ku mund të zije një pozicion e të qëlloje qetë e qetë. Ai shqoi përpara Fahredin Ickën tek vraponte gjysmë

i pérkulur me automatikun si një lodër në duart e tij të mëdha. «Oho, hoho!» — bëri Hajredini dhe mori rysh. Një mitraloz gjerman mbi si kërpudhë në krah të sulmit. Merzo Osmani u kthye dhe u vërvit drejt tij. Gjermani e pa dhe i ktheu mitralozin. Dicka i kishte ngecur dhe lëvizte duart me nervozizëm. «Baba!» — briti Dalipi dhe u hodh dhe ai. Gjermani shkrepri mitralozin. Merzo Osmani, i madh e i rëndë dhe Dalipi i vogël, ranë në një kohë mbi të. Xhelo Merdani e pa gjithë skenën me dimensionet e vërteta kohore. Ajo u zhvillua para tij sa hap e mbyll sytë. Xhelo Merdani u drodh. Ai priti që ata të dy të ngriheshin, por nga gropat ku ishte mitralozi gjerman nuk u ngrit njeri. Ai vrapi atje. Dora e Dalipit kishte mbetur e shtrënguar mbi krahun e të atit. Partizani Xhelo Merdani ndjeu t'i mjegulloheshin sytë. Ai shtrëngoi kapakët e tyre dhe lotët i shkanë poshtë si rruaza. Mjekra i dridhej si në një acar të paparë. Ai rrëmbeu mitralozin gjerman nga duart pa jetë të mitraljerit dhe bëri poshtë. Shiriti i fishekëve varej pas tij.

«Oo... oo!» — thirri Xhelo Merdani dhe e bëri vetëtimë përpàra vetes. Në gojë kishte shijen e kripur të lotëve. Ai kishte mbledhur nofullat sikur bluante dhëmbët dhe ndiente vetëm krismat e mitralozit të tij. Hajredini shikonte i shtangur vrapi e tij të zjarrtë.

«Xhelo! — thirri dikush. Asim Korabi vraptonte pas tij dhe shtinte me ndalesa. — Kujdes, Xheloo!»

«Oo... oo! — bëri përsëri Xhelo Merdani. — Përrapa, ore, me dorë, ore, me dorë!» Ndiente ajrin që i fishkëllente në vesh. Po plumbat ku ishin? Ku janë krismat e luftës? «Do t'ju vrash, — tha ai, — do t'ju vrash, o bisha, në emiér të jetës. Po të jeni ju gjallë, unë vdekur se vdekur jam, edhe Zara e nëna vdesin, mën-

gjeset bëhen blozë dhe diellin do ta kemi me zinxhirë. Unë, Xhelo Merdani, do t'ju vras.» Gjermanët u prapsën përpara tij. Thirrja partizane ushtoi mbi qafën. Befas ai ndjeu se u lodh. Jo, tha, nuk do të lodhem kurrë nga ky vrap. Shtiu përsëri dhe përsëri gjithçka përpara tij u përflak. Dora mbi tytën e mitralozit i dogji. Ai u mundua të thërriste, por zëri s'i bindej më. Ndjenja e lodhjes iu rrit, ai e kuptoi se s'mund të ec-te më, bile se s'mund të qëndronte as në këmbë. Gjermanët ishin thyer në të gjithë qafën dhe po tërhiqeshin poshtë. Partizani Xhelo Merdani preku gjoksin dhe dora iu njom. «Gjak, — tha ai, — ja dhe gjaku im». Për këtë gjak ishte trembur aq shumë ai? Ai deshi të buzëqeshte. Hapësira përpara iu sfumua. Gjithçka u bë fluide dhe atij iu duk sikur s'peshonte fare. Ekte dhe mitralozin s'e lëshonte nga duart. Pastaj, tek rrëzohej, ndjeu përsëri t'i endej në kokë diçka e papërcaktuar, diçka për jetën dhe vdekjen. Dhe ra ashtu, me sytë të hapur. Fytyra e zëvendëskomandant Asim-it iu drodh mbi vete. Ai deshi t'i thoshte diçka atij, diçka, për shembull, që ta falte, se kishte qenë frikacak. Por s'mundi. Shokët e gjetën të mbytur në gjak, në krahët e Asim Korabit.

Partizani Xhelo Merdani ndenji tri javë në spital. E kishte marrë veten po akoma nuk ngrihej dot nga shtrati. «Është i dobët, — thoshte mjeku, — ka derdhur shumë gjalk.» Një mëngjes, tek rrinte me kokën mbështetur mbi jastékët e lartë dhe vështronte nga dritarja elbin, që e lëpinte një erë e hollë, erdhë komisar Veliu. Xheloja u drodh kur e pa dhe zemra i regëtiu me vrull. Komisari e përqafroi dhe e puthi në buzë.

«Trim i kompanisë», — tha ai.

«Jo», — pëshpëriti Xhelo Merdani dhe u shkëput nga përqafimi i tij. «Jo, — tha pastaj më fort, — unë nuk jam trim, o komisar, trim ishte Merzo Osmani, Fahredini... unë jo, kam qenë frikacak. Ti nuk e di ç'frikë kam pasur.» Komisari e tërroqi nga vetja. Dora e tij e fortë shkau nëpër flokët e Xhelos.

«E di, — foli ai dhe i ngriti kokën e i pa sytë partizanit, — e di, të gjitha i di.»

«Si... ti...», — Xhelo Merdanit po i mbahej goja.

«Po, o Xhelo, — tha komisari dhe i shtrëngoi flokët, — e kisha kuptuar, ashtu siç kisha kuptuar se ti do të vije te trimëria thjesht dhe natyrshëm, duke e përbuzur vdekjen.» Të dy u panë në sy për një kohë të gjatë. Pastaj Xhelo Merdani ra mbi jastëkët dhe vështroi jashtë drifores. Ndoshta vërtet ai ishte trim. Ku ishin ata vargonj, që ia bënин aq të rëndë kafazin e kraharorit? Në dreq ai profesori me syze Konig, me gjithë pseudoteorinë e tij. Jo, njeriu nuk është si kafsha, që i bindet forcës nën instinktin e frikës. Njeriu i vërtetë di pse lufton e përpitet. Nëse vritet, kjo do të thotë se ato momente ai ka djegur gjithë karburantin e jetës që i mbetej dhe nga kjo ka ndezur një zjarr të pashuar lavdie dhe nderi, zjarr që zbardh mëngjeset e popullit të tij. Po, ai ishte bërë trim. Komisari e shikonte me buzë në gaz.

«C'mendon?» — pyeti ai.

«Mendoj se sa bukur është të jesh trim.» — foli Xhelo Merdani ashtu si nëpër èndërr. Komisari i shtrëngoi dorën.

«Po, bir, — tha ai, — e bukur është të jesh trim për luftën tonë.» Xhelo Merdani buzëqeshte. Sa e vështirë kishte qenë e gjithë kjo. Kishte kapërcyer një

luftë, kishte duruar vuajtjet e vështirësitetë. Po ky ishte kapërcimi më i madh. Ai kishte kapërcyer veten në një botë tjeter, më të re e më të mirë.

Ata u panë përsëri në sy. Përpara kishin akoma ditë lufte e betejash. Por, partizani Xhelo Merdani i shikonte të gjitha i qetë dhe me buzëqeshje.

FUSHË LUFTE

Puna në Institutin e Luftës Kimike Kundër Ndotjeve, kishte filluar, Drejtori zbriti nga makina dhe hapi korrespondencën që kishte ardhur. Ai diçka pëshpëriti në korridor, për atë që ishte vapë e madhe dhe që Instituti ishte shumë larg nga qendra. Ky Institut kishte dy vjet që ishte krijuar. Ai kishte dhe dhjetë stacione-pika në rrethe të ndryshme të Republikës që merrnin çdo ditë precipitatin e pluhurit atmosferik dhe, me një analizë të thjeshtë, përcakttonin përbajtjen e përafert. Këtë përbajtje ia komunikon Institutit me telefon. Pastaj kampioni i marrë çdo ditë dërgohej atje për një analizë më speciale. Me të dhënat e stacioneve të rretheve, Instituti përpilonte një buletin ku evidentohej përqindja e elementeve të ndryshëm kimikë që konstatohen në ajrin e qyteteve dhe fshatrave të vendit.

Sapo mbërriti në zyrë drejtori thirri sekretaren dhe e porositi të vendoste një lajmërim për një mbledhje kolektivi, pasi do të shqyrtohej plani i punës shkencore të Institutit për vitin e ardhshëm. Shaqir Skëndoja, laborant i ardhur nga NISH Kimikja dhe sekretar i organizatës bazë të partisë së Institu-

tit, pa sekretaren e drejtorit tek po vendoste në stendë lajmërimin dhe shfryu nga hundët tymin e duhanit.

«Ç'ke kështu ti? Ke ditë që i ke varur turinjtë, Shaqo,» — i tha Elvira duke buzëqeshur kur ky hyri në zyrë. Shaqir Skëndoja u përpoq t'i përgjigjej buzëqeshjes së saj.

«Sa të doli karboni tek Elbasani ty?» — tha.

«Elbasani? 2.7%. Nazmiu ia ka marrë dorën mirë, aq e kishte dhe ai.» Nga dhoma përballë erdhi Nesti, kimist i lartë.

«Ke cigare, Shaqo? Aty te rruga jonë ka ardhur një shitëse që më shumë mbyllur se hapur e mban dyqanin.» Ai ndezi cigaren dhe seç tha për analizat me rëntgen. Pastaj iku. Shaqir Skëndoja vuri bërrylat mbi tavolinë dhe mbështeti kokën përmbi duar. Ishte i shqetësuar. Instituti qe rritur e zgjeruar. Për çdo vit merrte kuadro e pajisje. Shteti kishte harxhuar miliona me stacionet e ngritura në rrethe. Po si po e justifikonte Instituti këtë rritje?! Ai vetë e kishte biseduar dhe në organizatë këtë gjë. Çfarë jepte Instituti konkretisht? Ai synonte të rriste saktësinë e matjeve, merrte aparatura të reja për çdo vit, por, në fund të fundit, kujt i vlente buletini i tij? Përse duhej gjithë kjo punë? Për ndonjërin këto mendime qenë të papritura, ndërsa drejtori kishte kundërshtuar me forcë. Ai kishte mbajtur një fjalë të gjatë për shkencën, për atë se si ne jemi mësuar t'i bëjmë punët si zanatçinj pa shkollë, se ç'perspektiva hap puna e Institutit etj...

Shaqir Skëndoja shoi cigaret pas faqes së xhamtë të tavllës dhe u ngrit. Nga dhoma ngjitur dëgjohej zëri i Xhevdetit, që lidhej me rrethet me telefon e merrte të dhënët. Shaqiri zbriti poshtë në katin

e parë ku ruheshin preparatet e ardhura dhe mori të gjitha kutitë e javës së fundit. Pastaj hyri në laborator dhe filloj analizën bashkë me Ramiun. Ramiu ishte djalë i ri që bënte stazhin pas mbarimit të Universitetit. Ata punuan të dy një copë herë, pa folur.

«Ti dukesh i lodhur, shoku Shaqir, — tha Ramiu, — lëre po të duash, i vazhdoj vetë.»

«Më plase me këtë «shoku Shaqir», hiqe, ore, të marrtë e mira, njëqind herë ta kam thënë». Ramiu u skuq dhe desh derdhi epruvetën me acid. Shaqiri e pa me dashamirësi. Pastaj e zuri nga bërryli.

«Ore Rami, nuk të kam pyetur, a të pëlqen kjo punë? Si të duket e gjithë kjo që bën Instituti?» Ramiu mblodhi supet me buzët e myllura dhe vështrimin disi të hutuar.

«Tani... si të them unë... po ja, tani,... punë për kimist këtu ka. Punë e bukur është, po ama... gjithmonë e njëjta gjë... Pastaj ne duhet t'i përgjigjemi emrit që ka Instituti, duhet të bëjmë diçka për këto ndotje, lidhur... si të them, ja, lidhur me masat për mbrojtjen,... tani edhe vetë s'e kam shumë të qartë, por diçka duhet bërë.»

«Po, diçka duhet bërë,» — përsëriti si në ndërr Shaqir Skëndoja.

* * *

Ata u takuan të dy mbasdite. Suati ishte shoku i tij i vjetër në ndërmarrjen ku kishte qenë. Tani ai që bërë përgjegjës reparti dhe kishte po atë gjallëri, humor e dëshirë për punë direkte. Ndërsa po shëtitnin përgjatë bulevardit të madh, Suati diçka po tre-

gonte për një lloj boje të re kundër ndryshkut që do të prodhonin së shpejti.

«A e di sa hyn në punë kjo, Shaqo? S'e merr me mend ti. Kur e eksperimentuam, erdhën shumë punonjës të ndërmarrjeve të tjera. Bah, sa u gjuan ca nga ata. «Na shpëtuat, ore, — thashë, — se kemi gjetur belanë me ndryshkun. Në fakt, e sillte vaporë nga jashtë, po ama kushtonte sa të dhemb koka ta mendosh... Ore, po ç'ke ti kështu? Më duket se po llap kot unë, ë?» Ai e shkundi shokun nga krahut.

«Jo, jo... vazhdo. — Shaqiri e pa në sy. — Dëgjo, Suat, më duket se kot ika nga ndërmarrja,» — tha ai pas pak dhe shtypi me forcë e flaku tëj kutinë bosh të shkrepëses.

«C'flet kot dhe ti?! Pse, pak punë ke aty? Pastaj aty merresh me shkencë, o babë», Suati qeshi dhe e shtyu me bërryl.

«Suat, unë nuk po bëj shaka.» Sytë e Shaqirit shihnin përpara, dy-tre metra larg këmbëve të tyre.

«Po ne... — nisi Suati, — ne sikur e kemi bërë muhabet këtë gjë, apo jo?»

«Jo ashtu siç duhet, — tha prerë Shaqiri. — Pastaj, dreqi ta hajë, se mos kemi ndonjë tru të përsosur filozofik që t'i kuptojmë të gjitha e t'i nuhatim të gjitha. Në fillim e gjithë ajo që bëjmë ne aty m'u duk e bukur shumë.. Nëpër mbledhje thoshnin se si i kishim realizuar planet, si i kishin përfunduar temat e ndryshme që kishte Instituti, dy punonjës tanë u bënë kandidatë shkencash dhe më dukej se e justifikonin vendin dhe rrogën që merrnin. Po, avash avash e pashë se po shtoheshin, po i rritnim kërkuesat dhe sot kam arritur në përfundimin që ne nuk i japim atdheut aq sa i marrim. Për kaq sa bëjmë ne, do mjaftonte një grup i vogël pune, i ngritur ndoshta dhe

pranë një instituti tjetër. Kurse ne jemi një Institut i tërë që rrithemi e zgjerohemë për vit. Më kupton, nuk them se një Institut si yni s'duhe të marrë përmasa». Ai heshti dhe mori frymë thellë. Suati i preku krahun.

«Vetëm ti e ke këtë mendim?»

«Si këtë mendim?»

«Ja, këtë mendim, që Institut po fryhet së tepërmë dhe po shpenzohet shumë për të.»

«Kam biseduar me shokë aty. E kam shtruar dhe në organizatën-bazë. Megjithëse organizata jonë është e vogël në numër dhe një pjesë më kanë përkrahur, prapëseprapë e shoh se s'është e lehtë. Dëgjo, Suat, këtu ndërhyjnë shumë probleme, interesë personal, rehatia etj. Rrogat aty janë të mira dhe puna është e preferueshme për këdo. Pastaj drejtori është njeri i shkathët. Ai di ta reklamojë punën; fuitet kudo dhe kudo nxjerr ndonjë përfitim për Institutin. Ja, për shembull në mbledhjen e fundit. Ishte puna për planin e këtij viti. Plot gjëra u thanë; po... Kemi bashkëpunim me Ministrinë e Ndërtimit, të Industrisë, por u japim atyre vetëm të dhënët kimike, q'përmban pluhuri i cimentos, gazrat e azotikut, pluhuri i metalurgjisë etj. Dhe konkluzioni është që oxhakët u dashkan bërë kaq të lartë dhe jo aq sa janë. Tani do të fillojmë studimin e ndotjeve në ujëra, do të marrim aparate të reja, njerëz të tjerë, drejtori me dy-tre specialistë do të shkojnë jashtë shtetit për eksperiencë etj., etj. A e kupton këtë ti, Suat?» Ai ishte nevrikosur dhe pothuajse thërriste.

«Mirë, mirë, po ule zërin. — Suati u vrenjt. — Hajde, — tha, — ulemi aty përtej dhe e bisedojmë më qetë.»

Katër punëtorët e ardhur në mbledhjen e kolektivit, rrnimin në tavolinat e para. Në presidium ishte drejtori, Shaqir Skëndoja dhe Kosta Brahimi, instruktor i komitetit të partisë së rajonit. Punonjësit ishin ndarë në dy pjesë dhe në sallë ndihej kjo.

«... Shkenca e kohës kërkon saktësi dhe punë me kualitet. Sot nuk mund të ecet më me parametrat e dikurshëm. Gama e gjerë e aparaturave që na vihen në dispozicion këtë vit, do të bëjë që të arrihet ky qëllim. Veç kësaj problemi i përcaktimit të ndotjeve hidrologjike kërkon një mobilizim total të energjive të punonjësve tanë. Por, nën udhëheqjen e organizatës-bazë të partisë dhe me përpjekjet e të gjithë shokëve, do t'u dalim mbanë detyrave që na ngarkon Partia dhe shteti.» Drejtori mori frymë dhe buzëqeshi. Ashtu me buzëqeshje vështroi Kosta Brahimin dhe u ul e fshiu me shami mjekrën e djerisitur. Pastaj foli Shaqir Skëndoja, që tha se shokët mund të fillonin nga pyetjet dhe diskutimet. Në sallë me gjithë të ardhurit bëheshin 42 vetë. Shumica e tyre vështronin mbi tavolina. U bë një heshtje e gjatë dhe rënduese. Shaqir Skëndoja qe skuqur në fytyrë. Drejtori diçka i tregonte nga fletët e planit. Kosta Brahimit, i cili shikonte gishtin e drejtorit dhe një rrudhë e thellë i qe krijuar në ballë.

«Me leje, shokë, nëse më lejoni, po flas unë.» Një nga punëtorët e ardhur, qe ngritur në këmbë dhe po shkundte kyçet e duarve.

«Shoku është Gani Estrefi, nga uzina e derdhjeve preçize,» tha Kosta Brahimi dhe i buzëqeshi punëtorit.

«Unë nuk jam specialist, shokë. Dhe shumë detaje të punës suaj nuk i di mirë. Por, edhe pse nuk jam specialist i kësaj fushe, — ai e ngriti zërin, — se

ç'bën Partia, si e drejton ajo punën, q'i duhet këtij vendi, ku duhet të synojë shkenca jonë, këto të gjitha do të isha fatkeq po të mos i kuptoja. Duke lënë mënjanë ndonjë sukses të punës suaj, shokë, më duket se puna e Institutit tuaj nuk është drejtuar atje ku duhet. Neve nuk na duhet shkencë për shkencë. Në qoftë se ju keni botuar 12 artikuj shkencorë këtë vit, bravo ju qoftë, në qoftë se keni mbrojtur dy kandidatura për kandidatë shkencash, përsëri bravo ju qoftë, në qoftë se keni përfunduar studimet tuaja sipas temave të përcaktuara në planin e punës, përsëri bravo ju qoftë, po, në qoftë se ju deri tanë nuk i keni dhënë asgjë ekonomisë sonë, asgjë konkrete, haram u qofshin të gjitha!» Salla gumëzhiu. Njerëzit pëshpëritën njëri me tjetrin.

Më poshtë Gani Estrefi foli për atë se si e shtron Partia çështjen e revolucionit tekniko-shkencor. Ai solli shembuj të ndryshëm nga ndërmarrje e institucionë të tjera të vendit që kishin bërë përpjekje të lavdërueshme në këtë drejtim.

«Në asnje zbatim konkret nuk e gjejmë firmën e Institutit tuaj shokë. Kjo nuk duhet të vazhdojë kështu. Duhet patjetër të gjeni vendin tuaj në gjithë sistemin tonë të ekonomisë, përndryshe kot që jeni. Lidhuni me ndërtimin, jepni mendimet tuaja të bazuara në shkencë, lidhur në ndërtimin e veprave të mëdha, lidhur me pajisjet e aspiracionit dhe rrugët e ndryshme të proceseve teknologjike, për të shmanjur ose pakësuar këtë apo atë lloj ndotjeje atmosferike... Më duket se këtu ka nevojë për thellim, shokë... Nuk justifikoheni dot me atë që në të ardhmen këto studime do t'i vlejnë ekonomisë. Shokë, s' themi jo, edhe e ardhmja na preokupon, por më parë e sotmja. Ç'mund të bëjë Institutit juaj për vitin

që vjen, që ta ndihmojë konkretisht prodhimin, shëndetin e popullit, apo ndonjë gjë tjetër? Këtë na thoni. Punëtori u ul me energji në karrige. Përsëri pati pëshpëritje në sallë. Drejtori herë buzëqeshtë me vështirësi, herë vrënjejtë. Shamia ishte qullur nga djersa. Rihat Kalicja, punonjës i vjetër shkencor i Institutit, që u ngrit më pas, e nisi fjalën e tij me pauza të gjata. Ramiu përkuli kokën gjer afër lustrës së tavolinës.

«Po të shkoja unë në repartin e shokut Gani, — tha ai, — kushedi se ç'do të thosha, ç'duhen këto derdhje e këto procese pune, se helbete aq marr vesh an-dej. Fshat e zanat, o shokë. Kështu thotë populli.» Ai qeshi dhe vështroi përreth.

«Më konkretisht, shoku Rihat, më konkretisht, flisni për punën tuaj dhe të shokëve dhe na i sqaroni ju, që jeni një shkencëtar i vjetër, punën tuaj, neve që s'marrim vesh, mua... këtyre shokëve, — ai tre-goi me dorë punëtorët, — dhe ndonjë tjetri këtu që s'e ka të qartë.» Kosta Brahimi foli pa e ngritur zërin, por të gjithë në sallë e dëgjuan.

«Keni të drejtë, shoku Kosta, shumë të drejtë keni, ne të shkencës e dimë se të gjithë janë në bërësi të çështjes po aq sa dhe ne dhe kjo gjë sjell një nyje kontradiktore në problemin në fjalë.» Shaqir Skëndoja dëgjonte me nofullat e shtrënguara. «Ti s'e ke bërë detyrën tënde, — i tha ai vetes. — Çfarë sekretari je ti, kur në organizatë ke komunistë me pikëpamje të tilla?! Çfarë komunisti je ti kur e lë problemin të vijë deri këtu?! Je treguar një miop klasik që kënaqeshtë me atë copë punë që bën.» Rihat Kalicja po fliste tanë për rëndësinë e përcaktimit të përqindjes së kripërave të silicit për të ardhmen e ekonomisë. Njëri nga punëtorët e ardhur në mble-

dhje, shfryu. Pastaj Rihat Kaliçja përmendi dhe një proverb popullor, citoi dhe fjalët e një shkencëtarit të madh, bëri thirrje për ta gjykuar problemin urtë e me maturi dhe u ul. Pas tij u ngrit Ramiu. Ai ishte i shqetësuar e nisi të ngatërrrohej. Drejtori vështronë i vrënjtur lëkurën e hollë të fytyrës së tij.

«Instituti ynë duhet të synojë në marrjen e mësimeve përmendëse që krijojnë atmosferë të pastër e normale... ne edhe ekonominë mund ta ndihmojmë... duke u sugjeruar uzinave e fabrikave që hedhin sedimente e aerolose në atmosferë, përfiltra të ndryshëm... kështu do të mund të mbahet dhe një sasi lënde e vlefshme që shkon kat.»

«Fol konkretisht, konkretisht, siç tha shoku Kosta, ke ndonjë ide apo propozim konkret apo e ke ashtu si atë tjetrin, që na the një muaj më parë e na shkaktovë aq dëm në laborator, duke na nxjerrë jashtëpërdorimit aparatin e ri gjerman?» Drejtori u përpoq ta fshinte inatin me një cipë buzëqeshjeje. Punëtorët lëvizën.

«S'është mirë kështu, o drejtor, — tha njëri. — E ti kërkon që pas kësaj heshte të flasë lirisht njeriu, ë?!» Në sallë u bë zhurmë. Shumë zëra përzireshin bashkë e nuk dëgjohej asgjë.

«Po jo, mor shokë...» — Drejtori hapi duart me habi.

«Mirë, fol ti, Rami, fol siç i flasim gjërat bashkë siç i flet më shokët, në laborator, në korridor, rrugëve, thuaji të gjitha.» Shaqir Skëndoja ndjeu, tek thoshte këto fjalë, vështrimet therëse të drejtorit dhe të Rihat Kaliçes. Ramiu vazhdoi përsëri, i skuqur e i djersitur Zëri i tij ishte bërë disi nervoz. Ai fliste me vështrimin ngulur në një cep të sallës. Nisi të shtjellonte një

ide të tij mbi disa filtra po pak vetë e morën vesh se ç'donte të thoshte:

«S'ka nevojë, shokë, të hapem më shumë se ç'duhet, — tha ai, — ato probleme që kapim, t'i shpiem deri në fund, gjer në zbatimin konkret, në kontaktin me ekonominë. Duhet të konkretizojmë gjuhën tonë shkencore.»

Në buzët e Rihat Kaliçes u shfaq një bузëqeshje plot kuptim. Ai diçka i foli shokut që kishte pranë. Pastaj u ngriten shumë nga punonjësit.

«Të them të drejtën, o shokë, — tha inxhinieri kimist Nesti Stefo, — kemi gjetur nga një qoshe pune e kemi rënë rehat. Vërtet çdo institucion ka një drejtues apo një grup drejtuesish, por ama edhe ne s'duhet të rrnim si të verbër. Nuk e kemi parë me këtë sy çështjen, jo.» Në sallë bëhej zhurmë. Drejtori ndërhyri disa herë i inatosur. Kosta Brahim i diçka i tha.

«Jo, mor shoku Kosta, ... po tani. . . » U ngrit të fliste Shaqir Skëndoja. Ai foli gjatë dhe herë-herë i emocionuar.

«Merre komunistin e vërtetë, — tha ai, — hidhe në çdo sferë të punës, ku të jetë nevoja dhe ai duhet të bjerë mbi këmbët e veta. Ai që bie në shpinë, në ije, me kokë, përmbysh, nuik është komunist i vërtetë. Kështu ndodhi me mua. Dhe sa u ngrita në këmbë, kaloi gjithë kjo kohë.» Pastaj ai tha se do të ishte e nevojshme ndoshta që kjo mbledhje të shtyhej, le ta mendonin shokët më mirë e më gjerë problemi, le të thërrisin dhe specialistë të fushave të ndryshme të prodhimit e të shkencës dhe le të gjykonin nëse ky Institut duhej të qendronte kështu siç ishte, apo ç'duhej të bëhej me të. Kosta Brahimit përsëri iu desh të përbante ndërhyrjen e drejtorit.

«More, shoku Kostë, po kjo është skandaloze, këtu kemi të bëjmë me vendime qeverie, më...» — Kosta Brahimi buzëqeshi i lodhur.

«Unë s'shikoj asgjë të keqe këtu, shoku drejtor, — tha ai, — qeveria është jona dhe në qoftë se diçka është për të mirën e përgjithshme, ajo do të na dëgjojë ne.» Kishte kohë që ishte errur. Sa kishte shkuar ora, vallë? Kosta Brahimi i pa me radhë fytyrat e skuqura të punonjësve, lëvizjet, mimikën e tyre, luhatjet e buzëve tek flisnin me shokun pranë. «Luttë klasash është kjo, — tha ai me vete. — Shpeshherë atë e kujtojmë si përleshje me armë, me pushkë e me topa me armikun, me diversantë, sabotatorë, armiq të revolucionit. Jo, dhe kjo mbledhje është një aspekt i madh i saj. Sepse mund të fitojmë me pushkë, me armë, po, nëse humbim këtu, te ky front, kemi rrezikuar të ardhmen e revolucionit. Cdo problem pune është një fushë beteje, qdo qendër pune, qdo institucion është një fushë beteje, qdo njeri dhe qdo koncept është një fushë e kësaj lufte të madhe që përfshin gjithë historinë e njerëzimit. Prandaj dhe ne duhet të jemi gjithmonë luftëtarë, luftëtarë të ashpër e të rreptë ndaj këtyre çështjeve. Dhe gjithmonë do të jemi të tillë, se të tillë e skalit gurinstrall të qenieve tona Partia.

PASQYRA E LËNDËS

Pranvera që ngjante me dimër	3
Pesha e një fjale	11
Usta Jorgji	19
Tri letrat	23
Njerëz mbi oxhak	29
Kanarina	35
Yjet e jetës	42
Një iso rend në hapësirë	48
Udha te njeriu	54
Sharrëxhiu	60
Një makinë në rrugë malore	65
Dallgët e grurit	72
Pazari i pasditës	77
Një tregim në muzg	83
Shoku i vjetër	88
Miniatura	92
Ekskursioni	98
Lokali pranë jetës	110
Komandanti	116
Simfonia	121
Xhirohet një film	131
Cështje në institucionin C.	141
Vdekja e plakut	149
Kovaçi	155
Gjyshi im Muharrem	160
Albana	171
Kapërcimi i madh	176
Fushë lufte	189